



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

PERMBAJTJA

Faqe

I.	Përmbledhje Ekzekutive.....	1-32
II.	Hyrje.....	32-35
	a. Objektivat dhe qëllimi	
	b. Identifikimi i çështjes	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e Vlerësimit	
	f. Standartet e auditimit	
III.	Përshkrimi i auditimit.....	35-116
	III.1. Auditim mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”, Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 “Për Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar”, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018.....	35-38
	III.2. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona (bashkëpunimi dhe korespondenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit Elbasan).....	38-62
	III.3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga privatizimi për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018 dhe transaksioneve të kryera me këtë prona, bazuar kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Bashkitë dhe ish-Njësit Vendore) dhe bazuar kontratave të shitblerjes me EKB-në.....	62-62
	III.4. Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve”, i ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018.....	62-93



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

III.5. Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.....93-97

III.6. Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.....97-100

III.7. Mbi përputhshmërinë e Aktivitetit financiar. Përdorimi me efektivitet i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Nxjerrja e përgjegjësisë për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me Degën e Thesarit për arkëtimet nga legalizimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Pagat dhe shpërblime etj). Administrimi, ruajtja. Dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe aktiveve. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.....100-113

III.8. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH.....113-116

IV. Gjetje dhe Rekomandime.....116-139

V. Konkluzione dhe Opinioni i auditimit.....136-141

VI. Dokumentacion shoqërues.....141-141

VII. Aneke.....142-153

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, sot Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme dhe funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjatë periudhës së auditimit nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2018 (për probleme të veçanta, me indicie auditimi është shtrirë edhe në periudhat e mëparshme) “Mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pranim dhe administrim të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe tjetërsimin e saj. Vlersimi i përputhshmërisë së procedurave të prokurimit dhe zërave kryesorë financiarë” është konstatuar se veprimtaria e ish-Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, sot Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, në drejtim çështjeve që lidhen me procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, nuk ka qenë plotësisht efektive, pasi pavarësisht punës së bërë për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe transaksioneve të kryera me tonë zbatim të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

dispozitave të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, konstatohet se:

Në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, sot Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh referuar bazës së të dhënave të disponuar ka në inventarin e saj 93 Zona Kadastrale nga të cilat 1 që përfshijnë Qytetin e Gramshit. Për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 deri në 31.12.2018 në këtë Zyrë janë kryer 10051 shërbime respektivisht në lidhje me; regjistrime të pronave sipas përcaktimeve ligjore, lëshim certifikata pronësie, lëshim kopje dokumentacioni, korrigjime gabimesh në harta e kartela, kalim nga regjistrat hipotekore, rivlerësime pasurie etj.

Në subjektin e audituar gjatë procesit të auditimit në terren, mbas ballafaqimit me personat përgjegjës në subjekt, nga grupi i auditimit janë mbajtur 7 Akt konstatime të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh. Mbi aktet e mbajtura në periudhën e auditimit dhe Projekt Raportin janë paraqitur observacionet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh. Nga Grupi Auditimi u caktua data 19.07.2019 për ballafaqimin përfundimtar por subjekti nuk u paraqit në ambientet e KLSH-së.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0157, me Aplikim, ka regjistruar Vendimin nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit e Pronave ish-Pronarëve Gramsh “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave z. H.R”, i cili i ka njohur dhe kthyer në natyrë në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, neni 16/c, sipërfaqen prej 4116m², e regjistruar në KPP, vol. 2, fq 178, pasuria nr. 90/4, arrë, me sip. 800m²; KPP, vol. 2, fq 179, pasuria nr. 90/5, arrë, me sip. 850m²; KPP, vol. 2, fq 180, pasuria nr. 90/6, arrë, me sip. 1000m² KPP, vol. 3, fq 228, pasuria nr. 90/10, arrë, me sip. 1466m². Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasi nuk është bërë verifikimi i titullit të pronësisë në ATP, duke qënë se vendimi nuk është përcjellë për regjistrim nga organi që ka nxjerrë aktin, por është dorëzuar nga vetë përfituesi.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurive për ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 648, datë 25.02.1992, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, si vijon: -Pasuria nr. 389/1 adresa Gramsh, e llojit arë” me sipërfaqe totale 3300 m² regjistruar në Vol 2, faqe 161; - Pasuria nr. 340 , adresa Gramsh Zgjupe, e llojit arë me sipërfaqe 1425 m², regjistruar në vol 1 faqe 51; -Pasuria nr. 266, me adresë Zgjupe Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 300 m² truall nga e cila ndërtesë 128 m²; -Pasuria nr. 339 adresa Zgjupe Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 1650 m² regjistruar në. vol 1 faqe 50; -Pasuria nr. 264 adresa Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 1000 m² regjistruar në vol 1 faqe 184; - Pasuria 273 adresa Zgjupe Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 1200 m² regjistruar në vol 2 faqe 86; -Bashkëpronari G.M për sipërfaqen 3300 m² pasuria 364 sipas nr. 207 repertorit dhe nr 188 kol datë 22.03.2000 dhe kartelës nr. serial 567738, pasuria 389/1, vol 2 faqe 161 tokë e llojit arë; - Bashkëpronari N.M pjestim nr. pasurie 389 sipërfaqe 1500 m², nr. 149 rep, nr. 9 kol, datë 3.02.1999.

Nga auditimi rezulton se në ZVRPP Gramsh në emër të pronarit të familjes bujqësore S.M ekzistojnë dy AMTP, një me nr. 648 datë 25.02.1992 për sipërfaqen gjithsej 10 800 m², me pasuritë me zë kadastral nr. 364, 389, dhe 293 firmosur nga kryetari i komisionit të ndarjes së tokës I. M dhe përfaqësuesi i rrethit I. Z dhe AMTP tjetër me sipërfaqe totale 7800 m² firmosur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

nga komision tjetër i ndarjes së tokës F.M dhe përfaqësuesja e rrethit Z.C. Gjithashtu në ZVRPP mungon lista e ndarjes së tokës për frymësipas fshatrave. Në ZVRPP Gramsh mungon AMTP origjinale ku sipërfaqja e përgjithshme e familjes bujqësore rezulton të jetë regjistruar 13025 m². Pra nga ZVRPP është regjistruar me shumë 2225 m² tokë bujqësore.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e trashëgimisë së pasurive ZK. 1392 ref. 0418 të qytetarit N.M të fituara sipas AMTP nr. 6726, datë 23.07.1993, për pasurinë nr. 37/1 sip. 1400 m², nr.6/49 sip 2000 m², nr. 73.10 sip 2800 m², nr. 71/23 sip 1500 m², nr. 32/29 sip 1260 m², 17/24 sip 1400 m² dhe pasuria 24/4 sip 600 m² gjithsejt sipërfaqe 10960 m².

Faktikisht në Zk 1392 janë regjistruar pasuritë me nr. 38/39 për sipërfaqe 1500 m² vol 2 faqe 63, nr. 17/24, për sipërfaqe 1400 m², vol 2 faqe 64, nr. 6/49 me sipërfaqe 1900 m², vol 2, faqe 60, nr. 73/10 me sipërfaqe 2800 m², vol 2, faqe 61, nr. 66/1 vol 2, faqe 15, me sipërfaqe 1600 m² gjithsejt sipërfaqe 9200 m² pra më shumë sipërfaqe 1600 m² se sa është certifikuar nga KV.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.2764 ref. 1409 fshati Cingo i Sipërm, pasurinë e qytetares H.Z** nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë nga trashëgimlënësi Sh.L. Pasuritë janë të fituara sipas AMTP nr. 154, datë 16.03.1991 për sipërfaqen gjithsejt 12000 m², sipas në ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar. Kjo AMTP, sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 816/1 datë 05.02.2018, është certifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave për sipërfaqen gjithsejt sipas AMTP sipërfaqen 11700 m² tokë arë dhe truall më pak nga ATM sipërfaqe 300 m². Nga auditimi konstatohet se praktika nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit për tu shprehur se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Gjithëashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë prej 5 vetave. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit Cingar i Sipërm rezulton se është 1700 m². Familja e z. Sh.L ku është anëtar edhe trashëgimlënësi Sh.L, është e përbërë prej 5 vetash i takon 8500 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe certifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 11700 m², **pra me shumë sipërfaqe 3200 m²**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka kryer regjistrimin në **ZK.2143, Ref. 0021 fshati Kërpicaç**, pasurinë e qytetarit I.M të fituar sipas AMTP nr. 2351, datë 20.12.1999 për sipërfaqen gjithsejt 5174 m², Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Gjithashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 1.08.1991 e përbërë prej nga 1 person. **Nga të dhënat e tabelës së Komunës Kërpicaç mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit rezulton se është 1700 m² dhe familjes I.M e përbërë prej 1 personi i takon 1700 m²**. Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe certifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 5174 m², regjistruar në ZK 2143, veprime këtonë papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.2331 ref. 0030 fshati Kuretë**, pasurinë e qytetarit E.H të fituar nëpërmjet aktit të trashëgimisë nga babai tij Veis Hasa sipas AMTP nr. 3290 , datë s’ka, për sipërfaqen gjithsejt 24120 m2. Kjo AMTP është regjistruar në pronësi të ndjerit në vol 1 faqe 66 pasuria nr. 144 sipërfaqe 300 m2, nr. 152 faqe 67 sipërfaqe 8250 m2, nr. 151 faqe 68 sipërfaqe 1100 m2, nr. 156 faqe 69 sipërfaqe 3550 m2, nr. 168 faqe 70 sipërfaqe 1900 m2, nr. 149 faqe 71 sipërfaqe 2650 m2, nr. 155 faqe 72 sipërfaqe 2350 m2 gjithsejt 20100 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se duke krahasuar normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës me çertifikatën familjare të datës 01.08.1991 nr. 010325762, rezulton së përbërja familjare e V.H është prej 3 veta dhe i takojnë 6000 m2 tokë. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 14100 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.1994 ref. 0029 fshati Jance Qendër**, pasurinë e qytetarit A.K të fituar sipas AMTP nr. 1186 , datë 08.01.1992 për sipërfaqen gjithsejt 28300 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës dhe çertifikatës së përbërjes familjare të datës 01.08.1991 nr. 010326518 datë 07.10.2016 rezulton së përbërja familjare e A.K është prej 8 veta dhe i takojnë 23320 (8x2915) m2 tokë. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 4980 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.1593 ref. 0030 fshati Mashan për** pasurinë e qytetarit T.Z të fituar sipas AMTP nr. 2958, datë 30.10.1992 për sipërfaqen gjithsejt 20700 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës me krahasimin e çertifikatës së përbërjes familjare të datës 01.08.1991 nr. 0011843748 datë 12.04.2017, rezulton së përbërja familjare e T.Z nga fshati Ermej është prej 7 veta dhe i takojnë 19600 m2 (8x2800) m2 tokë dhe jo 20700 sipas AMTP lartpërmendur. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 1100 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK 3461, Ref 01048, fshati Skanderbegas Gramsh** e qytetares M.Sh të fituar sipas AMTP nr. 2450, datë 03.02.1994. Bazuar në marrëveshjen me nr. Rep 917 dhe nr. 432 Kol, të hartuar nga noteria G.H e Zyrës së noterisë Gramsh, shtatë subjektet pjesëmarrës në aktin noterial të paraqitur të quajtur B.Sh, K.H, V.B, S.Sh, J.Sh, Sh.Sh dhe M.Sh pjestojnë pasuritë e mëposhtme: -Pasuria nr.179/5 ZK 3461 vol 5 faqe 226 sipërfaqe 2700 m2 arë dhe truall 300 m2;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

-Pasuria nr. 167/24 , adresa Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe 3200 m², regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 224; -Pasuria nr. 248/2, me adresë Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 2600 m² regjistruar ne ZK 3461 vol 1 faqe 76; -Pasuria nr. 254/6 adresa Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 2500 m² regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 228; -Pasuria nr. 259/6 Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 2000 m² regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 230, gjithsejt pasuria e pjestuar midis 4 pjestarëve sipërfaqe 13000 m². Bazuar në certifikatën familjare të datës 02.05.2015 znj. A.D konfirmon gjendjen familjare të familjes buqësore me datë 01.08.1991 dhe sipas normativës për frymë dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 10000 m² (4x2500) **pra më shumë sipërfaqja 3000 m²**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Nga auditimi i plotë konstatohet se qytetari M.M ka kërkuar regjistrimin e pasurisë sipas AMTP nr. 2236, datë 16.09.1992, me sipërfaqe gjithsejt 15310 m².

Bazuar në AMTP rezulton se për këtë qytetar veprimet e regjistrimit janë kryer me një AMTP të pa vlefshme me të njejtin numër nr. 2236 datë 20.07.2000 e cila është e pa firmosur nga pronari dhe e lëshuar nga një komision tjetër i ndarjes së tokës i përbërë nga T.D dhe përfaqësuesi i rrethit H.D. Duke analizuar gjendjen e pasurive sipas AMTP, LN printimi tretë dhe plan rlevimeve nga matjet në vend rezulton se :

Nga mos trajtimi i qytetarit me AMTP e rregullt nr. 2236 të vitit 1993, nuk janë regjistruar saktë parcelat e ngastrat e përshkruara në pronësi të qytetarit M.M, për pasuria nr. 158 e quajtur Bizhanake me sipërfaqe 1250 m² dhe gropa e kajtazit (Gliqe) me sipërfaqe 1800 m² që aktualisht qytetari e ka në shfrytëzim, veprim i konfirmuar me shkresë nr. 186 prot, datë 14.012.2017 e firmosur nga Inspektori i shërbimeve D.Z dhe Administratori Xh.B të Komunës së fshatit Sotirë, pasuria sipas AMTP me nr. 192, me sipërfaqe 6400 m², në hartën kadastrale është e paraqitur me ndarjet 192/6, me sipërfaqe 6300 m² në pronësi të z. M.M, dhe 192/ 7 me sipërfaqe 1750 m², vol. 1, faqe 108 në pronësi të S.D e cila ka mbivendosje. Në këtë kartelet është vendosur shënimi që kjo pasuri sipas aktit ndodhet në pasurinë me nr. 192 /10 e cila sipas LN është 1300 m² pra, **regjistruar më shumë 400 m²**. Nga verifikimi në hartën ipotekore rezulton se kjo pasuri është mbivendosur mbi pasurinë 192/6, e cila është pronë e z M.M.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK 1409, Ref 0020, fshati Cingar i Sipërm Gramsh** pasurinë eqytetarit F.L për ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 379 ,datë 28.07.2000 bazuar në dëshminë e tashëgimërisë të hartuar për të ndjerën F.L.

Origjina e pasurive vjen nga regjistrimi i AMTP nr. 379(153), datë 28.07.2000, regjistruar me sipërfaqe 11250 m². Bazuar në certifikatën familjare të datës 04.01.2015 e cila konfirmon gjendjen familjare të familjes buqësore me datë 01.08.1991, rezulton se në pronësi të pronares (fb)janë regjistruar dhe më pastaj janë përpjestuar pjestarëve sipërfaqja 11250 m² tokë bujqësore, nga e cila truall 300 m² më pak nga sipërfaqja e AMTP nr, 153 datë 16.03.1993.Në fakt sipas normativës për frymë dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 8500 m² (5x1700) **pra përfituar më shumë sipërfaqja 2750 m²**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Nga verifikimi i pasurive të nënshtruara procesit të shpronësimit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës, rezulton se nga zbatimi i projektit janë prekur gjithsej 326 pasuri të pronarëve dhe fshatrave të ndryshëm, me sipërfaqe totale të shpronësuar 497097 m² me një vlerë totale shpronësimi 94,459,123 lekë. Nga këto pasuri rezultoi se 157 prej tyre me sipërfaqe totale 234362,53 m², edhe pse janë pasuri të paçertifikuara kanë përfituar nga procesi i shpronësimit një vlerë totale 41,013,442.75 lekë, pa u verifikuar më parë ligjshmëria e përfitimit të titujve të pronësisë me AMTP, më hollësisht trajtuar sipas tabelës nr. 1 “*Pasuritë e shpronësuara për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës*”, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Në 2 raste**, për pasuritë regjistruara sipas **AMTP nr. 16**, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, me sipërfaqe 5350 m² dhe **AMTP nr. 47**, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A.C, me sipërfaqe 9700 m², që i janë nënshtruar procesit të shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, me sipërfaqe të përcaktuar sipas Aktit por që nuk përputhet me gjëndjen faktike sipas librit të ngastrave, përkatësisht si vijon:

- Pasuria nr. 155/1, vol. 1, fq. 59, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2590 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2500 m², **lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013. Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2580.8 m², ndërkohë që sipas faktit Librit të ngastrave është 2500 m² **pra 80.08 m² më shumë se fakti**.

- Pasuria nr. 36, vol. 1, fq. 195, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truall, me sip. 1000 m², ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 500 m², **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, sipas VKM nr. nr. 656, datë 26.09.2012, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. Shpronësimi është bërë për të sipërfaqen 531.07 m², ndërkohë që sipas faktit Libri i ngastrave, është 500 m² **pra 31.07 m² më shumë se fakti**, veprime këto në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Në 3 raste** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, për pasuritë nr. 10/300, vol. 20, fq. 108, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të N.C, nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gram, në pronësi të R.M, nr. 7/135+1-4, vol. 1, fq. 102, zk. 1842 dhe nr. 7/135+1-3, vol. 1, fq. 98, zk. 1842, në pronësi të V.Sh, bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Në 19 raste** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetrit e objekteve informale, si dy nga dokumentet e detyrueshme për regjistrimin e lejes së legalizimit, nuk janë të rregullta pasi janë të pafirmosura nga specialistët e Sektorit të Cështjeve të Pronësisë, dhe specialistët e sektorëve të tjerë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” dhe pikën 10 të VKM Nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet Aluizni-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

- **Në 7 raste** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për dhënien e shërbimit të kërkuar qytetarëve, duke krijuar vonesa në disa raste deri në një vit, kjo pa shoqëruar me Aktverifikim (AV), për mangësi në dokumentacion, që do argumentonte ligjërisht vonesat e shkaktuara, veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e trafivave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

- **Në 2 raste** nga Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në zonën kadastrale 1842-Gramsh, janë regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi konkretisht pasurianr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, pasi sipërfaqet e ndërtimit dhe parcelës ndërtimore sipas lejes së legalizimit nuk përputhen me ato të përcaktuara në gent plan dhe planimetri, gjithashtu leja e legalizimit është me korigjime dhe nga ana e ish- ZVRPP Gramsh nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Në 2 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasinga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objekti informal është ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore dhe mbi trotuarë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2, pika 4/8/1, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Në 1 rast** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, nuk ka verifikuar origjinën e truallit mbi të cilën është ndërtuar objekti informal pasi nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se regjistrimi i pasurisë nr. 7/96, vol. 14, fq. 216, zk. 1842, pjesë e pasurisë truall, fillimisht është bërë me Ref. 5975, aplikimi nr. 2277-2580, datë 08.07.2009, me leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 1, datë 01.12.1992, të Këshillit të Rregullimit të Territorit, ku është miratuar sheshi i ndërtimit për sipërfaqen prej 16 m², për ndërtimin repartit mekanik në favor të shtetasit H.C. Në dosje nuk administrohet kontrata e blerjes së truallit pas vitit 1991, mbi të cilin është ndërtuar objekti repart mekanik, si një nga 3 dokumentet që duhet për regjistrimin e pronës dhe pajisjen me certifikatë pronësie në përputhje me përcaktimet e Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12. Gjithashtu sipërfaqja e regjistruar në kartelë pas hedhjes nga sistemi hipotekor dhe e certifikuar datë 29.12.2009 është 20 m², ndërkohë që në asnjë prej dokumenteve të pronësisë nuk përmendet sipërfaqja 20 m² por 16 m², pra regjistrimi **i sipërfaqes prej 4 m² është i pa justifikuar me dokumente ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në kundërshtim** me përcaktimet e Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni 38, shfuqizuar me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12.

- **Në 2 raste** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar pasurit nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të Vullnet Shahini dhe nr. 7/329, vol.20, fq. 135, në pronësi të N.D, bazuar në lejet e legalizimit për objektet informale të ndërtuara mbi troje në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh sipas VKM-së nr. 431, datë 11.07.2007, “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të Qarkut Elbasan*”, **pa marrë më parë miratimin nga Bashkia Gramsh për legalizimin e objektit informal veprime këto që bien në kundërshtim** me pikën 2, Neni 15/1, Neni 39-Përjashtimi nga legalizimi, të Ligjit nr.9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar, nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve Tace, zk. 1842, Ref. 8646, datë 21.02.2017, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin pasi sipas VKM nr. 117, datë 17.02.2011, sipërfaqja e miratuar për parcelën ndërtimore për bashkëpronarët Tace është 302.5 m² (3.22+299.3) ndërkohë që sipërfaqja e miratuar në leje është 340.2 m², **pra nuk dokumentohet se si është përfituar sipërfaqja e mbetur prej 40 m²**. Gjithashtu mbi pasurinë nr. 9/421, vol. 21, fq. 190, Zk. 1842 me sip. 855, e llojit truall, është regjistruar në favor të bashkëpronarëve Dervishi, me Ref. 8662, datë 15.07.2015, Vendimi i Gjykatës nr. 5001, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

21.04.2014, lëshuar certifikatë pronësie datë 21.12.2015, ndërkohë që për një pjesë të kësaj pasurie ekziston një VKM për kalimin e parcelës ndërtimore nga shteti në favor të bashkëpronarëve Tace, e dhënë më parë në kohë nga vendimi gjykatës. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit deri në saktësimin e marrëdhënieve me truallin, dhe vazhdimin e procedurave të shpronësimit nga ALUIZNI Elbasan si dhe korigjimin e lejes së legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit”.

- Në **14 raste** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar leje legalizimi mbi pasuritë pa verifikuar më parë marrëdhëniet me truallin, pasi pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin Përshkrimi i veçantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ish-ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*”. Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirëfilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP-Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, nenin 36, 36/1 dhe 37 të Ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit”.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2018 ka qenë palë në 24 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat ka qenë në mungesë në 4 raste, duke mos ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 391, 442, 443, 444 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 9175, pa Aplikim, ka regjistruar pasurinë nr. 9/400 sipërfaqe truall dhe ndërtim 92.7 m², volum 20, faqe 123, në emër të I.Xh dhe S.Xh, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Apelit Durrës nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017. Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45, pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasi ka kryer regjistrim e vendimit të gjykatës pa aplikim të kërkuesit, duke shkaktuar shmangien e detyrimeve financiare për regjistrimin e aktit dhe i padituri D.Xh, bashkëpronar i pasurisë nuk është pasqyruar në kartelën e hapur nga ZVRPP Gramsh, duke lënë pronar me pjesë të papërcaktuara në kartelë I.Xh dhe S.Xh.
- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0483, me Aplikim, ka regjistruar Vendimin e Gjykatës nr. 157, datë 03.02.2016 i cili ka vendosur kthimin në natyrë të sipërfaqes prej 6334m², brenda sipërfaqes 20000m², të njohur me Vendimin nr. 559, datë 15.05.1996 të KKKP Gramsh, kjo sipërfaqe e kthyer është e ndarë në 17 parcela(pasuri) sipas dispozitivit të vendimit të gjykatës. Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për trajtimin e kërkesës së shtetasit Q.G, pasi vendim Gjykatës Elbasan nr. 157, datë 03.02.2016, ka mos përputhje të sipërfaqes së kthyer fizikisht paditësve, konkretisht, në dispozitiv gjykata shprehet për 6334 m², ndërsa shuma e parcelave përbën një sipërfaqe totale prej 6634m², pra një diferencë prej 300 m². Njëherazi, procedura e Përmirësimit e Përditësimit nuk është bërë në pajtueshmëri me kërkesat e VKM n. 245, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimit të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” pasi nuk janë respektuar përcaktimeve të pikës 8 e në vijim të VKM-së.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në Zyrën Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) mbi regjistrimin e pasurive të transferuara dhe administrimi i tyre ndër vite, u konstatua se me numër reference 6402, datë 03.12.2010 dhe aplikim 0455794, datë 02.12.2010, Bashkia Gramsh, në përputhje dhe në zbatim të VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore”, që transferohen, në pronësi, ose në përdorim, ka aplikuar për regjistrimin në pronësi dhe përdorim të pronave, kolektorët e ujërave të bardha dhe të zeza, rrjeti i ndricimit publik, trojet dhe hapësirat publike, sheshet, trotualet, lulishtet, etj. Për 32 pasuri rezulton se është bërë aplikimi për regjistrimin e tyre dhe pajisjen me certifikatë pronësie nga Bashkia Gramsh dhe janë pajisur me certifikatë 19 pasuri, për 3 pasuri nuk ka informacion, ndërsa për 10 pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie, pasi nuk është paguar tarifa e shërbimit. Gjithashtu për 189 pasuri nuk është kryer asnjë veprim nga ana e Bashkisë Gramsh në ish-ZVRPP Gramsh për sa i takon aplikimit për pajisjen me certifikatë të tyre, edhe pse ka kaluar shumë kohë që nga dalja e VKM nr. 431, datë 11.07.2007. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 24 e 25 të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore”.
- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) për periudhat raportuese objekt auditimi në procesin e hartimit të buxhetit bazuar në programin e PBA-n e hartuar nga ish-ZQRPP Tiranë, ka hartuar projektbuxhet vjetore për periudhën afatmesme 3 vjeçare për të ardhurat dhe shpenzimet në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimet vjetore përkatëse” por rezultoi se fondet e alokuara janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të Institucionit, sepse ka mungesa investimesh kryesisht për pajisje elektronike dhe kanceleri të ndryshme.

- Në Zyrën Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në strukturën organike të miratuar mungon përfshirja e pozicionit arkivist/protokollist, rol të cilin e kryen specialistja e financës e patrajnuar në këtë fushë, ndërsa arkiv/protokolli duhet të funksionojë mbështetur në zbatimin e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivën” dhe Manualit rregullator “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Miratimi i strukturës dhe nivelit të pagave për secilin pozicion janë sipas lidhjes 2/2 të përcaktuara në kategorin III-b me grupin 1 Drejtor dhe IV-b grupi 1, ose 2 ose 3 duke përcaktuar dhe kushtet e punës.

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) evidentimin e organizimit të procedurës së blerjeve me vlerë të vogël, për periudhat objekt auditimi të viteve 2017 dhe 2018, ka vepruar sipas regjistrave të prokurimeve janë parashikuar shpenzime për t’u kryer me procedurë “blerje e vogël”, por konstatohet se komisioni i autorizuar për realizimin e procedurës së blerjes në vitin 2017 në asnjë rast nuk ka evidentuar dhe kryer procedurën me prokurim elektronik, për pasojë edhe njoftim për klasifikimin e ofertave konkurruese nuk është njoftuar ofertuesi që nuk janë kualifikuar për mungesa në dokumentacion kur kontraktori është i detyruar të njoftojë operatorët nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës”, në mospërputhje me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” i ndryshuar.

-Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk ka zbatuar procedurat ligjore lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe zbatimin e afateve ligjore për kryerjen e shërbimeve të faturuara, ndaj qytetarëve, si vijon:

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 9 vitesh deri në 31.12.2018 janë 39 praktika me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, në mos zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim nga Kryeregjistruesi, një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës, për periudhën e mëparshme dhe për periudhën 01.01.2017- deri 31.12.2018, të bazuar në organikat dhe organigramat e miratuara nga qeveria me urdhërat përkatës, pasi Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP-së, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat ligjore aktuale, për rrejdhojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësisë, të secilit specialist sipas sektorëve përkatës, Regjistruesit, *lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimi, pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.*

- Në 1 rast, regjistrimi i **AMTP nr. 12**, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të D.K, me sipërfaqe 5200 m² dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezultojnë se **në total shtetasi D.K ka përfituar 5985 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 4900 m² tokë arë, pra 1085 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 190,960 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.**

- Në 1 rast, regjistrimi i **AMTP nr. 80**, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të F.C, me sipërfaqe 5400 m² dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezultojnë se **në total shtetasi F.C ka përfituar 5282 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 5100 m² tokë arë, pra 182 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 32,032 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.**

- Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në zonën kadastrale zk. 1842-Gramsh, ka regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, në lidhje me mosllogaritjen dhe kryerjen e pagesës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

sipas vlerës së tregut për sipërfaqet e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes së ndërtuar, pra mbi normën ligjore, duke ka kaluar në pronësi të përfituesve të lejes së legalizimit, sipërfaqja prej 66.8 m² me pasoja dëmin ekonomik në vlerën 165,304 lekë, për pasurinë nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, në pronësi të shtetasit R.M. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 17, pika 1/c të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe pika 5 të Udhëzimit KM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin për pagimin e qirasë, për periudhën e auditimit nga data 30.06.2014 deri 30.06.2017, nuk ka të përcaktuar marrëdhëniet e pronësisë me qira apo shitje dhe nga llogaritja e qirasë së truallit në zbatim VKM 54, datë 05.02.2014 rezulton se për sipërfaqen 16 m² x 100 lekë/m² x 36 muaj, duhet të kishte paguar detyrimin **57,000 lekë**.

- Në 8 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka arkëtuar **vlerën 412,733 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit**, që vijnë nga mosarkëtimi i të ardhurave nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të legalizimit, në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 27, pika “ç” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar”, si dhe Kreu I, pikën 1, c dhe pika 2 të VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”.

I.b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0157, me Aplikim, ka regjistruar Vendimin nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit e Pronave ish-Pronarëve Gramsh “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave z. H.R ”, i cili i ka njohur dhe kthyer në natyrë në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, neni 16/c, sipërfaqen prej 4116m², e regjistrua në KPP, vol. 2,fq 178, pasuria nr. 90/4, arrë, me sip. 800m²; KPP, vol. 2,fq 179, pasuria nr. 90/5, arrë, me sip.850m²; KPP, vol. 2,fq. 180, pasuria nr. 90/6, arrë, me sip.1000m² KPP, vol. 3,fq 228, pasuria nr. 90/10, arrë, me sip.1466m². Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme”, pasi nuk është bërë verifikimi i titullit të pronësisë në ATP, duke qënë se vendimi nuk është përcjellë për regjistrim nga organi që ka nxjerrë aktin, por është dorëzuar nga vetë përfituesi.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë nr. 90/4 vol. 2, fq 17; nr. 90/5, vol. 2, fq 179; nr. 90/6, vol. 2, fq. 180 dhe nr. 90/10, vol. 3, fq. 228, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETËTORRE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

në procedurën e regjistrimit në zbatim të nenit 27, pika b e ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e trashëgimisë së pasurive ZK. 1392 ref. 0418 të qytetarit N.M të fituara sipas AMTP nr. 6726, datë 23.07.1993, për pasurinë nr. 37/1, sip. 1400 m², nr.6/49, sip 2000 m², nr. 73.10 sip 2800 m², nr. 71/23, sip 1500 m², nr. 32/29, sip 1260 m², 17/24 sip 1400 m² dhe pasuria 24/4 sip 600 m² gjithsejt sipërfaqe 10960 m².

Faktikisht në Zk 1392 janë regjistruar pasuritë me nr. 38/39 për sipërfaqe 1500 m², vol 2, faqe 63, nr. 17/24 për sipërfaqe 1400 m², vol 2, faqe 64, nr. 6/49 me spërfaqe 1900 m², vol 2, faqe 60, nr 73/10 me spërfaqe 2800 m², vol 2, faqe 61, nr. 66/1, vol 2, faqe 15 me sipërfaqe 1600 m² gjithsejt sipërfaqe 9200 m² pra më shumë sipërfaqe 1600 m² se sa është çertifikuar nga KV.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi si dhe të verifikohet deri në origjinë kërkesa e qytetares N.M për pasurinë nr. në Zk 1392, nr. 38/39, vol 2 faqe 63, nr. 17/24, vol 2 faqe 64, nr. 6/49 vol 2 faqe 60, nr 73/10 vol 2 faqe 61, nr. 66/1 vol 2 faqe 15.

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.2764 ref. 1409 fshati Cingo i Sipërm, pasurinë e qytetares H.Z nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë nga trashëgimlënësi Sh.L.** Pasuritë janë të fituara sipas AMTP nr. 154, datë 16.03.1991 për sipërfaqen gjithsejt 12000 m², sipas në ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar. Kjo AMTP, sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 816/1 datë 052.02.2018, është çertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave për sipërfaqen gjithsejt sipas AMTP sipërfaqen 11700 m² tokë arë dhe truall më pak nga ATM sipërfaqe 300 m². Nga auditimi konstatohet se praktika nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit për tu shprehur se nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar. Gjithëashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë prej 5 vetave. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit Cingar i Sipërm rezulton se është 1700 m². Familja e z. Shaban Lumishi ku është antar edhe trashëgimlënësi Sh.L, është e përbërë prej 5 vetash i takon 8500 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe çertifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 11700 m², **pra me shumë sipërfaqe 3200 m²**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke kërkuar dhe lidhur praktikës deklaratën e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar. Gjithashtu të nxjerrë urdhër korigjimi dhe mbështetur në certifikatën familjare e pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë prej 5 vetave dhe e tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes për frymë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETËTORË TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

tokës të fshatit Cingar i Sipërm e cila rezulton se është **1700 m2**, familjes e z. Sh.L **t'i zbritet sipërfaqes 3200 m2, duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka kryer regjistrimin në **ZK.2143, Ref. 0021 fshati Kërpicaç**, pasurinë e qytetarit Idajet Sh.M të fituar sipas AMTP nr. 2351, datë 20.12.1999 për sipërfaqen gjithsejt 5174 m2, Komisioni i lartpëtmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Gjithashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë prej nga 1 person. ***Nga të dhënat e tabelës së Komunës Kërpicaç mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit rezulton se është 1700 m2 dhe familjes Idajet Sh.M e përbërë prej 1 personi i takon 1700 m2.*** Në fakt sipas AMTP së lartpëtmendur dhe certifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 5174 m2, regjistruar ne ZK 2143,veprime këtonë papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke kërkuar dhe lidhur praktikës deklaratën e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar si dhe familjes I. M për pasurinë nr. 20/3 vol, 2 faqe 138, **t'i zbritet sipërfaqja 3474 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.2331 ref. 0030 fshati Kuretë**, pasurinë e qytetarit E. H të fituar nëpërmjet aktit të trashëgimisë nga babai tij V.H sipas AMTP nr. 3290, datë s'ka, për sipërfaqen gjithsejt 24120 m2. Kjo AMTP është regjistruar në pronësi të ndjerit në vol 1, faqe 66, pasuria nr. 144 sipërfaqe 300 m2, nr. 152, faqe 67, sipërfaqe 8250 m2, nr. 151 faqe 68, sipërfaqe 1100 m2, nr. 156, faqe 69, sipërfaqe 3550 m2, nr. 168, faqe 70, sipërfaqe 1900 m2, nr. 149, faqe 71, sipërfaqe 2650 m2, nr. 155, faqe 72, sipërfaqe 2350 m2, gjithsejt 20100 m2.Nga auditimi i praktikës konstatohet se duke krahasuar normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës me certifikatën familjare të datës 01.08.1991 nr. 010325762, rezulton se përbërja familjare e V.H është prej 3 veta dhe i takojnë 6000 m2 tokë. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 14100 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 1.08.1991 nr. 010325762 familjes V.H **t'i zbritet sipërfaqja 14100 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.1994 ref. 0029 fshati Jance Qendër, pasurinë e** qytetarit A.K të fituar sipas AMTP nr. 1186 , datë 08.01.1992 për sipërfaqen gjithsejt 28300 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës dhe çertifikatës së përbërjes familjare të datës 01.08.1991 nr. 010326518 datë 07.10.2016 rezulton së përbërja familjare e A.K është prej 8 veta dhe i takojnë 23320 (8x2915) m2 tokë. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 4980 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke u bazuar në çertifikatën familjare të datës 1.08.1991 nr. 01030326518 të familjes A.K **t’i zbritet sipërfaqja 4980 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK.1593 ref. 0030 fshati Mashan për** pasurinë e qytetarit T.Z të fituar sipas AMTP nr. 2958, datë 30.10.1992 për sipërfaqen gjithsejt 20700 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës me krahasimin e çertifikatës së përbërjes familjare të datës 1.08.1991 nr. 0011843748 datë 12.04.2017, rezulton së përbërja familjare e T.Z nga fshati Ermej është prej 7 veta dhe i takojnë 19600 m2 (8x2800) m2 tokë dhe jo 20700 sipas AMTP lartpërmendur. **Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 1100 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke u bazuar në çertifikatën familjare të datës 01.08.1991, nr. 01030326518 të familjes T.Z **t’izbritet sipërfaqja 1100 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK 3461, Ref 01048, fshati Skanderbegas Gramsh e** qytetares M.Sh të fituar sipas AMTP nr. 2450 ,datë 03.02.1994. Bazuar në marrëveshjen me nr. Rep 917, dhe nr. 432 Kol, të hartuar nga noteria G.H e Zyrës së noterisë Gramsh, shtatë subjektet pjesëmarrës në aktin noterial të paraqitur të quajtur B.Sh, K.H, V.B, S.Sh, J.Sh, Sh.Sh dhe M.Sh pjestojnë pasuritë e mëposhtme : -Pasuria nr.179/5 ZK 3461, vol 5, faqe 226 sipërfaqe 2700 m2 arë dhe truall 300 m2; -Pasuria nr. 167/24, adresa Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe 3200 m2, regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 224; -Pasuria nr. 248/2, me adresë Gramsh, e llojit arë me sipërfaqë totale 2600 m2 regjistruar në ZK 3461 vol 1 faqe 76; -Pasuria nr. 254/6 adresa Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 2500 m2 regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 228; -Pasuria nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

259/6 Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 2000 m2 regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 230, gjithsejt pasuria e përpjestuar midis 4 pjestarëve sipërfaqe 13000 m2. Bazuar në certifikatën familjare të datës 02.05.2015 znj. A.D konfirmon gjendjen familjare të familjes buqësore me datë 01.08.1991 dhe sipas normativës për frymë dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 10000 m2 (4x2500) **pra më shumë sipërfaqja 3000 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerre urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore* duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 1.08.1991 të familjes T.B, M.Sh, **t’i zbritet sipërfaqja 3000 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK 3494 referencë 0032, fshati Sotirë Gramsh pasurinë e qytetarit M.M.** Nga auditimi i mbi arkivimin e AMT-ve në ZVRPP u gjenden 2 AMTP me të njëjtin numër 2236 viti 1993 e cila është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e saj, ndërsa AMTP 2236 viti 2000 me komision tjetër të ndarjes së tokës e pasaktë ku pronari i tokës nuk ka firmosur. Nga ZVRPP janë kryer veprime regjistrimi sipas AMTP së parregullt çka përbën shkelje të zbatimit të ligjit 33/12 për rregjistrimin e pasurive të fituara me ligjin nr 7501 datë 19.07.1991.

Nga auditimi i plotë konstatohet se qytetari M.M ka kërkuar regjistrimin e pasurisë sipas AMTP nr. 2236 , datë 16.09.1992, me sipërfaqe gjithsejt 15310 m2.

Bazuar në AMTP rezulton se për këtë qytetar veprimet e regjistrimit janë kryer me një AMTP të pa vlefshme me të njëjtin numër nr. 2236 datë 20.07.2000 e cila është e pa firmosur nga pronari dhe e lëshuar nga një komision tjetër i ndarjes së tokës i përbërë nga T.D dhe përfaqësuesi i rrethit H.D. Duke analizuar gjendjen e pasurive sipas AMTP, LN printimi tretë dhe plan rilevimeve nga matjet në vend rezulton se :

Nga mos trajtimi i qytetarit me AMTP e rregullt nr. 2236 të vitit 1993, nuk janë regjistruar saktë parcelat e ngastrat e përshkruara në pronësi të qytetarit M.M, për pasuria nr. 158 e quajtur Bizhanake me sipërfaqe 1250 m2 dhe gropa e kajtazit (Gliqe) me sipërfaqe 1800 m2 që aktualisht qytetari e ka në shfrytëzim, veprim i konfirmuar me shkresë nr. 186 prot, datë 14.12.2017 e firmosur nga Inspektori i shërbimeve D.Z dhe Administratori Xh.B të Komunës së fshatit Sotirë, pasuria sipas AMTP me nr. 192, me sipërfaqe 6400 m2, në hartën kadastrale është e paraqitur me ndarjet 192/6, me sipërfaqe 6300 ne pronësi të z.M.M, dhe 192/ 7 me sipërfaqe 1750 m2 vol 1 faqe 108 në pronësi të S.D e cila ka mbivendosje. Në këtë karteles është vendosur shënimi që kjo pasuri sipas aktit ndodhet në pasurinë me nr. 192 /10 e cila sipas LN është 1300 m2 pra, **regjistruar më shumë 400 m2**. Nga verifikimi në hartën ipotekore rezulton se kjo pasuri është mbivendosur mbi pasurinë 192/6, e cila është pronë e z M.M.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” të saktë me nr. 2236 viti 1993 e cila është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e saj.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, **të nxjerrë urdhër kufizimideri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore**”, të njoftojë qytetarët M.M dhe S.D për statusin juridik të pasurisë sipas AMTP me nr. 192 me sipërfaqe 6400 m2 e cila në hartën kadastrale është e paraqitur me ndarjet 192/6 me sipërfaqe 6300 në pronësi të z. M.M dhe 192/7 me sipërfaqe 1750 m2, vol 1, faqe 108, në pronësi të S.D e cila ka mbivendosje.

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në **ZK 1409, Ref 0020, fshati Cingar i Sipërm Gramsh** pasurinë e qytetarit F.L për ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 379, datë 28.07.2000 bazuar në dëshminë e tashëgimisë të hartuar për të ndjerën Farije Lumshi.

Origjina e pasurive vjen nga regjistrimi i AMTP nr. 379(153), datë 28.07.2000, regjistruar me sipërfaqe 11250 m2. Bazuar në certifikatën familjare të datës 04.01.2015 e cila konfirmon gjendjen familjare të familjes bujqësore me datë 01.08.1991, rezulton se në pronësi të pronares (fb)janë regjistruar dhe më pastaj janë përpjestuar pjestarëve sipërfaqja 11250 m2 tokë bujqësore, nga e cila truell 300 m2 më pak nga sipërfaqja e AMTP nr. 153 datë 16.03.1993. Në fakt sipas normativës për frymë dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 8500 m2 (5x1700) **pra përfituar më shumë sipërfaqja 2750 m2**, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi *deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore*” duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991 të familjes Faik Bajram Lumishi **t’i zbritet sipërfaqja 2750 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.**

- **Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste, për pasuritë regjistruara sipas **AMTP nr. 16**, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, me sipërfaqe 5350 m2 dhe **AMTP nr. 47**, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A.C, me sipërfaqe 9700 m2, që i janë nënshtruar procesit të shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, me sipërfaqe të përcaktuar sipas Aktit por që nuk përputhet me gjendjen faktike sipas librit të ngastrave, përkatësisht si vijon:

- Pasuria nr. 155/1, vol. 1, fq. 59, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2590 m2 sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2500 m2, **lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004.** Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013. Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2580.8 m2, ndërkohë që sipas faktit Librit të ngastrave është 2500 m2 **pra 80.08 m2 më shumë se fakti.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Pasuria nr. 36, vol. 1, fq. 195, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truell, me sip. 1000 m², ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 500 m², **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, sipas VKM nr. 656, datë 26.09.2012, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. Shpronësimi është bërë për të sipërfaqen 531.07 m², ndërkohë që sipas faktit Libri i ngatsrave, është 500 m² **pra 31.07 m² më shumë se fakti**, veprime këto në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të verifikohet ligjshmëria e procedurave të shpronësimit për pasuritë regjistruara sipas AMTP nr. 16, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, dhe AMTP nr. 47, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A. C.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, për pasuritë nr. 10/300, vol. 20, fq. 108, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të Nazmi Collaku, nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gram, në pronësi të Ramazan Muha, nr. 7/135+1-4, vol. 1, fq. 102, zk. 1842 dhe nr. 7/135+1-3, vol. 1, fq. 98, zk. 1842, në pronësi të Vullnet Shahini, bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në çdo rast të regjistrimit të lejeve të legalizimit për objektet informale të ndërtuara mbi objektet e vjetra, të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit ligjor lëshuar nga organet kompetente vendore për prishjen e objektit të vjetër në përputhje me përcaktimet ligjore.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 19 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetrit e objekteve informale, si dy nga dokumentet e detyrueshme për regjistrimin e lejes së legalizimit, nuk janë të rregullta pasi janë të pafirmosura nga specialistët e Sektorit të Cështjeve të Pronësisë, dhe specialistët e sektorëve të tjerë, për pasuritë si vijon:

- Pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H; - Pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.Sh; - Pasuria nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, në pronësi të F.M; - Pasuria nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, në pronësi Xh.K; - Pasuria nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, në pronësi A.R; - Pasuria nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, në pronësi V.D; - Pasuria nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, në pronësi H.M; - Pasuria nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, në pronësi B.J; - Pasuria nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, në pronësi Xh.K; - Pasuria nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, në pronësi D.D; - Pasuria nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, në pronësi H.Sh; - Pasuria nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, në pronësi F.H; - Pasuria nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, në pronësi D.B; - Pasuria nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

9/321+1-6, vol, 22, fq.98, në pronësi S.D; - Pasuria nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, në pronësi S.Ç; -Pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve Tace, zk. 1842; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, zk. 1842; veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” dhe pikën 10 të VKM Nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet Aluizni-t dhe ZQRPP-së,dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përefekt të regjistrimit të pasurivetë legalizuara”.

- **Rekomandim:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, për pasuritë si vijon: - Pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H; - Pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të Vullnet Shahini; - Pasuria nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të F.M; - Pasuria nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, zk. 1842-Gramsh, në pronësi Xh.K; - Pasuria nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B;

- Pasuria nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, zk. 1842-Gramsh, në pronësi A.R; - Pasuria nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, zk. 1842-Gramsh, në pronësi V.D; - Pasuria nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.M; - Pasuria nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, zk. 1842-Gramsh, në pronësi B.J; - Pasuria nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; - Pasuria nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.D.; - Pasuria nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.Sh; - Pasuria nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, zk. 1842-Gramsh, në pronësi F.H; - Pasuria nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-6, vol, 22, fq.98, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.D; - Pasuria nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.Ç; -Pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, zk. 1842;

- **Gjetje nga auditimi:**Në 2 raste nga Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në zonën kadastrale 1842-Gramsh, janë regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi konkretisht pasurianr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, pasi sipërfaqet e ndërtimit dhe parcelës ndërtimore sipas lejes së legalizimit nuk përputhen me ato të përcaktuara në gent plan dhe planimetri, gjithashtu leja e legalizimit është me korigjime dhe nga ana e ish- ZVRPP Gramsh nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”.

- **Rekomandimi:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në çdo rast kur lejet e legalizimit janë me korigjime të refuzojë regjistrimin e tyre dhe të kthejë dokumentacionin për korigjim, gjithashtu në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendoset masa e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, deri në korigjimin e lejes së legalizimit dhe plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasinga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objekti informal është ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore dhe mbi trotuarë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2, pika 4/8/1, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”.

- **Rekomandimi:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të vendoset masa e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, të shfuqizojë certifikatat e lëshuara si dhe të rikthejë lejet e legalizimit për rishqyrtim.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, nuk ka verifikuar origjinën e truallit mbi të cilën është ndërtuar objekti informal pasi nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se regjistrimi i pasurisë nr. 7/96, vol. 14, fq. 216, zk. 1842, pjesë e pasurisë truall, fillimisht është bërë me Ref. 5975, aplikimi nr. 2277-2580, datë 08.07.2009, me leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 1, datë 01.12.1992, të Këshillit të Rregullimit të Territorit, ku është miratuar sheshi i ndërtimit për sipërfaqen prej 16 m2, për ndërtimin repartit mekanik në favor të shtetasit H.C. Në dosje nuk administrohet kontrata e blerjes së truallit pas vitit 1991, mbi të cilin është ndërtuar objekti repart mekanik, si një nga 3 dokumentet që duhet për regjistrimin e pronës dhe pajisjen me certifikatë pronësie në përputhje me përcaktimet e Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12. Gjithashtu sipërfaqja e regjistruar në kartelë pas hedhjes nga sistemi hipotekor dhe e certifikuar datë 29.12.2009 është 20 m2, ndërkohë që në asnjë prej dokumenteve të pronësisë nuk përmendet sipërfaqja 20 m2 por 16 m2, pra regjistrimi **i sipërfaqes prej 4 m2 është i pa justifikuar me dokumente ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në kundërshtim** me përcaktimet e Ligjit nr. 7843, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

13.07.1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni 38, shfuqizuar me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12.

- **Rekomandimi:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar pasurit nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.Sh dhe nr. 7/329, vol.20, fq. 135, në pronësi të N.D, bazuar në lejet e legalizimit për objektet informale të ndërtuara mbi troje në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh sipas VKM-së nr. 431, datë 11.07.2007, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të Qarkut Elbasan”, **pa marrë më parë miratimin nga Bashkia Gramsh për legalizimin e objektit informal veprime këto që bien në kundërshtim** me pikën 2, Neni 15/1, Neni 39-Përfashtimi nga legalizimi, të Ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar, nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

-**Rekomandimi:** Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurit nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të Vullnet Shahini dhe nr. 7/329, vol.20, fq. 135, në pronësi të N. D, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, Ref. 8646, datë 21.02.2017, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin pasi sipas VKM nr. 117, datë 17.02.2011, sipërfaqja e miratuar për parcelën ndërtimore për bashkëpronarët T është 302.5 m² (3.22+299.3) ndërkohë që sipërfaqja e miratuar në leje është 340.2 m², **pra nuk dokumentohet se si është përfituar sipërfaqja e mbetur prej 40 m².** Gjithashtu mbi pasurinë nr. 9/421, vol. 21, fq. 190, Zk. 1842 me sip. 855, e llojit truall, është regjistruar në favor të bashkëpronarëve D, me Ref. 8662, datë 15.07.2015, Vendimi i Gjykatës nr. 5001, datë 21.04.2014, lëshuar certifikatë pronësie datë 21.12.2015, ndërkohë që për një pjesë të kësaj pasurie ekziston një VKM për kalimin e parcelës ndërtimore nga shteti në favor të bashkëpronarëve T, e dhënë më parë në kohë nga vendimi gjykatës. ZVRPP Gramsh nuk duhej të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit deri në saktësimin e marrëdhënieve me truallin, dhe vazhdimin e procedurave të shpronësimit nga ALUIZNI Elbasan si dhe korigjimin e lejes së legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”

-Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin.

- Gjetje nga auditimi: Në 14 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar leje legalizimi mbi pasuritë si vijon: - Pasuria nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të F.M; - Pasuria nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, zk. 1842-Gramsh, në pronësi Xh.K; - Pasuria nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, zk. 1842-Gramsh, në pronësi A.R; - Pasuria nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, zk. 1842-Gramsh, në pronësi V.D; - Pasuria nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.M; - Pasuria nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, zk. 1842-Gramsh, në pronësi B.J; - Pasuria nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, zk. 1842-Gramsh, në pronësi Xh.K; - Pasuria nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.D; - Pasuria nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.Sh; - Pasuria nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, zk. 1842-Gramsh, në pronësi F.H; - Pasuria nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-6, vol, 22, fq.98, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.D; - Pasuria nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, zk. 1842-Gramsh, në pronësi Syrja Çela; pa verifikuar më parë marrëdhëniet me truallin, pasi pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin Përshkrimi i veçantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ish-ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*”.

Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirëfilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP-Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, nenin 36, 36/1 dhe 37 të Ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

-Rekomandimi:Drejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallinpër pasuritë si vijon: - Pasuria nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të F.M; - Pasuria nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; - Pasuria nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, zk. 1842-Gramsh, në pronësi A.R; - Pasuria nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, zk. 1842-Gramsh, në pronësi V.D; - Pasuria nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.M; - Pasuria nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, zk. 1842-Gramsh, në pronësi B.J; - Pasuria nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; - Pasuria nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.D; - Pasuria nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.Sh; - Pasuria nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, zk. 1842-Gramsh, në pronësi F.H; - Pasuria nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; - Pasuria nr. 9/321+1-6, vol, 22, fq.98, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.D; - Pasuria nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.Ç;

- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2018 ka qenë palë në 24 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat ka qenë në mungesë në 4 raste, duke mos ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 391, 442, 443, 444 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Rekomandim: Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa të menjëhershme të caktojë me urdhër të brëndshëm një specialist i cili do të përfaqësojë zyrën në proceset gjyqësore, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit duke bërë ankimimet përkatëse si dhe të krijojë database duke evidentuar të gjitha proceset gjyqësore si dhe ecurinë e tyre.

- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 9175, pa Aplikim, ka regjistruar pasurinë nr. 9/400 sipërfaqe truall dhe ndërtim 92.7 m2, volum 20, faqe 123, në emër të I.Xh dhe S.Xh, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Apelit Durrës nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017. Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasi ka kryer regjistrim e vendimit të gjykatës pa aplikim të kërkuarit, duke shkaktuar shmangien e detyrimeve financiare për regjistrimin e aktit dhe i padituri D.Xh, bashkëpronar i pasurisë nuk është pasqyruar në kartelën e hapur nga ZVRPP Gramsh, duke lënë pronar me pjesë të papërcaktuara në kartelë I.Xh dhe S.X.

- Rekomandim: Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/400 regjistruar në volum nr. 20, faqe nr.123 ZK 1842, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të nenit 27, pika b e ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0483, me Aplikim, ka regjistruar Vendimin e Gjykatës nr. 157, datë 03.02.2016 i cili ka vendosur kthimin në natyrë të sipërfaqes prej 6334m², brenda sipërfaqes 20000m², të njohur me Vendimin nr. 559, datë 15.05.1996 të KKKP Gramsh, kjo sipërfaqe e kthyer është e ndarë në 17 parcela(pasuri) sipas dispozitivit të vendimit të gjykatës. Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për trajtimin e kërkesës së shtetasit Q.G, pasi vendim Gjykatës Elbasan nr. 157, datë 03.02.2016, ka mos përputhje të sipërfaqes së kthyer fizikisht paditësve, konkretisht, në dispozitiv gjykata shprehet për 6334 m², ndërsa shuma e parcelave përbën një sipërfaqe totale prej 6634m², pra një difference prej 300 m². Njëherazi, procedura e Përmirësim e Përditësimit nuk është bërë në pajtueshmëri me kërkesat e VKM n. 245, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimit e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” pasi nuk janë respektuar përcaktimeve të pikës 8 e në vijim të VKM-së.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara në zbatim të Vendimit të Gjykatës nr. 157, datë 03.02.2016, sipas referencës nr. 0483, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të nenit 27, pika b e Ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

-**Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) për periudhat raportuese objekt auditimi në procesin e hartimit të buxhetit bazuar në programin e PBA-n e hartuar nga ish-ZQRPP Tiranë, ka hartuar projektbuxhet vjetore për periudhën afatmesme 3 vjeçare për të ardhurat dhe shpenzimet në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimet vjetore përkatëse” por rezultoi se fondet e alokuara janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të Institucionit, sepse ka mungesa investimesh kryesisht për pajisje elektronike dhe kancelari të ndryshme.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa që bazuar në nevojat e konstatuara për investime dhe shërbime të ndryshme, në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës të planifikojë në periudhat e ardhshme fondet e nevojshme për plotësimin me pajisje dhe shërbime konkrete.

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) evidentimin e organizimit e procedurës së blerjeve me vlerë të vogël, për periudhat objekt auditimi të viteve 2017 dhe 2018, ka vepruar sipas regjistrave të prokurimeve janë parashikuar shpenzime për t’u kryer me procedurë “blerje e vogël”, por konstatohet se komisioni i autorizuar për realizimin e procedurës së blerjes në vitin 2017 në asnjë rast nuk ka evidentuar dhe kryer procedurën me prokurim elektronik, për pasojë edhe njoftim për klasifikimi ofertave konkurruese nuk është njoftuar ofertuesi që nuk janë kualifikuar për mungesa në dokumentacion kur kontraktori është i detyruar të njoftojë operatorët nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës”, në mospërputhje me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” i ndryshuar.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masat e nevojshme për nxjerrjen e urdhër prokurimeve për zbatimin e procedurës “blerje me vlerë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

e vogël” duke përcaktuar referimin ligjor për “blerje e vogël” me sistem elektronik ku bashkëlidhur janë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese, procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë të vogël, tërheqje nga operatori i ofertës fituese veprime në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24; 10; 11; 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, si dhe Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar.

- **Gjetje nga auditimi:** Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk ka zbatuar procedurat ligjore lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe zbatimin e afateve ligjore për kryerjen e shërbimeve të faturuara, ndaj qytetarëve, si vijon:

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 9 vitesh deri në 31.12.2018 janë 39 praktika me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, në mos zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim nga Kryeregjistruesi, një rregullore të brendshme të Funkzionimit të Administratës, për periudhën e mëparshme dhe për periudhën 01.01.2017- deri 31.12.2018, të bazuar në organikat dhe organigramat e miratuara nga qeveria me urdhërat përkatës, pasi Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP-së, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat ligjore aktuale, për rrejdhojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësisë, të secilit specialist sipas sektorëve përkatës, Regjistruesit, *lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkëljes së afateve, evidentimi, pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.*

-**Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e 39 praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara, para dhe prej 3 vitesh, deri në 31.12.2018, për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit të faturuar, rritjen e integritetit dhe transparencës së punës së Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh ndaj publikut, si dhe të administrohet në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave në proces.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- **Rekomandim:** Dejtari i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të marrë masa për të hartuar e miratuar Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Administratës, e cila do të përcaktojë qartë funksionimin e hallkave e strukturave dhe detyrat e përgjegjësitë për çdo punonjës, duke ngritur e forcuar Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm(SMKB).
- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, regjistrimi i **AMTP nr. 12**, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të Demir Kllogjri, me sipërfaqe 5200 m² dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezulton se **në total shtetasi D.K ka përfituar 5985 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 4900 m² tokë arë, pra 1085 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 190,960 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.**
- **Rekomandim:** Dejtari i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **190,960 lekë përfituar padrejtësisht nga procesi i shpronësimit nga shtetasi D.K.**
- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, regjistrimi i **AMTP nr. 80**, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të F.C, me sipërfaqe 5400 m² dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezulton se **në total shtetasi F.C ka përfituar 5282 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 5100 m² tokë arë, pra 182 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 32,032 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.**
- **Rekomandim:** Dejtari i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të kërkojë në rrugë ligjore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

arkëtimin e vlerës **32,032 lekë** përfituar padrejtësisht nga procesi i shpronësimit nga shtetasi F.C.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në zonën kadastrale zk. 1842-Gramsh, ka regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, në lidhje me mosllogaritjen dhe kryerjen e pagesës sipas vlerës së tregut për sipërfaqet e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes së ndërtuar, pra mbi normën ligjore, duke ka kaluar në pronësi të përfituesve të lejes së legalizimit, sipërfaqja prej 66.8 m² me pasoja dëmin ekonomik në vlerën 165,304 lekë, për pasurinë nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, në pronësi të shtetasit R.M. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 17, pika 1/c të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe pika 5 të Udhëzimit KM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Rekomandim:** Dejtori i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, në pronësi të shtetasit R.M deri në arkëtimin e vlerës **165,304 lekë**.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin për pagimin e qirasë, për periudhën e auditimit nga data 30.06.2014 deri 30.06.2017 nuk ka të përcaktuar marrëdhëniet e pronësisë me qira apo shitje dhe nga llogaritja e qirasë së truallit në zbatim VKM 54, datë 05.02.2014 rezulton se për sipërfaqen 16 m² x 100 lekë/m² x 36 muaj, duhet të kishte paguar detyrimin **57,000 lekë**.

-**Rekomandimi:** Drejtoria i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin dhe arkëtimin e detyrimit të qirasë së përcaktuar **57,000 lekë**.

- **Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka arkëtuar **vlerën 412,733 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit**, që vijnë nga mosarkëtimi i të ardhurave nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të legalizimit, **për pasuritë si vijon:** - Pasuria nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit R.M, për vlerën **12,447 lekë**; - Pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H, për vlerën **35,176 lekë**; - Pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M, për vlerën **53,782 lekë**; - Pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.S, për vlerën **116,957 lekë**; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 6654236, datë 22.04.2016, në pronësi të V dhe M.D, me Ref. 8679, datë 10.03.2017, për vlerën 6094 lekë; - Pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, vlerën 56,530 lekë; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, për vlerën 70,319 lekë; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 3040276, datë 29.08.2016, në pronësi të N.C, me Ref. 8871, pa datë, për vlerën 61,428 lekë, në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 27, pika “ç” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar”, si dhe Kreu I, pikën 1, c dhe pika 2 të VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”.

- **Rekomandimi:** Dejtari i Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në arkëtimin e vlerës totale **412,733 lekë**, përkatësisht për pasuritë si vijon:- Pasuria nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit R.M, për vlerën **12,447 lekë**; - Pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H, përvlerën **35,176 lekë**; - Pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M, për vlerën **53,782 lekë**; - Pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.Sh, për vlerën **116,957 lekë**; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 6654236, datë 22.04.2016, në pronësi të V dhe M.D, me Ref. 8679, datë 10.03.2017, për vlerën **6094 lekë**;- Pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, vlerën **56,530 lekë**; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, për vlerën **70,319 lekë**; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 3040276, datë 29.08.2016, në pronësi të N.C, me Ref. 8871, për vlerën **61,428 lekë**.

I.c. Konkluzione dhe opinionin i auditimit

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret).

- Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk është audituar më parë nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2017 deri me 31.12.2018 janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur nga veprimet e mosveprimet e specialistëve dhe nga një kuadër legjislativë me mangësi. Niveli i menaxhimit të veprimtarisë së subjektit nga strukturat drejtuese konstatohet në nivele jo të mjaftueshme. Auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të ish-ZVRPP Gramsh si një institucion që ka impakt të lartë social dhe ndikon direkt në vlerësimin dhe opinionin e qytetarëve për qeverisjen e vendit, paraqet rëndësi në lidhje me informimin dhe evidentimin e mangësive për vendosjen e rekomandimeve në lidhje me përmirësimin e punës në të ardhmen. Auditimet më të shpeshta dhe periodike do të ndikonin në rritjen e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni.

Konkluzioni më sipër është arritur duke u bazuar në mangësitë dhe shkeljet si vijon:

- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, bazuar vetëm në deklaratën noteriale, të poseduesit të ndërtimit, për prishjen e ndërtimit të vjetër,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

pa dokumentacionin përkatës ligjor nga institucionet vendore, si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit.

- Janë kryer regjistrime me shkelje të dispozitave ligjore, pasi mungon dokumentacioni tekniko ligjor, akti i fitimit të pronësisë mbi truallin, konfirmimi zyrtar nga institucionet përkatëse lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i truallit në pronësi “shtet”, gjithashtu marrëdhëniet me truallin nuk janë sipas ligjit, etj.

- Janë kryer regjistrime të pasurive të përfituara me AMTP, me shkelje të dispozitave ligjore, pasi janë regjistruar pasuri që nuk janë të llojit tokë bujqësore, për të cilat AMTP-ja nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie.

- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetrit e objekteve informale, si dy nga dokumentet e detyrueshme për regjistrimin e lejes së legalizimit, nuk janë firmosur nga specialistët e Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, dhe specialistët e sektorëve të tjerë.

- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale të ndërtuara mbi troje në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh pa marrë më parë miratimin nga Bashkia Gramsh për legalizimin e objektit informal.

- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe janë kryer transaksione, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi është shkelur kriteri i ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre kanë përfituar më tepër tokë se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare datë 01.08.1991.

- Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Elbasan, lidhur me konfirmimin zyrtar të statusit të parcelave ndërtimore të miratuara, ndërsa nga ish-ZVRPP Gramsh është proceduar duke regjistruar dhe certifikuar pronësinë për poseduesit e lejeve të legalizimit, të cilat janë ndërtuar mbi objekte që figurojnë në pronësi “shtet”, të regjistruara në KPP.

Magësit dhe shkeljet e konstatuara më sipër nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, janë materiale për devijimet e konstatuara në disa raste, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar me rezervë dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar ish-Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, sot Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, marrja e masave përkatëse.

II-Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, (këtu e në vazhdim KLSH) në zbatim të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01.04.2019, miratuar nga Nën Kryetari i KLSH u krye auditimi në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nga data 01.04.2019 deri më datë 31.05.2019 për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2018 (për probleme të ndryshme, me indicie auditimi është shtrirë edhe në periudhat e mëparshme), “Mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pranim dhe administrim të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe tjetërsimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

e saj. Vlersimi i përputhshmërisë së procedurave të prokurimit dhe zërave kryesorë financiarë”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Besmir Pajaj, (Përgjegjës Grupi)
2. Xhovan Domi, Auditues
3. Julian Adili, Auditues
4. Keida Muca, Auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), “Mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pranim dhe administrim të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe tjetërsimin e saj, vlersimi i përputhshmërisë së procedurave të prokurimit dhe zërave kryesorë financiarë” në tre kopje nga të cilat, dy kopje i dërgohen ish-ZVRPP Gramsh dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

a) Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat: Vlerësimi i aktivitetit të institucionit lidhur me procedurën e pranimi dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve, performancën e punës në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj publikut në lidhje zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë apo objektivave të përcaktuara me ndonjë plan strategjik zhvillimi afat shkurtër apo afat mesëm të shkruar, në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Qëllimi: KLSH nëpërmjet një pune audituese sistematike dhe me zgjedhje të evidentojë devijacionet nga zbatimi i dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore, mangësitë, shkeljet dhe parregullsitë si në drejtim të transaksioneve financiare lidhur me tarifat e aplikimit, përlogaritjes së tatimit të kalimit të pronësisë, ashtu edhe në zbatimin e procedurave ligjore nga strukturat e subjektit të audituar me qëllim që auditimi ti shërbej subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës për të ardhmen, si dhe për të bërë të mundur që menaxherët e ish-ZVRPP Gramshit kuptojnë nevojën e domosdoshme të një strukture kompetente e cila do të bënte të mundur evidentimin në kohë të mangësive e shkeljeve me qëllim marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për përmirësimin e gjendjes.

b) Identifikimi i çështjes.

1. Auditimi mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

2. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfitur nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga privatizimi për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018 dhe transaksioneve të kryera me këtë prona, bazuar kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Bashkitë dhe ish-Njësit Vendore).

4. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të nprocedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo, i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

5. Auditimi mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.

6. Regjistrimi i pasurive publike të transferuara dhe administrimi i tyre.

7. Mbi përputhshmërinë e Aktivitet financiar. Përdorimi me efektivitet i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Nxjerrja e përgjegjësive për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me Degën e Thesarit për arkëtimet nga legalizimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Pagat dhe shpërblime etj). Administrimi, ruajtja. Dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe aktiveve. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

8. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Strukturat drejtuese të subjektit ish-ZVRPP Gramsh, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e pasurive përfituara me vendime të KKKP-së, me AMTP, përfituar me leje legalizimi, me vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe regjistrimin e pasurive të transferuara, mbajnë përgjegjësi në lidhje me regjistrimin e tyre me mangësi, në shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 dhe të akteve ligjore e nënligjore të tjera gjatë kryerjes së auditimit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ish-ZVRPP Gramsh, kryesisht Regjistruesit sipas periudhave përkatëse evidentuar në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

d) Përgjegjësitë e audituesve:

Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim pikat 1, 2, 4, 5, 6, etj në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e pasurive përfituara me AMTP, vendim gjyqësor të formës së prerë, përfituar me leje legalizimi, dhe regjistrimin e pasurive të transferuara, u konstatuan mangësi e shkelje të dispozitave të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 dhe aktet nën ligjore në zbatim të tij, duke ngarkuar me përgjegjësi kryesisht strukturat drejtuese të subjektit. Auditimi është kryer sipas standardeve duke respektuar kërkesat etike dhe duke planifikuar e kryer auditimin duke arritur nivelin e sigurisë së kërkuar.

e) Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën, është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, shfuqizuar me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”; ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar; ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, i ndryshuar, ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”; ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”; udhëzimi i MBU nr. 106, datë 23.02.1996 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe VKM nr. 161, datë, 08.04.1993 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”; ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”; ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar; VKM nr. 315, datë 24.04.2003 dhe nr. 162, datë 07.03.2007 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, i ndryshuar; VKM nr. 35, datë 24.01.2007 “Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë për qëllime tregu”; VKM nr. 169, datë 13.03.2003 dhe nr. 703, datë 11.10.2006 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare”; VKM nr. 704, datë 11.10.2006 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes”; VKM nr. 286, datë 2.6.2000 “Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga EKB në tregun e lirë të banesave”; ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”; ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit”; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

f) Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Zyra Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk është audituar më parë nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2017 deri me 31.12.2018 janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur kryesisht nga veprimet dhe mosveprimet e punonjësve dhe nga një kuadër legjislativë me mangësi. Niveli i menaxhimit të veprimtarisë së subjektit nga strukturat drejtuese konstatohet në nivele jo të mjaftueshme. Auditimi i përputhmërisë së aktivitetit të ish-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

ZVRPP Gramsh paraqet një rëndësi në lidhje me informimin dhe evidentimin e shkeljeve për vendosjen e rekomandimeve në lidhje me përmirësimin e punës në të ardhmen.

2. Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimeve të regjistrimit të pasurive nga Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në zbatim të akteve administrative lëshuar nga organet që e kanë në kompetencë dhe me vendime të gjykatave të formës së prerë që lidhen me pasuri përfituar nga ligji i legalizimeve, me vendime gjykate të formës së prerë, nga ligji i Privatizimit, Ligji për Shitblerjen e Trojeve etj, duke kryer bashkim e ndarje pasurish, duke kryer regjistrime fillestare të tokave bujqësore, etj, përgjatë periudhës 01.01.2017 deri me 31.12.2018, etj.

3. Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

4. Fushëveprimi: Auditimi është shtrirë në masën 25% të veprimeve të kryera nga ish-ZVRPP Gramsh duke audituar dokumentacionin me zgjedhje të specifikuar në zona kadastrale dhe sipas regjistrave kadastral, pa u kufizuar gjatë auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Auditim mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”, Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 “Për Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar”.

Mbi auditimin e ushtruar në ZVRPP Gramsh (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) në bazë të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01/04/2019, mbajtur në datë 28/05/2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Nga ana e ish-ZVRPP Gramsh nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përsa i përket regjistrimit të pasurive të përfituara me vendime të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ndërvite (sot ATP, në 1 rast, referuar nenit referuar nenit 45, pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012” dhe pikës 2 të Udhezimit nr. 2, datë 12.09.2012 në të cilin përcaktohet që:

“Regjistrimi i fitimit apo kalimit të drejtes së drejtes së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të njohura apo të fituara me anë të ligjit, vendim gjyqësor, aktit administrativ ose me parashkrim fitues, në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” behet nga ZVRPP pas verifikimit të plotë të elementëve të aktit që njeh ose permban fitimin e të drejtën e pronësisë për efekt të plotësimit të kushteve të regjistrimit të përcaktuara në nenin 193 të Kodit civil të RSH.

Nga auditimi rezultoi se :

1.Me refencën nr. 0029, me Aplikim, është refuzuar regjistrimi i pasurisë llojit “pyll” me sip. 94812m², me Vendim nr.44, datë 05.04.2006 të KVKKP-Qarku Elbasan dhe ka nënshkruar në KPP N.Z dhe regjistruar X.B. Inventari pa datë nga N.Z.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Me Projekt Urdhërin nr. 11, datë 10.06.2016, miratuar dhe nga ZQRPP me Urdhërin nr 172, datë 07.02.2017, është refuzuar regjistrimi i pasurisë, me arsyetimin se pasuria e pretenduar nuk plotëson kriteret për regjistrimin të përcaktuara në nenin 25/a të ligjit 33/2012, pikës 5/c, 6/ç të UKM nr. 2/2012, në të cilët përcaktohet që akti i fitimit të pronësisë i paraqitur për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme duhet të ketë të përcaktuar minimalisht kufijtë dhe pozicionin gjeografik të kësaj pasurie, ku përfshihet vendodhja e pronës/ numrin e regjistrimit në regjistrat hipotekor etj...

Vlerësojmë se veprimet ZVRPP janë në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore.

2.Me refencën nr. 0024, me Aplikim, është bërë regjistrimi i sipërfaqes totale 563248.92m², me Vendim nr. 528, datë 25.04.2017 të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, **“Për Kompensimin e Pronës”**. dhe ka nënshkruar në KPP N.Z dheish-regjistrues F.H. Inventari pa datë nga N.Z. Konstatohet se Agjencia e Trajtimit të Pronave me Vendim nr. 528, datë 25.04.2017, **“Për Kompensimin e Pronës”, ka vendosur:**

1. Pranimin e kërkesës nr. 267, datë 31.03.2017 të paraqitur nga zj. M.B.
2. Kompensimin financiar të pronës së njohur me Vendimin nr. 996, datë 28.12.1994 të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar Z. e A.B, në vlerën prej 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë.
3. Kompensim fizik nga fondi i ATP-së me pasuritë:
 - Pasuria nr. 9/1 me sip. 210787 m² ZK 3624, fshati Trashovicë, Rrethi Gramsh, Elbasan;
 - Pasuria nr. 315 me sip. 70989 m² ZK 2014, fshati Kabash, Rrethi Gramsh, Elbasan;
 - Pasuria nr. 130/2 me sip. 148429.74 m² ZK 2154, fshati Kishte, Rrethi Gramsh, Elbasan;
 - Pasuria nr. 87 me sip. 68442.12 m² ZK 1286, fshati Broshtan, Rrethi Gramsh, Elbasan;
 - Pasuria nr. 80 me sip. 52801.06 m² ZK 1286, fshati Broshtan, Rrethi Gramsh, Elbasan;
 - Pasuria nr. 83 me sip. 11800m² ZK 1286, fshati Broshtan, Rrethi Gramsh, Elbasan;
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, përfundoi procesi i kompensimit për vendimin nr. 996, datë 28.12.1994, të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar Z e A. B.

Nga verifikimi rezulton se këto sipërfaqe, me anë të VKM nr. 770, datë 12.11.2014 *“Për kalimin në Fondin e Kompensimi Fizik, në dispozicion të AKKP(sot ATP), të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23.368.8ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim të njësive të qeverisjes vendore”*

Pasuritë objekt i vendimit të ATP, ndodhen në listën bashkëngjitur VKM-së së sipër përmendur me numrat rendor:

1. Pasuria nr. 80, në list me numrin rendor nr. 1
2. Pasuria nr. 83, në list me numrin rendor nr. 3
3. Pasuria nr. 87, në list me numrin rendor nr. 5
4. Pasuria nr. 130/2, në list me numrin rendor nr. 6
5. Pasuria nr. 9/1, në list me numrin rendor nr.1073.
6. Pasuria nr. 315, në list me numrin rendor nr.1141.

Vlerësojmë se veprimet ZVRPP janë në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore për regjistrimin e akteve administrative.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

3.Me refencën nr. 0157, me Aplikim, është bërë regjistrimi i sipërfaqes totale 4116m², me Vendim nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit e Pronave ish-Pronarëve Gramsh **“Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave z. H.R”**. dhe ka nëshkruar në KPP N.Z dhe regjistruar X.B. Inventari pa datë nga N.Z.

Me Vendim nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit e Pronave ish-Pronarëve Gramsh **“Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave z. H.R”**, është vendosur:

1. Të njohë z. H.R, trashëgimtarë të ish-pronarit H.R për këto prona:
2. Trualli prej 1425m² i cili kufizonet nga rrugë, rrugë, R.K, rrugë, sipas skicës bashkangjitur.
3. Trualli prej 4140 m² i cili kufizonet nga rrugë, I.M, Q.K, sipas skicës bashkangjitur.
4. Kthim në natyrë në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, neni 16/c, sipërfaqet të cilat janë parashikuara për planin rregullues të fshatit Drizë, si parcela nr. 6/1, me përmasat (24mX24m), në shumën 576 m², kufizimet nga veriu K.K, lindja K.K, jug vetë, perëndim X.M.
Parcela nr. 6/2, me përmasat (48mX25m): 2x97, gjithsej 3540m², me kufizimet nga veriu vet, lindje M.K, jugu rrugë, perëndimi F.B.

Shuma gjithsej e kthimit 576m²+3540m²=4116m² sipas skicave bashkangjitur.

Regjistrimi është bërë në:

1. KPP, vol. 2,fq 178, pasuria nr. 90/4, arrë, me sip. 800m²;
2. KPP, vol. 2,fq 179, pasuria nr. 90/5, arrë, me sip.850m²;
3. KPP, vol. 2,fq 180, pasuria nr. 90/6, arrë, me sip.1000m²
4. KPP, vol. 3,fq 228, pasuria nr. 90/10, arrë, me sip.1466m²;

Rezulton se nga ZVRPP Gramsh, nuk është bërë verifikimi i titullit të pronësisë në ATP, duke qënë se vendimi nuk është përcjellë për regjistrim nga organi që ka nxjerrë aktin, por është dorëzuar nga vetë përfituesi.

Në këto rrethana, ZVRPP duhet ti kishte vepruar në zbatim të nenit 45 të ligjit 33/2012, UKM nr. 2/2012 dhe Rregullores nr. 184, ku ti kërkonte ATP-së konfirmimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit e Pronave ish-Pronarëve Gramsh **“Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave z. H.R”**.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Nenin 45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
- 2) Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012
- 3) Pikës 10.4, Kreu IV Rregullores nr.184, datë 08.04.1999

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Flamur Hasa me detyrë ish-regjistruar.

Z. Nerënxa Zhupani me detyrë specialiste

Z. Xhilson Bajrami me detyrë Regjistruar.

Për problemet e trajtuar më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 2, datë 28.05.2019.

Pika 2. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona (bashkëpunimi dhe korespondenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit Elbasan).

Në zbatim të pikës “2” të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i kërkuar për auditimin mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurisë të paluajtshme përfituar sipas dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve për regjistrim fillestar, ndarje e bashkim pasurie, e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar në bazë të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01.04.2019.

Auditimi u krye duke u bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore të përfitimit të pronësisë mbi tokën si vijon :

-Referuar gërmeve ‘b’, dhe ‘ç’, pika 1, të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)”, në të përcaktohet që

Regjistrimi i fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme me aktin e marrjes së tokës në pronësi, në vijim AMTP, të nxjerrë në zbatim të ligjeve nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, ..., bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenet 25 e 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pas verifikimit nëse AMTP-ja përmban elementet e mëposhtme të formës dhe përmbajtjes:

Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, duke përfshirë nënshkrimin e kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës;

Njërën nga vulat e mëposhtme:

Vulën e komitetit ekzekutiv të fshatit;

Vulën e kryeplakut;

Vulën e komunës/bashkisë;

Vulën e ndërmarrjes bujqësore;

Vulën e këshillit të rrethit/këshillit të qarkut.

-Referuar gërmeve ‘b’, pika 2.2, të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)”, në të përcaktohet që

‘Kur gjatë verifikimit rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera nga punonjësit, që përpunojnë praktikën, i referohen regjistruarit në formë të shkruar, duke treguar hollësisht mangësitë e konstatuara. Regjistrimi në origjinë i tokës bujqësore ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin në rastet kur:

është kryer në bazë të akteve të marrjes së tokës në pronësi, me mungesë të një apo më shumë elementeve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të këtij udhëzimi’

-Referuar gërmeve ‘c’, pika 2.2, të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)”, në të përcaktohet që

Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet “i” dhe/ose “ii” të shkronjës “b” të kësaj pike, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në vijim KV.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

-Referuar gurmës ‘a/i’, pika 3.1, të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, në të përcaktohet që:

Për rastin e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 3, ZVRPP-ja procedon me regjistrimin e saj në favor të përfituesit duke ndjekur rregullat e mëposhtme: a) Për AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, pasi të plotësohen njëherësh këto kushte:

i) AMTP-ja të përmbajë të gjitha elementet e formës dhe të përmbajtjes, të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi

Përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, pika 1, gerrat ‘b’ dhe ‘c’ dhe pika 2.2, gerra ‘ç’, lidhur me plotësimin e kërkesave për formën dhe përmbajtjen e AMTP-ve dhe mungesën e bashkëpunimit dhe disponimit ligjor me KV Prefekti Gramsh

-Referuar gurmës ‘c’, pika 2.2, të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, në të përcaktohet që:

‘Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet “i”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore e pasqyruar në AMTP. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, si dhe argumentimin e mangësive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që konstatojnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjeneralitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit.

-Pas verifikimit të mangësive, bashkia duhet të kthejë, zyrtarisht, përgjigje në ZVRPP, duke plotësuar mangësitë e evidentuara. Plotësimi i mangësive nuk bëhet në AMTP-në konkrete, por duke i përshkruar ato shkresërisht”

Përcaktimet ligjore të bëra në Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, Kreu IV, pika 1, lidhur me mos plotësimin e kërkesave për formën dhe përmbajtjen e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Gramsh, sipas Vendimit të KM nr. 556, datë 23.10.2000

-Referuar pikës 1, Kreu IV, i Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, në të përcaktohet që:

‘Menyra e Regjistrimit Fillestar të drejtat e pronësisë si dhe kufijtë e çdo pasurie të paluajtshme, vertetohen me paraqitjen në ZRPP të dokumentave të mëposhtme. Për secilin rast është dhënë edhe legjislacioni përkatës për t’u konsultuar:

-Pasuritë e paluajtshme të njohura nga Ligji Nr.7501, datë 19.07.1991, “Për Tokën”:

‘Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi ose Përdorim’

-Përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, nenet 1, 2, 3, lidhur me llojet e tokës që shpërndahet sipas këtij ligji, ku nuk përfshihen tokat “Pa Frut” dhe “Pus naftë”.

-Referuar nenit 3, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Toka bujqësore u jepet në pronësi ose në përdorim personave juridike a fizike vendas pa shpërblim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

-Përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.8752, datë 26.03.2001, 'Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës', të ndryshuar, neni 11, lidhur me ndryshimin e zërave kadastralë, nga toka "Pa Frut" dhe 'Pus nafte', në tokë "Arë".

-Referuar nenit 11/1, pika 5, të ligjit nr.8752, datë 26.03.2001, 'Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës', të ndryshuar, në të përcaktohet që: Ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo të organit të qeverisjes vendore, i cili e ka në pronësi ose në përdorim këtë resurs, dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

-Përcaktimet ligjore të bëra në Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, Kreu IV, pika 13 dhe në Urdhrin e Kryerregjistruesit nr. 3191, datë 11.05.2012 "Unifikimi i procedurave të rregjistrimit të pasurive "truall+ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në VKM 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", të shfuqizuar", lidhur me mungesën e nënshkrimit të pronarëve përfitues për trojet dhe ndërtesat në zonën urbane të fshatrave.

-Referuar pikës 13, Kreu IV, i Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, në të përcaktohet që:

'Regjistrimi i trojeve dhe shtëpive në zonat urbane të fshatrave në baze të VKM Nr.432, datë 14.8.1995 bëhet në bazë të "Listës emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive"

-Referuar listës emërore, bashkëlidhur VKM 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit".

Nga auditimi rezultoi që:

I. ZVRPP Gramsh ka kryer regjistrimin e pasurive "Truall" dhe "Ndërtesë", në zonën urbane të fshatit "Zgjupe Kodër" për Zonën Kadastrale: 2184, sipas dokumentit "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", prej nga u konstatua se:

- "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të ZK 2184, fshatit Zgjupe Kodër nuk është firmosur nga pronarët e trojeve. Lista përmban gjithsej 42 pronarë dhe nuk ka asnjë shënim mbi numrin e familjeve që janë banuese në fshat me datë 1.08.1991.

ZK 2184, Zgjupe, Kodër ; Ref. 0077

Me kërkesë nr. 299, datë e aplikimit 11.05.2018 qytetari S.M ka kërkuar ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 648, datë 25.02.1992, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Pranimi i dokumentacionit është bërë specialiste N.Z.

Bazuar në marrëveshjen me nr. Repertori 427 dhe nr. 183 Koleksionit, të hartuar nga noteria G.H e Zyrës së noterisë Gramsh, katër subjektet pjesëmarrës në aktin noterial të paraqitur të quajtur S. M, Z.M, S.M dhe A.M pjestojnë pasuritë e mëposhtme :

- Pasuria nr. 389/1 adresa Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 3300 m² regjistruar në Vol 2, faqe 161, lëshuar vertetim pronësie me nr. 567738 firmosur nga rregjistruesi F.H.

- Pasuria nr. 340, adresa Gramsh Zgjupe, e llojit arë me sipërfaqe 1425 m², regjistruar në vol 1 faqe 51, lëshuar vertetim pronësie me nr. 567835 firmosur nga rregjistruesi F.H.

- Pasuria nr. 266, me adresë Zgjupe Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 300 m² truall nga e cila ndërtesë 128m², lëshuar vertetim pronësie me nr. 567737 firmosur nga rregjistruesi F.H.

- Pasuria nr. 339 adresa Zgjupe Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 1650 m² regjistruar në. vol 1 faqe 50, lëshuar vertetim pronësie me nr 567734 firmosur nga rregjistruesi F.H.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

-Pasuria nr. 264 adresa Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 1000 m2 regjistruar në vol 1 faqe 184, t lëshuar certifikatë pronësie nr 567735 datë 17.04.2014 firmosur nga rregjistruesi F.H.

- Pasuria 273 adresa Zgjupe Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 1200 m2 regjistruar në vol 2 faqe 86 lëshuar vertetim pronësie me nr. 1585242 datë 23.04.2018 firmosur nga rregjistruesi X.B.

Gjithsejt pasuria për t'u pjestuar midis 4 pjestarëve është shuma 8875 m2(S. dhe S.M 650 m2 + Z.M 5725 m2 dhe A.R 1500 m2.

Në marrëveshje cilësohet se dy pjestarë të familjes bujqësore sipas gjendjes familjare të certifikatës me datë 1.08.1991 i kanë marrë më parë pjesët e tyre. Bshkëlidhur praktikës gjendet(fotokopje dhe vulë të palexueshme), akti i pjestimit të pasurisë nga noteri N.G. i Zyrës noterisë Gramsh me nr. 140 Rep , i firmosur nga 6 pjestarët e familjes bujqësore, ku familja e re regjistron pasuritë e pa lujtëshme si më poshtë :

-Bashkëpronari G.M për sipërfaqen 3300 m2 pasuria 364 sipas nr. 207 repertorit dhe nr 188 kol datë 22.03.2000 dhe kartelës nr. serial 567738, pasuria 389/1, vol 2 faqe 161 tokë e llojit arë firmosur datë 17.04.2014 certifikata e pronësisë nga regjistruesi F.H.

- Bashkëpronari N.M. pjestim nr. pasurie 389 sipërfaqe 1500 m2, 149 rep nr 9 kol datë 3.02.1999, firmosur certifikata e pronësisë nga rregjistruesi F.H.

Nga auditimi rezulton se: Në ZVRPP Gramsh në emër të pronarit të familjes bujqësore Safedin M.M ekzistojnë dy AMTP, një me nr. 648 datë 25.02.1992 për sipërfaqen gjithsejt 10800 m2, me pasuritë me zë kadastral nr. 364, 389, dhe 293 firmosur nga kryetari i komisionit të ndarjes së tokës I.M dhe përfaqësuesi i rrethit I.Z dhe AMTP tjetër me sipërfaqe totale 7800 m2 firmosur nga komision tjetër i ndarjes së tokës F.M dhe përfaqësuesja e rrethit Z.C. Gjithashtu në këtë të fundit vula është e palexueshme si dhe në ZVRPP mungon lista e ndarjes së tokës për frymë sipas fshatrave.

- Në ZVRPP Gramsh mungon AMTP origjinale ku sipërfaqja e përgjithshme e familjes bujqësore rezulton se të jetë regjistruar 13025 m2. Pra nga ZVRPP është regjistruar me shumë 2225 m2 tokë bujqësore.

ZVRPP Gramsh ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar neni 34 "Bashkimet dhe ndarjet" pika 1 citohet se: *Me kërkesën me shkrim të pronarit të vetëm apo të të gjithë bashkëpronarëve për ndarjen e një pasurie të paluajtshme në dy a më shumë pjesë të kësaj pasurie, rrregjistruesi bën regjistrimin e ndarjes, duke mbyllur kartelën për pasurinë e paluajtshme që ndahet, hap kartela të reja dhe përditëson hartat kadastrale për pasuritë e paluajtshme të reja, që dalin nga ndarja dhe regjistron në kartelat e reja të gjithë informacionin që kishte kartela e mbyllur.*

3. Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, pronarët dorëzojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme certifikatën origjinale të pasurisë që do të bashkohet ose do të ndahet, si dhe pajisen me certifikata të reja pronësie për pasuritë e krijuara. ZVRPP Gramsh ka vepruar në kundërshtim me vendim KM nr. 994, datë 9.12.2015për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi ku citohet:

1. Regjistrimi i fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, me aktin e marrjes së tokës në pronësi, në vijim të AMTP-së, të nxjerrë në zbatim të ligjeve nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, nr. 57/2012, "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore", nr. 171/2014,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

“Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, dhe të vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore”, të ndryshuar, bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenet 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pas verifikimit nëse AMTP-ja përmban elementet e formës dhe përmbajtjes, si më poshtë vijon:

b) Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, që përfaqësohet nga kryetari i komisionit të ndarjes së tokës, për aktet e lëshuara deri në 15.8.2008, ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për AMTP-të e lëshuara në zbatim të ligjeve nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014;

c) Të dhënat identifikuese të pasurisë/ve të dhëna në pronësi: ku detyruese janë numri kadastral apo toponimi i ngastrës/ve, sipërfaqja dhe lloji i tokës bujqësore;

ç) Njërën nga vulat

d) Përputhjen e llojit të pasurisë së disponuar me AMTP-në me ndonjërin nga llojet e pasurive të kadastruara në zërin “Tokë bujqësore”, më 1.8.1991, të përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar;

dh) AMTP-në origjinale ose të njësuar me origjinalin, apo dublikatën e lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore apo këshilli i qarkut.

b) Kur, gjatë verifikimit, rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera, nga punonjësit që përpunojnë praktikën, i referohen rregjistruarit, me shkrim, duke treguar, hollësisht, mangësitë e konstatuara.

iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

c) Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet “i”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore e pasqyruar në AMTP. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, si dhe argumentimin e mangësive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që konstatojnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjeneralitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit. Pas verifikimit të mangësive, bashkia duhet të kthejë, zyrtarisht, përgjigje në ZVRPP, duke plotësuar mangësitë e evidentuara. Plotësimi i mangësive nuk bëhet në AMTP-në konkrete, por duke i përshkruar ato shkresërisht.

ç) Kur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme AMTP-ja administrohet në fotokopje ose mungon, ZVRPP-ja, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, i drejtohet mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë këshillit të qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP. Kërkesës i bashkëlidhet edhe një kopje e akteve/dokumenteve që disponon ZVRPP-ja. Mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia dhe DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, kthejnë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike. Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, bashkia përkatëse, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga ZVRPP-ja, ku përfshihet edhe kopja e AMTP-së, bën verifikimin faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore dhe plotëson AMTP-në, me shënimin dublikatë, e cila i dërgohet,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

zyrtarisht, zyrës së regjistrimit. Në rastin kur mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopje të AMTP-së, mbajtësi i parë i titullit të pronësisë i drejtohet, me kërkesë, bashkisë, për plotësimin e AMTP-së, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, ose të ligjeve nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014.

d) Kur sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP-në, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre, ZVRPP-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune, nga data e konstatimit, vë në dijeni mbajtësin e parë të titullit të pronësisë dhe bashkinë për të bërë saktësimin e planvendosjes, sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë me AMTP. Në këtë rast, bashkia konfirmon planvendosjen dhe e përcjell atë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pranë ZVRPP-së, shoqëruar me relacionin përkatës dhe deklaratën noteriale të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, në të cilën shprehet se ai është dakord me saktësimin e bërë. Në rast se sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP, del më e madhe se sipërfaqja e regjistrimit fillestar të tyre, e pasqyruar në kartelat respektive, zyra vendore e regjistrimit vijon me realizimin e shërbimit të aplikuar, sipas të dhënave të AMTP-së.

Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë nuk dorëzon deklaratën noteriale, që është dakord me saktësimin e bërë, dhe ZVRPP-ja ka lëshuar më parë certifikatën e pronësisë për këtë pasuri të paluajshme, rregjistruesi bën shënimin në kartelën e pasurisë për mospërputhjen ndërmjet sipërfaqes së përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale. Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë nuk dorëzon deklaratën noteriale, që është dakord me saktësimin e bërë, dhe ZVRPP-ja nuk ka lëshuar më parë certifikatën e pronësisë për këtë pasuri të paluajshme, rregjistruesi bën shënimin në kartelën e pasurisë për mospërputhjen, ndërmjet sipërfaqes së përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale, dhe nuk e lëshon certifikatën e pronësisë, duke argumentuar, me shkrim, mospërputhjen e konstatuar.

c) ATMP-ja të përcillet zyrtarisht për regjistrim nga njësia e qeverisjes vendore;

ç) subjektet, në favor të të cilëve është lëshuar AMTP-ja, të kenë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

- Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korrigjimi dhe saktësimi i tyre, bashkitë, me shpenzimet e tyre, ngarkojnë punonjës, topografë të licencuar, për përgatitjen e tyre. Planvendosjet, detyrimisht, duhet të jenë të konfirmuara nga bashkia përkatëse.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh ku shprehet se bazuar në aktin e pjestimit të pasurisë me nr. Rep 427 dhe nr. Kol 183 i hartuar nga noteri për bashkëpronarët të cilësuar në akt kërkojnë pjestimin e pasurisë së tyre referuar akt marrëveshjes të përcaktuar me vullnetin e tyre të lirë, kemi bërë regjistrimin në zbatim të pikës 5 neni 45 i ligjit nr. 33 /2012, "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", sipas certifikatave të pronësisë me të dhënat reale të pronës në kartelë dhe hartë treguese të certifikuara pranë zyrës qysh në vitin 1999 dhe në vitin 2014, nuk ka lidhje me VKM 994 dt. 09.12.2015, por me verifikimin nga specialisti i regjistrimit për kryerjen e cdo veprimi deri në origjinë dhe kur ka parregullsi kërkojnë plotësimi i sakte i dokumentacionit.

ZK. 1392 ref. 0418, fshati Cerujë.

Me kërkesë nr. 92 dhe 93, datë e aplikimit 13.02.2018 qytetari N.M ka kërkuar regjistrimin e trashëgimërisë së pasurisë sipas vendimit të noterit K.M e noterisë Gramsh për pasuritë sipas AMTP nr. 6726, datë 23.07.1993, për pasurinë nr. 37/1 sip. 1400 m2, nr.6/49 sip 2000 m2, nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

73.10 sip 2800 m², nr. 71/23 sip 1500 m², nr. 32/29 sip 1260 m², 17/24 sip 1400 m² dhe pasuria 24/4 sip 600 m² gjithsejt sipërfaqe 10960 m².

Për sa sipër sipas shkresës nr. 815/1 datë 05.02.2018, të Bashkisë Gramsh në zbatim të VKM nr. 994 datë 09.12.2015, dhe urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 144 datë 01.09.2016 “Për krijimin për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi” është certifikuar kjo AMTP në emër të z. N.M për 4 pasuri mr nr. 38/9 vol 2 faqe 63, me sipërfaqe 1500 m², nr. 17/24 vol 2 faqe 64, sipërfaqe 1400 m², nr. 6/49 vol 2 faqe 60 sipërfaqe 1900 m², pasurinë 73/10 vol 2 faqe 61 sipërfaqe 2800 m², gjithsejt sipërfaqe 7600 m².

Faktikisht në Zk 1392 janë regjistruar pasuritë me nr. 38/39 për sipërfaqe 1500 m² vol 2 faqe 63, nr. 17/24 për sipërfaqe 1400 m², vol 2 faqe 64, nr. 6/49 me sipërfaqe 1900 m² vol 2 faqe 60, nr. 73/10 me sipërfaqe 2800 m² vol 2 faqe 61, nr. 66/1 vol 2 faqe 15 me sipërfaqe 1600 m² gjithsejt sipërfaqe 9200 m² pra më shumë sipërfaqe 1600 m² se sa është certifikuar nga KV. Pranuese e dokumentacionit specialiste N.Z. ndërsa kartelat e pasurive mbajnë datën 23.02.2018.

Nga auditimi rezulton se në ZVRPP Gramsh gjendet AMTP 6726, datë 23.07.1993 origjinale dhe vulë të lexueshme, e firmosur nga Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës në fshat Z.A dhe përfaqësuesi i rrethit S.X.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se bashkëlidhur praktikës gjendet shkresa nr. 815/1 datë 05.02.2018, sipas së cilës janë certifikuar pasuritë e familjes N.M gjithsejt 7600 m² tokë bujqësore, ku rezulton më pak 3300 m² nga sa ka regjistruar me AMTP tjetër me nr. 134 e cila nuk gjendet në arkivën e ZVRPP Gramsh.

Në krahasim të këtyre AMTP-ve dhe veprimeve të kryera nga KV dhe ZVRPP Gramsh rezulton që, AMTP e përcjellë me shkresë përcjellëse nr. 815/1, datë 05.02.2018, nuk duhej marrë parasysh për regjistrimin e pasurive mbasi në ZVRPP dokumentacioni i paraqitur ka shkelje dhe mangësi të theksuara, si mungesa e deklaratës noteriale të pronarit për pranimin e sipërfaqeve të certifikuara, njoftimi i ndaj kufiarve për ndryshimet të pronës së certifikuar. AMTP duhej dërguar në KV për verifikimin e ligjshmërisë së saj. Nga ZVRPP nuk është përgatitur relacioni në lidhje me këtë AMTP veprime që nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes duke vepruar në kundërshtim me pikën 2.6, germa “b” sipas të cilit në rastin e konstatimit të mungesës së AMTP të elementëve të formës dhe përmbajtjes “...rregjistruesi nxjerr urdhër për kufizimin e veprimeve mbi pasurinë, deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore.”

Lidhur me observacionin e paraqitur është mbajtur qëndrimi mëparshëm i ZVRPP Gramsh për pasuritë 92 dhe 93 datë 13.02.2018 me referencë nr. 0418. Shtetësja N.M ka aplikuar për regjistrim dëshmi trashëgimie për të ndjerin N.M si dhe certifikim të pasurisë të përfutur në bazë të Ligjit 7501 datë 19.07.1991, i cili është objekt i VKM Nr. 994 dt 15.12.2015 dhe i shqyrtimit nga Bashkia Gramsh. Rregjistrimi kryhet nga ZVRPP si ndarje për pjesën e përfutur në zbatim të ligjit 7501 datë 19.07.1991 për tokën me AMTP- në nr. 6726 datë 23.07.1993 në total 10960m² dhe pas këtij veprimi rregjistrimi bëhet si bashkim prone për pjesën e trashëguar.

ZK. 2167 ref. 0887, fshati Kocaj.

Me kërkesë nr.469, datë e aplikimit 22.08.2018 qytetari P.K ka kërkuar regjistrimin e pasurisë së fituar sipas AMTP nr. 6447 datë 10.10.1993 bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, për pasuritë nr. 6213, sipërfaqe 2500 m², nr. 53/14 sip. 800 m², nr.55/9 sip



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

pemtore 2000 m2, nr. 12/11 sip 2000 m2, nr. 1236 sip. 900 m2 (Me korigjim me bojë të kuqe)) nr. 154/29 sip. 1000 m2 si dhe pasuri pa nr. sipërfaqe 400 m2 dhe 1000 m2, gjithsejt sipërfaqe 10600 m2.

Nga auditimi rezulton se bashkëlidhur praktikës gjendet AMTP 6447, datë 10.10.1993 origjinale dhe vulë të palexueshme, e firmosur nga Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës në fshat P.K dhe përfaqësuesi i rrethit N.A. AMTP paraqitet me korigjime dhe është e arkivuar në ZVRPP Gramsh.

Bashkëlidhur praktikës nuk gjendet çertifikata familjare e datës 1.08.1990 për përbërjen familjare të familjes P.K.

Nga auditimi rezulton se qytetari është njëkohësisht edhe kryetar i komisionit për ndarjen e tokës si dhe për pasurinë 55/9 të regjistruar në vol 1, faqe 134 është paisur me çertifikate pronësie në vitin 2002 firmosur nga ish rregjistruesi B. K, për sipërfaqen 3200 m2, kur në AMTP pasuria 154/9 vol 1 faqe 133 figuron 2000 m2, pra më shumë 1200 m2.

Faktikisht në Zk 2167, janë regjistruar pasuritë me nr. 55/14 për sipërfaqe 2000 m2 vol 1 faqe 92, nr. 62/22 për sipërfaqe 1000 m2 vol 1 faqe 91, regjistruar fillimisht pronë shtet, pasuria nr 62/15 me sipërfaqe 1000 m2 vol 1 faqe 69 me shënimin në seksionin E të kartelës si pasuri e okupuar nga z P.K, nr. 55/15 me sipërfaqe 1200 m2 vol 1 faqe 93, nr 55/9 vol 1 faqe 134 me sipërfaqe 3200 m2 gjithsejt 8400 m2. Pranuese e dokumentacionit specialiste Nerenza Zhupani ndërsa kartelat e pasurisë mbajnë datën 23.02.2018 dhe janë firmosur nga rregjistruesi X.B.

Në krahasim të këtyre AMTP-ve dhe veprimeve të kryera nga KV në Bashki, ZVRPP Gramsh nuk duhet të vepronte për regjistrimin e pasurive mbasi dokumentacioni i paraqitur ka shkelje dhe mangësi të theksuara, si njoftimi i ndaj kufiarve për ndryshimet të pronës së çertifikuar, AMTP duhet dërguar në KV për verifikimin e ligjshmërisë së saj dhe nuk është përgatitur relacioni në lidhje me këtë AMTP nga ZVRPP, veprime që nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes. Për sa më lartë është vepruar në kundërshtim me pikën 2.6, germa b sipas të cilit në rastin e konstatimit të mungesës së AMTP të elementëve të formës dhe përmbajtjes *"...rregjistruesi nxjerr urdhër për kufizimin e veprimeve mbi pasurinë, deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore."*

Shqyrtuam me vemendje observacione paraqitur nga ZVRPP Gramsh datë 10.06.2019 firmosur nga specialistja N.Z dhe Drejtori X.B i të cilët shpjegojnë se veprimet e regjistrimit janë bërë vetëm për një pasuri dhe me vonë është konstatuar vendodhja jo saktë e nje pasurie për të cilën është lëshuar çertifikatë. Në këtë rast nga ZVRPP bëhet verifikimi në total i pasurive dhe bëhet regjistrim i ri duke saktësuar gjithë sipërfaqen e dhënë sipas AMTP-së.

ZK. 3337 ref. 0216 fshati Gurrë, Me kërkesë nr.649, datë e aplikimit 09.11.2018 qytetari N.M ka kërkuar regjistrimin e pasurisë së fituar sipas AMTP nr. 1624, datë 24.04.1993 për sipërfaqen gjithsejt 8695 m2, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar. Kjo AMTP sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 1400/1 datë 26.02.2018, është çertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Sipas relacionit bashkëlidhur praktikës pas verifikimeve në vend Komisioni i lartpërmendur ka çertifikuar z. N.M sipërfaqen gjithsejt 8395 m2.

Nga auditimi konstatohet se për çertifikimin e AMTP nr. 1624, datë 24.04.1993, Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufiarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar. Në raste të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

tilla komisioni i verifikimit të bashkisë njofton pronarët dhe kufiarët për zgjidhjen e çështjes deri në rrugë gjyqësore.

ZK 2764 , Referenca 0084

Me kërkesë nr. 36, datë e aplikimit 15.01.2018 qytetari H.S ka kërkuar regjistrimin e pasurisë së fituar sipas AMTP nr. 2688 datë 15.06.1992 për sipërfaqen gjithsejt 24300 m2, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar. Kjo AMTP sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 8747/1 datë 19.12.2017, është çertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Sipas relacionit bashkëlidhur praktikës pasverifikimeve në vend Komisioni i lartpërmendur ka çertifikuar z H.S pronar për sipërfaqen gjithsejt 21095 m2, e përbërë nga pasuria nr. 91/16 me sip 10000 m2 ,(plan vendosja 7800 m2)nr. 70/3 me sip 7400 m2 (plan Vendosja 6735 m2), por e përfshire dy herë dhe e çertifikuar me siperfaqe 1700 m2, nr. 18/31 sip truall 300 m2.

-Sipas AMTP, KV ka çertifikuar në mënyrë të pjesshme vetëm pasurinë 70/3/ me sipërfaqe 7400 m2 duke dhënë shpjegimet se sipas plan vendosjes dhe matjeve në vend ajo përbëhet nga pasuria 92/2 me sipërfaqe 5700 m2 dhe pasuria 70/3 me sipërfaqe 1700 m2.

Sipas relacionit të bashkisë, bazuar në kërkesën e qytetarit H.S rezulton se është kërkuar rregjistrim e pjeshëm vetëm për pasurinë 92/2 me sipërfaqe 5700 m2.

Nga auditimi konstatohet se për çertifikimin e AMTP nr. 2658, datë 15.06.1992, Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufiarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar .Gjithëashtu praktikës i mungon çertifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991.

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM nr. 994 datë 09.02.2015 pasi :

Ka marrë në shqyrtim dy herë të njejtat pasuri e për rrjedhojë i bën të pa vlefshme të dy këto çertifikime.

ZK.2764 ref. 0087 dhe ref 0084 fshati Nartë,

Me kërkesë nr. 584, datë e aplikimit 20.10.2018 qytetari H.S ka kërkuar regjistrimin e pasurisë së fituar sipas AMTP nr. 2688, datë 15.06.1992 për sipërfaqen gjithsejt 24300 m2, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar. Kjo AMTP sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 6386/1 datë 28.09..2018, është çertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Sipas relacionit bashkëlidhur praktikës pas verifikimeve në vend Komisioni i lartpërmendur ka çertifikuar z H.S jo sipërfaqen gjithsejt sipas AMTP por, ka çertifikuar në mënyrë të pjesshme vetëm pasurinë 70/3/ me sipërfaqe 7400 m2 duke dhënë shpjegimet se sipas plan vendosjes dhe matjeve në vend ajo përbëhet nga pasuria 92/2 me sipërfaqe 5700 e regjistruar në fakt në vol 3 faqe 26 me sipërfaqe 5535 m2. m2. (Kjo pasuri e çertifikuar më parë sipas ref 0084) dhe pasuria 70/3 me sipërfaqe 1700 m2.

Sipas relacionit të bashkisë, bazuar në kërkesën e qytetarit H.Sh rezulton se është kërkuar rregjistrim e pjeshëm vetëm për pasurinë 92/2 me sipërfaqe 5700 m2.

Nga auditimi konstatohet se për çertifikimin e AMTP nr. 2658, datë 15.06.1992, Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufiarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar .Gjithëashtu praktikës i mungon çertifikata familjare e pronarit me datë 1.08.1991.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM nr. 994, datë 09.02.2015 pasi :

-Në çdo rast, nëse ZVRPP-ja konstaton se lloji i pasurisë “tokë bujqësore” (arë, vreshtë, ullishtë, pemishte), dhënë me AMTP, nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me nismën e vet apo me kërkesë të mbajtësit të titullit të pronësisë, kërkon informacion nga DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, për zërin kadastral të ngastrës, sipas regjistrave kadastralë më datë 1.8.1991. Nëse konstatohet:

a) parregullsi në sistemin e regjistrimit, korrigjohet zëri kadastral në kartelën përkatëse; b) shkelje e nenit 2, të ligjit nr. 9948/2008, ZVRPP-ja i drejtohet komisionit vendor respektiv, me relacion të argumentuar, me qëllim shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të AMTP-së konkrete.

Pika 2.2. Kur pasuria e fituar me AMTP figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë, si më poshtë vijon:

b) Kur, gjatë verifikimit, rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera, nga punonjësit që përpunojnë praktikën, i referohen rregjistruarit, me shkrim, duke treguar, hollësisht, mangësitë e konstatuara. Regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:

i) është kryer me mungesën e një apo më shumë elementeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

Sa më sipër Komisioni i Verifikimit duhet të rakordojë gjithë sipërfaqen e pasqyruar në ATM pamvarësisht se bazuar në kërkesën e qytetarit mund të autorizojë për regjistrim të pjesshëm.

ZK.2764 ref. 1409 fshati Cingo i Sipërm,

Me kërkesë nr. 99, datë e aplikimit 15.02.2018 qytetari H.Z ka kërkuar regjistrimin dëshmisë së trashëgimisë nga trashëgimlënësi S.L. Pasuritë janë të fituara sipas AMTP nr. 154, datë 16.03.1991 për sipërfaqen gjithsejt 12000 m², sipas në ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar. Kjo AMTP, sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 816/1 datë 052.02.2018, është çertifkuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Sipas relacionit bashkëlidhur praktikës pas verifikimeve në vend Komisioni i lartpërmendur ka çertifkuar z. S.L sipërfaqen gjithsejt sipas AMTP sipërfaqen 11700 m² tokë arë dhe truall më pak nga AMTP sipërfaqe 300 m².

Nga auditimi konstatohet se për çertifikimn e AMTP nr.154, datë 15.06.1992, Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufiarëve të pronarit për tu shprehur se nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifkuar Gjithëashtu praktikës është bashkëlidhur çertifikata familjare e pronarit me datë 1.08.1991 e përbërë prej 5 vetave. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit Cingar i Sipërm rezulton se është 1700 m². Familja e z. Sh.L e përbërë prej 5 vetash i takon 8500 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe çertifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 11700 m², pra me shumë sipërfaqe 3200 m².

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM Nr 994 datë 09.02.2015 pika 1.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Për sa sipër mbajnë përgjegjësi komisioni i ndarjes së tokës në fshat i përbërë nga kryetari S.Z, përfaqësuesi i rrethit R.Z dhe ish rregjistruesi F. H.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehem i pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK.2764 ref. 0083 fshati Nartë Gramsh.

Me kërkesë nr. 1443, datë e aplikimit 27.12.2017 në ZVRPP Gramsh është paraqitur qytetari R.C i quajtur me emër tjetër R.C i identifikuar me vertetim të gjendjes civile të njësisë Adiminstrative Gramsh. Z. R.C është pronar sipas AMTP 2671, datë 1.12.1993 për sipërfaqen 2500 m2, njëkohësisht sipas deklaratës noteriale datë 26.12.2017 është vëlla me z P. C i cili është pronar me AMTP 2672 datë 7.01.1992, për sipërfaqen 8800 m2.

Bashkëlidhur praktikës nuk gjendet shkresa zyrtare e ZVRPP Gramsh që duhet ti drejtohej KVTP për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë. Gjthëashtu bashkëlidhur praktikës nuk ka shkresë së Bashkisë Gramsh me relacion për shpjegimet që sjellin ndryshimet e këtyre pasurive të regjistruara më parë duke i riçertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Në Volumet e ZVRP nuk është evidentuar sipërfaqja 300 m2 truall dhe ndërtesë e paraqitur në AMTP.

Nga auditimi konstatohet se për certifikimn e AMTP-ve nuk janë marrë deklaratat noteriale të kufiarëve për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e tyre për tu shprehur se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Praktika nuk ka të bashkëlidhur certifikatat familjare të pronarëve R.C dhe P.C me datë 01.08.1991 për përbërjen familjare të tyre.

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM Nr 994 datë 09.02.2015 pika 1. Nga sa më sipër ZVRPP Gramsh duhet të refuzonte regjistrimin e pasurive të mësipërme bazuar në VKM Nr. 994, datë 09.12.2015 pika 3.2 *Për AMTP-të e lëshuara nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë", ZVRPP-ja procedon me regjistrimin e saj në favor të përfituesit me AMTP, pasi të plotësohet kushti që:*

a) AMTP-ja të përmbajë elementet dhe dokumentacionin shoqërues, të përcaktuar me vendimin nr. 224, datë 19.2.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)". Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV), për plotësimin e mangësive. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit dhe argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhen edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/ dokumenteve që përmbajnë këto mangësi. Ky njoftim i dërgohet edhe subjektit përfitues; b) ATMP-ja dhe dokumentacioni që e shoqëron atë të përcillet zyrtarisht, për regjistrim, nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë (KV); c) subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP, pika 4. Në rastet kur në ZVRPP pasuria figuron e regjistruar si pasuri shtetërore dhe AMTP-ja ndodhet në ZRPP, procedohet, si më poshtë vijon:

a) ZVRPP-ja dërgon në bashkinë përkatëse një kopje të njësuar me origjinalin e AMTP-së;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

b) Bashkia kryen veprimet, sipas pikës 3, të këtij vendimi. Pika 5. Në çdo rast, nëse ZVRPP-ja konstaton se lloji i pasurisë "tokë bujqësore" (arë, vreshtë, ullishtë, pemishte), dhënë me AMTP, nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me nismën e vet apo me kërkesë të mbajtësit të titullit të pronësisë, kërkon informacion nga DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, për zërin kadastral të ngastrës, sipas regjistrave kadastrale më datë 1.8.1991. Nëse konstatohet:

a) parregullsi në sistemin e regjistrimit, korrigjohet zëri kadastral në kartelën përkatëse; b) shkelje e nenit 2, të ligjit nr. 9948/2008, ZVRPP-ja i drejtohet komisionit vendor respektiv, me relacion të argumentuar, me qëllim shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të AMTP-së konkrete, pika 6. Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korrigjimi dhe saktësimi i tyre, bashkitë, me shpenzimet e tyre, ngarkojnë punonjës, topografë të licencuar, për përgatitjen e tyre. Planvendosjet, detyrimisht, duhet të jenë të konfirmuara nga bashkia përkatëse.

Për sa sipër për veprimet e mosveprimet në përputhje me dispozitat e cituara më lart mbajnë përgjegjësi ish rregjistruesi F.H specialistja N.Z si dhe komisioni i ndarjes së tokës në fshat i përbërë nga kryetari S.Z, përfaqësuesi i rrethit R.Z dhe ish rregjistruesi F.H.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK.2143, ref. 0021 fshati Kërpica

Me kërkesë nr. 1149 datë e aplikimit 29.06.2017 qytetari I.M ka kërkuar regjistrimin pasurisë të fituar sipas AMTP nr. 2351, datë 20.12.1999 për sipërfaqen gjithsejt 5174 m², bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar. Kjo AMTP sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 3968 prot. datë 07.06.2017, është çertifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave. Sipas relacionit bashkëlidhur praktikës pas verifikimeve në vend Komisioni i lartpërmendur ka çertifikuar z. I.M sipas AMTP sipërfaqen 5174 m² tokë arë .

Nga auditimi konstatohet se për certifikimin e AMTP nr.2351, datë 20.12.1999, Komisioni i lartpërmendur nuk ka bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufiarëve të pronarit se nuk kanë pretendime ndaj pronës së çertifikuar. Gjithëashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 1.08.1991 e përbërë prej nga 1 person. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Kërpica mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit rezulton se është 1700 m² dhe familjes I. M e përbërë prej 1 personi i takon 1700 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe certifikmit nga KV në Bashki ka përfituruar 5174 m², regjistruar ne ZK 2143 pasuria nr. 20/3 vpl 2 faqe 138, pra, me shumë sipërfaqe 3474 m².

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM nr. 994 datë 09.02.2015 pika 1.

Për sa sipër mbajnë përgjegjësi komisioni i ndarjes së tokës në fshat i përbërë nga Kryetari B.M, përfaqësuesi i rrethit H. D dhe ish rregjistruesi F. H si dhe Komisioni i përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK.2331 ref. 0030 fshati Kuretë,

Me kërkesë nr. 312 datë e aplikimit 21.05.201 qytetari E.H ka kërkuar regjistrimin pasurisë të fituar nëpërmjet aktit të trashëgimërisë nga babai tij V. H sipas AMTP nr. 3290 , datë s'ka, për sipërfaqen gjithsejt 24120 m², bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar. Kjo AMTP është regjistruar në pronësi të ndjerit në vol 1 faqe 66 pasuria nr. 144 sipërfaqe 300 m², nr. 152 faqe 67 sipërfaqe 8250 m², nr. 151 faqe 68 sipërfaqe 1100 m², nr. 156 faqe 69 sipërfaqe 3550 m², nr. 168 faqe 70 sipërfaqe 1900 m², nr. 149 faqe 71 sipërfaqe 2650 m², nr. 155 faqe 72 sipërfaqe 2350 m² gjithsejt 20100 m² më pak nga AMTP sipërfaqe 4020 m².

Nga auditimi i praktikës konstatohet se duke krahasuar normativën për fryme të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës i përbërë nga N. M Kryetarë dhe përfaqësuesi rrethit B. X me çertifikatën familjare të datës 1.08.1991 nr. 010325762, rezulton së përbërja familjare e V. H është prej 3 veta dhe i takojnë 6000 m² tokë. Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 14100 m².

Pasuritë e mësipërme janë regjistruar sipas aktit të trashëgimërisë datë 27.10.2016, hartuar nga noteria G.H e cila nuk ka përcaktuar të drejtën e trashëgimërisë duke u referuar pasurive parkatëse të ndjerit V.H. Ky veprim e bën aktin të pavlefshëm për efekt të regjistrimit të përbashkët të pronës.

Në vijim të auditimit rezulton se nga Bashkia Gramsh sipas shkresës nr. 2523/1 prot datë 17.04.2018, relacionit bashkëlidhur dhe plan vendosjes së pronave të hartuara nga topografi G.D, në zbatim të urdhërit nr. 144 datë 01.09.2016 të kryetarit të bashkisë, për krijimin e Komisionit të përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e aktit të tokës në pronësi, certifikon pronat nr. 149 me sipërfaqe 2650 m², nr. 151 me sipërfaqe 1100 m², nr. 156 me sipërfaqe 3550 m², nr. 152/2 me sipërfaqe 6000 m², nr. 144 me sipërfaqe 300 m². Gjithsjet në pronësi të z. V. H rezulton e certifikuar sipërfaqja 13600 m². Nga llogaritja rezulton se AMTP 3290 është plotësuar duke llogaritur sipërfaqen jo sipas numrit të frymëve të familjes paraqitur në certifikatën familjare të datës 1.08.1991.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK.1994 ref. 0029 fshati Jance Qendër,

Me kërkesë nr. 1421 datë e aplikimit 31.12.2017 qytetari A.K ka kërkuar regjistrimin pasurisë të fituar sipas AMTP nr. 1186, datë 08.01.1992 për sipërfaqen gjithsejt 28300 m², bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar.

Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për fryme të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës i përbërë nga F.K Kryetare dhe përfaqësuesi rrethit S.K dhe çertifikatës së përbërjes familjare të datës 1.08.1991 nr. 010326518 datë 07.10.2016 lëshuar nga nëpunësi i gjendjes civile M.S i Njësisë Administrative Tunjë rezulton së përbërja



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

familjare e A.K është prej 8 veta dhe i takojnë 23320 (8x2915) m² tokë. Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 4980 m².

Pasurite e mësipërme janë regjistruar sipas shkresës nr.7170 prot, datë 13.10.2017 të Bashkisë Gramsh, relacionit bashkëlidhur dhe plan vendosjes së pronave të hartuara nga topografi G.D. Nga ana e Komisionit të përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e aktit të tokës në pronësi certifikon pronat nr. 472/4 vol 1 faqe 27, me sipërfaqe 3600 m², nr, 472/1 vol 1 faqe 26 me sipërfaqe 4650 m², nr. 460/2 vol 1 faqe 25 me sipërfaqe 4125 m², nr 482/1 vol 1 faqe 24 me sipërfaqe 3100 m², nr 466/5/1 vol 1 faqe 23 me sipërfaqe 300 m², 92 m² ndertesë, nr. 466/5/2 vol 1 faqe 23 me sipërfaqe 3900 m², nr, 466/2 vol 1 faqe 22 sipërfaqja 450 m², nr, 457/6 vol 3 faqe 176 me sipërfaqe 5760 m² gjithsejt sipërfaqja certifikuar rezulton 25575 m² më shumë sipërfaqja 2255 m², ku AMTP 1186 datë 08.01.1992 është plotësuar duke llogaritur jo sipas frymëve në certifikatën familjare të datës 1.08.1991.

Nga Komisioni i verifikimit në Bashki dhe ZVRPP nuk është vepruar në përputhje të plotë me VKM Nr 994, datë 09.02.2015 pika 1.

Për sa sipër mbajnë përgjegjësi komisioni i ndarjes së tokës në fshat i përbërë nga Kryetari F. K përfaqësuesi i rrëthit dhe S.K ish rregjistruesi F.H si dhe Komisioni i përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK.1593 ref. 0030 fshati Mashan,

Me kërkesë nr. 354 datë e aplikimit 16.07.2018 qytetari T.Z ka kërkuar regjistrimin pasurisë të fituar sipas AMTP nr. 2958, datë 30.10.1992 për sipërfaqen gjithsejt 20700 m², bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar.

Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës konstatohet se të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës i përbërë nga N.H Kryetare dhe përfaqësuesi rrethit K.H, përgjegjësi i kadastrës B. K dhe certifikatës së përbërjes familjare të datës 1.08.1991 nr. 0011843748 datë 12.04.2017 lëshuar nga nëpunësi i gjendjes civile Ymer Kasmi i Njësisë Administrative Gramsh, rezulton së përbërja familjare e T.Z nga fshati Ermej është prej 7 veta dhe i takojnë 19600 m² (8x2800) m² tokë dhe jo 20700 sipas AMTP lartpërmendur. Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 1100 m².

Pasuritë e mësipërme janë regjistruar sipas shkresës nr.2755 prot, datë 24.04.2018 të Bashkisë Gramsh, relacionit bashkëlidhur dhe plan vendosjes së pronave të hartuara nga topografi G.D. Nga ana e Komisionit të përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e aktit të tokës në pronësi certifikohen pronat nr. 98/1 vol 1 faqe 189 me sipërfaqe 2000 m², nr, 93/7 vol 1 faqe 188 me sipërfaqe 6380 m², nr. 126 vol 1 faqe 190 me sipërfaqe 7000 m², nr. 6/1/1 vol 1 faqe 191 me sipërfaqe 5000 m², nr 98/3 me sipërfaqe 300 m², 87 m² ndertesë, gjithsejt sipërfaqja certifikuar rezulton 20680 m² më pak 20 m² sipërfaqja e AMTP nr 2598 datë 30.10.1992 është plotësuar duke llogaritur jo sipas sipërfaqes për frymë në certifikatën familjare të datës 1.08.1991.

Për sa sipër mban përgjegjësi Komisioni i ndarjes së tokës, përbërë nga N. H Kryetar dhe përfaqësuesi rrethit K.H, Komisionit të përpilimit të dokumentacionit për regjistrimin e aktit të tokës në bashki, speciaslistja N.Z.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK 3461, Ref 01048 , fshati Skanderbegas Gramsh.

Me kërkesë nr. 1218, datë e aplikimit 15.08.2017 qytetari M.S ka kërkuar ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 2450 ,datë 03.02.1994, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Pranimi i dokumentacionit është bërë specialiste N.Z.

Bazuar në marrëveshjen me nr. Repertori 917 dhe nr. 432 Koleksionit, të hartuar nga noteria Gentiana Haruni e Zyrës së noterisë Gramsh, shtatë subjektet pjesëmarrës në aktin noterial të paraqitur të quajtur B.S, K.H, V.B, S. S, J.S, S.S dhe M. S pjestojnë pasuritë e mëposhtme:

-Pasuria nr.179/5 ZK 3461 vol 5 faqe 226 sipërfaqe 2700 m² arë dhe truall 300 m², adresa Gramsh, lëshuar vertetim pronësie me nr. 459846 firmosur nga rregjistruesi F.H.

-Pasuria nr. 167/24 , adresa Gramsh , e llojit arë me sipërfaqe 3200 m², regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 224 lëshuar vertetim pronësie me nr. 459848 firmosur nga rregjistruesi F. H.

-Pasuria nr. 248/2, me adresë Gramsh, e llojit arë me sipërfaqë totale 2600 m² regjistruar ne ZK 3461 vol 1 faqe 76 , lëshuar vertetim pronësie me nr. 459849 firmosur nga rregjistruesi F.H.

-Pasuria nr. 254/6 adresa Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 2500 m² regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 228, lëshuar vertetim pronësie me nr. 459847 firmosur nga rregjistruesi F.H.

-Pasuria nr. 259/6 Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 2000 m² regjistruar në ZK 3461 vol 5 faqe 230, përpunesi i praktikës N.Zh me detyrë specialist, lëshuar certifikatë pronësie nr. 459850 datë 03.05.2015 firmosur nga rregjistruesi F.H.

Gjithsejt pasuria për tu pjestuar midis 4 pjestarëve sipërfaqe 13000 m²

Bazuar në certifikatën famljare të datës 02.05.2015 lëshuar dhe firmosur nga nëpunësja e gjendjes civile Gramsh znj. A. D, e cila konfirmon gjendjen familjare të familjes bujqësore me datë 01.08.1991, kërkesë e ligjit të lartpërmendur, rezulton se në pronesi të pronares (fb) S. S janë regjistruar dhe më pastaj janë përpjestuar pjestarëve sipërfaqja 13000 m² tokë bujqësore, nga e cila truall 300 m² e barabartë me sipërfaqen e AMTP nr. 2450 datë 2.02.1994. Në fakt sipas normativës për frymë dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 10000 m² (4x2500) pra më shumë sipërfaqja 3000 m².

Për sa sipër mbajnë përgjegjësi Komisioni i ndarjes së tokës në Komunë z G. P, përfaqësuesi i rrethit X. T dhe ish rregjistruesi F.H.

Lidhur me observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh shprehemi pjesërisht dakord sepse veprimet e gabuara vijnë nga Komisioni i certifikimit të titujve të pronësisë në Bashki, por ZVRPP në raste të tilla duhet të refuzojë kërkesën për regjistrim.

ZK 3494 referencë 0032, fshati Sotirë Gramsh.

Nga auditimi mbi depozitimin e AMTP-ve në ZVRPP Gramsh u kostatua se në emër të qytetarit M.M gjenden 2 AMTP me të njejtin numër 2236 viti 1993 e cila është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e saj, ndërsa AMTP 2236 viti 2000 me komision tjetër të ndarjes së tokës e pasaktë ku pronari i tokës nuk ka firmosur. Nga ZVRPP janë kryer veprime regjistrimi sipas AMTP së parregullt çka përbën shkelje të rëndë të zbatimit të ligjit 33/12 për regjistrimin e pasurive të fituara me ligjin nr 7501 datë 19.07.1991.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Nga auditimi i plotë konstatohet se me kërkesë nr. 4134, datë e aplikimit 11.09.2012 qytetari M.M ka kërkuar regjistrimin e pasurisë sipas AMTP nr. 2236 , datë 16.09.1992, me sipërfaqe gjithsejt 15310 m2, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Pranimi i dokumentacionit është bërë specialiste N.Z.

Bazuar në AMTP rezulton se për këtë qytetar veprimet e regjistrimit janë kryer jo sipas AMTP së rregullt nr. 2236 datë 16.09.1992 , e firmosur nga komisioni i ndarjes së tokës i përbërë nga I. G, përgjegjësi i zyrës së kadastrës B.K, emri i përfaqësuesit të rrethit i pa lexueshëm, por janë kryer me një AMTP tjetër me të njëjtin numër nr. 2236 datë 20.07.2000 e cila është e pa firmosur nga pronari dhe e lëshuar nga një komision tjetër i ndarjes së tokës i përbërë nga T.D dhe përfaqësuesi i rrethit H.D.

Bazuar në referencën 0032, datë 11.09.2012, pronari ka rregjistruar në ZRPP dhe është paisur me certifikatë pronësie për pasuritë e mëposhtme :

Pasuria nr. 192/6 me sipërfaqe 6300 m2 vol 1 faqe 93
Pasuria nr. 177/11 me sipërfaqe 1400 m2 vol 4 faqe 168,169
Pasuria nr. 180/16 me sipërfaqe 1940 m2 vol 4 faqe 166
Pasuria nr. 180/ 5 ne sipërfaqe 3060 m2 vol 1 faqe 195
Pasuria nr. 249/5 me sipërfaqe 300 m2 vol 1 faqe 96
Pasuria nr. 156/1 me sipërfaqe 600 m2 vol 1 faqe 92, e cila gabimisht figuron e mbyllur.

Duke analizuar gjendjen e pasurive sipas AMTP, LN printimi tretë dhe plan rlevimeve nga matjet në vend rezulton se :

Nr	Emri	AMTP Siperfaqe m2	Pasurite sipas LN	Pasuritë rilevimit sipas	Siperfaqe m2	Vjen ose vijon
163	Perroi Demirit	560	600	156/1	600	
158	Bizhanake (Gliqe)	1800	2750	Vol 2 faqe 246	0	shteti
82	Kumi Selimit	1250	1600	177/1 vol 4 f 168,	1400	Vol 1 f 97
192	Gropa e Peshanit	6400	6300	192/6 vol 1 f 93	6300	
180	Skenderas	5000	5285	180/16 vol 4 f 166 180/5 vol 1 195	1940 3060	
169	Tek shpia	300	300	249/5 vol 1 96	300	
	Shuma	15310			13600	

Gjithsejt sipërfaqe 13600 m2, më pak nga AMTP sipërfaqja 1710 m2.

Nga verifikimi dhe krahasimi i dy dokumenteve të AMTP-ve rezulton se :

Nga mos trajtimi i qytetarit me AMTP e rregullt nr. 2236 të vitit 1993, nuk janë regjistruar saktë parcelat e ngastrat e përshkruara në pronësi të qytetarit M. M,

Pasuria nr. 158 e quajtur Bizhanake me sipërfaqe 1250 m2 dhe gropa e kajtazit (Gliqe) me sipërfaqe 1800 m2 qe aktualisht qytetari e ka në shfrytëzim), vprim që do të kryhej sipas AMT se rregullt të lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës. Sa sipër për aktin e marrjes në pronësi është shprehur duke konfirmuar me shkresë nr, 186 prot, datë 14.012.2017 e firmosur nga Inspektori i shërbimeve D.Z dhe Administratori X.B të Komunës së fshatit Sotirë.

Pasuria sipas AMTP me nr. 192, me sipërfaqe 6400 m2 , në hartën kadastrale është e paraqitur me ndarjet 192/6, me siperfaqe 6300 ne pronësi të z. M.M, dhe 192/ 7 me sipërfaqe 1750 m2 vol



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

1 faqe 108 në pronesi të S. D. Në këtë kartele është vendosur shënimi që kjo pasuri sipas aktit ndodhet në pasurinë me nr. 192 /10 e cila sipas LN është 1300 m² pra, regjistruar më shumë 400 m². Kjo kartelë duhet të vihet kufizim dhe saktësohet. Nga verifikimi në hartën ipotekore rezulton se kjo pasuri është mbivendosur mbi pasurinë 192/6, e cila është pronë e z M.M.

Veprimet e kryera nga ZVRPP nuk janë në kushtet e zbatimit të kërksave të VKM nr. 224 datë 19.02.2009.

Për rrjedhoje nga ZVRPP nuk është regjistruar padejtësisht sipërfaqja e AMTP së rregullt për pronat e qytetarit M. M.

Për sa sipër ZVRPP nuk duhet të kryente veprime duke u bazuar në AMTP e vitit 2000 e cila është e pa firmosur nga kryefamiljari, veprim në kundërshtim me gjithë kuadrin ligjor për hartimin e dokumentacionit të regjistrimit të tokës bujqesore. Për kryerje apo moskryerjen e veprimeve mbajnë përgjegjësi Komisioni i ndarjes së tokës në Komunë z. G.P, përfaqësuesi i rrethit X.T, si dhe specialistja N.Z dhe ish regjistruesi G. T.

Nga ana e ZVRPP Gramsh nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)”, pika 1, germa “b” dhe “ç” dhe pikën 2.2, germa “b”, “c”, lidhur plotësimin e kërkesave për formën dhe përmbajtjen e AMTP-ve dhe mungesën e bashkëpunimit dhe disponimit ligjor me KV Prefekti Gramsh duke sjellë si pasojë mos dërgimin e dokumentacionit ligjor të administruar për dërgimin e dokumentacionit të korrigjuar i cili ka sjellë si pasojë marrjen e një vendimi jo objektiv e të saktë të këtij komisioni, pasi baza dokumentare çka e bën të pa saktë dhe të pa rregullt rregjistrimin.

Lidhur me observacionin e paraqitur për rregjistrimet e pasurisë së z. M. M jemi dakord me arsyetimin tuaj që për shkaqet e trajtuara më lart duhet të krijohet mundësia e rishqyrtimit të rregjistrimeve sipas AMTP që plotëson gjithë kërkesat e zbatimit të ligjit 7501 datë 19.07.1991, dhe mbasi të na dërgohet një përgjigje zyrtare do të procedojmë në zbatim të VKM-së 994.

Shpjegimet e dhëna si marrim në konsideratë dhe të vzhdojë procedura e mëtejshme jonë.

ZK 1409, Ref 0020, fshati Cingar i Sipërm Gramsh.

Me kërkesë nr. 1218, datë e aplikimit 15.08.2017 qytetari F. L ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimërisë sipas nr, 1607 Repertori, nr 613 Kol dhe ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 379 ,datë 28.07.2000, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Pranimi i dokumentacionit është bërë specialiste N. Z.

Bazuar në dëshminë e tashëgimërisë të hartuar nga noteria Gentiana Haruni e Zyrës së noterisë Gramsh, pesë subjektet pjesëmarrës në aktin noterial të paraqitur të quajtur B. K, M. L, R. L, S. K, F.L janë trashëgimtarë ligjore të ndjerës F.L.

Origjina e pasurive vjen nga regjistrimi i AMTP nr. 379(153), datë 28.07.2000, regjistruar si më poshtë :

-pasuria nr. 43/5, vol 1 faqe 130 sipërfaqe 9450 m² arë adresa Gramsh, lëshuar kartelë e pasurisë 02.02.2018, firmosur nga rregjistruesi X.B.

-pasuria nr. 47/8, vol 1 faqe 131 e llojit arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar në ZK 1409, sipas karteles pasurisë datë 02.02,2018.

-pasuria nr. 92/5, me adresë Gramsh, e llojit truall sipërfaqë totale 300 m² regjistruar në ZK 14.09 vol 1 faqe 132, lëshuar kartelë e pasurisë datë 02.02.2018, firmosur nga rregjistruesi F.H.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Gjithsejt pasuria për tu pjestuar midis 5 pjestarëve shuma 11250 m².

Bazuar në certifikatën familjare të datës 04.01.2015 lëshuar dhe firmosur nga nëpunësja e gjendjes civile Gramsh znj A.D, e cila konfirmon gjendjen familjare të familjes buqësore me datë 01.08.1991, kërkesë e ligjit të lartpërmendur, rezulton se në pronesi të pronares (fb) janë regjistruar dhe më pastaj janë përpjestuar pjestareve sipërfaqja 11250 m² tokë bujqësore, nga e cila truell 300 m² më pak nga sipërfaqja e AMTP nr, 153 datë 16.03.199 .Në fakt sipas normativës për fryme dhe numrit të antarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 8500 m² (5x1700) pra përfituar më shumë sipërfaqja 2750 m².

Për sa sipër mbajnë përgjegjësi Komisioni i ndarjes së tokës në Komunë z. V.Z, përfaqësuesi i rrethit F.Z, Përgjegjësi i kadastrës B. K si dhe specialistja N. Z dhe ish regjistruesi F.H.

Për problemet e trajtuara u mbajt akt konstatimi nr. 4, datë 31.05.2019.

Shqyrtuam me vemendje observacionin e paraqitur nga ZVRPP Gramsh datë 10.06.2019 firmosur nga specialistja N. Z dhe Drejtori Xh. B të cilët shpjegojnë se veprimet e regjistrimit fillestar janë kryer në vitin 2014, si dhe akti i përcaktues i sipërfaqes për frymë nuk është kompetencë e ZVRPP. Problemi qëndron së specialisti i regjistrimit në cdo rast transaksioni ndarje, pjestimi, bashkim, shitje e tj. mbi pasuritë e regjistruara fillimisht bazuar në është i detyruar të verifikojë saktësinë e veprimeve të kryera më parë dhe kur konstaton parregullsi apo saktësi të formave të ndryshme njofton aplikuesin dhe i dërgon aktet e fitimit të pronës për verifikim në KV sipas kërkesave të ligjit nr.33/2012 “ të cituarara më sipër. Nga auditimi konstatohet se për të gjitha rregjistrimet e kryera nga ZVRPP, konstatohet se regjistrimet i ka kryer të diktuar nga KV të titjve të pronësisë, i cili ka marrë emertimin në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 144 datë 01.09.2016 “Për krijimin për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi”. Ky komision praktikisht nuk ka zbatuar kërkesat e VKM 994 datë. 09.12.2015, por ka ligjëruar prona (AMTP) jo në kompetencë të tij si dhe pa akte ligjore si deklaratat e kufiarëve, nuk është mbështetur në konfirmimet nga Njësitë Administrative ku banon aplikanti dhe shoqërimin e problemeve vetëm më fjalë pa bërë ndryshimet në dokumentacion (AMTP). Për të gjitha rastet e gjetura nga ana jonë, vemë në dukje se Komisioni nuk ka tagër të vendimarrjes por vetëm të drejtën përputhshmërisë se pasurive me zërin kadastral, hartën ipotekore, sipërfaqen sipas AMTP , dakordësinë e me kufiarët, në të kundërt duhet ti drejtonte aplikantët për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në rrugë gjyqësore dhe jo pranë ZVRPP.

Kokluzion: Për mos përsëritjen e veprimeve nga ana juaj të bëhet me dijeni Komisioni i çertifikimit të titujve të pronësisë në Bashki të reflektojë mbi mangësitë e konstatuar nga ana jonë dhe në rast të kundërt, do të refuzohet nga ZVRPP çdo pasuri çertifikuar pa plotësuar kërkesat e ligjit të përmendura më lart.

II-Procesi i shpronësimit për ndërtimit e Hidrocentralit të Banjës

- Me shkresën nr. 1231/1 prot, datë 05.11.2012, ZVRPP Gramsh, drejtuar Kompanisë D. H SH.A, është kërkuar planimetria e shpronësimit për pasuritë që preken projekti i ndërtimit të hidrocentralit. Nga ZVRPP Gramsh nuk na u vu në dispozicion kthim përgjigje për shkresën e sipërcituar.

- Me shkresën nr. 756/1 prot, datë 07.10.2010, kthim përgjigje, ZVRPP Gramsh, drejtuar Kompanisë D.H Sh.A, konfirmon gjendjen juridike të pasurive sipas planvendosjes së përcjellë me shkresën pa numër protokolli, datë 30.09.2010.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Me shkresën nr. 876/1 prot, datë 18.03.2011, nga ZVRPP Gramsh drejtuar Kompanisë D. H SH.A, është dërguar informacioni, për statusin juridik të pasurive që preken nga zbatimi i projektit të ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës.
- Me shkresën nr. 5855/1 prot, datë 16.10.2012, të ZQRPP është përcjellë për regjistrim në ZVRPP Gramsh, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, regjistruar sipas Referencës nr. 026, datë 21.12.2012, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1392- Zgjupe.
- Me Ref. nr. 026, datë 21.12.2012, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1736- Gjergjovinë
- Me Ref. nr. 031, datë 21.12.2012, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1736- Gjergjovinë
- Me Ref. nr. 032, datë 14.06.2013, është regjistruar marrëveshja e uzufuktit “Për krijimin e uzufuktit mbi sheshin e marrëveshjes së koncesionit që lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjitik të lumit Devoll në Republikën e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe D. H SH.A, sipas aplikimit nr. 3199-3272, datë 24.05.2013, për regjistrim
- Me Ref. nr. 039, datë 21.12.2012, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 3262-Cingar;
- Me Ref. nr. 056, datë 21.12.2012, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 2184-Kodër Zgjupe;
- Me Ref. nr. 057, datë 14.06.2013, sipas aplikimit nr. 2461-3486, datë 24.05.2013, nga D.H, lista e shtojcave ku përfshihen Shtojca nr. 1- Harta e sheshit, Shtojca nr. 2- Lista e pronave aktuale të shpronësuara dhe të përfshira në Shesh, Shtojca nr. 3- Certifikatat e pronësisë të pasurive që përbëjnë pronat aktuale (kopje), Shtojca nr. 4- Forma e shtesës;
- Me Ref. nr. 094, datë 21.11.2013, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 3103-Qerret;
- Me Ref. 240, datë 13.05.2016, është regjistruar VKM nr. 860, datë 21.10.2015, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 656, datë 26.09.2012, sipas aplikimeve nr. 415, datë 14.04.2016, nr. 416, datë 14.04.2016, nr. 417, datë 14.04.2016;
- Me Ref. nr. 308, datë 21.11.2013, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1392-Cerrujë;
- Me Ref. nr. 103, datë 21.11.2013, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1556-Drizë;
- Me Ref. nr. 352, datë 21.11.2013, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1362-Cekin;
- Me Ref. nr. 056, datë 21.11.2013, lista e shpronësimeve për zonën kadastrale 1362-Cekin;

Nga Kompania D. H nga ndërtimi i Hidrocentralit, janë prekur gjithsej 326 pasuri, të pronarëve dhe fshatrave të ndryshëm. Nga këto 326 pasuri të prekura nga procesi i shpronësimit, 157 pasuri janë pasuri të paçertifikuara. Sipërfaqja totale e 326 pasurive të shpronësuara është **497097 m²** me një vlerë totale shpronësimi **94,459,123 lekë**, ndërsa sipërfaqja e 157 pasurive të paçertifikuara është **234362,53 m²**, me një vlerë totale shpronësimi **41,013,442.75 lekë**, më hollësisht trajtuar sipas tabelës nr. 1 “Pasuritë e shpronësuara për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës”

Punuar dhe hedhur veprimet në KPP nga zj. N.Zh me detyrë Specialiste Hartografe, miratuar nga ish Regjistruesi G.T.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Nga auditimi me zgjedhje për pasuritë të certifikuara dhe të parcertifikuara në zonën kadastrale 1556-Drizë rezultoi se:

-**AMTP nr. 47**, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A. C, me sipërfaqe 9700 m², është me korigjime, janë bërë shënime me laps, gjithashtu nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës, nuk janë të rregullta.

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 47**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 98/21, vo. 1, fq. 193, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 3500 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 3850 m², **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, sipas VKM nr. 656, datë 26.09.2012, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. Shpronësimi është bërë për sipërfaqen 3850 m².

- Pasuria nr. 119/10, vo. 1, fq. 194, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2400 m², edhe sipas LN Mars 2000 është 2400 m², lëshuar certifikatë pronësie, datë 27.11.2015, regjistruar sipas Ref. 0118, hedhur veprimet në kartelë nga zj. N. Zh, miratuar nga ish-Regjistruesi F. H. Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

- Pasuria nr. 36, vol. 1, fq. 195, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truall, me sip. 1000 m², ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 500 m², **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, sipas VKM nr. nr. 656, datë 26.09.2012, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. Shpronësimi është bërë për të sipërfaqen 531.07 m², ndërkohë që sipas faktit Libri i ngatsrave, është 500 m² **pra 31.07 m² më shumë se fakti**.

- Pasuria nr. 32/5, vo. 1, fq. 196, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2800 m², edhe sipas LN Mars 2000 është 1875 m², lëshuar certifikatë pronësie, datë 27.11.2015, regjistruar sipas Ref. 0118, hedhur veprimet në kartelë nga zj. N. Z, miratuar nga ish-Regjistruesi F. H. Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

AMTP nr. 46, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të B. C, me sipërfaqe 6800 m².

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 46**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 98/19, vo. 1, fq. 190, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2500 m², ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2950 m², **lëshuar certifikatë pronësie datë 18.01.2004**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 98/29, vol. 3, fq. 146, me sip. 2654.41, e llojit arë, në pronësi METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013 dhe pasurinë nr. 98/30, vol. 3, fq. 147, me sip. 295.5, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie. Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2654.41.

- Pasuria nr. 37, vo. 1, fq. 191, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truall, me sip. 800 m² arë dhe 300m² truall sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 500 m² arë, 300 m² truall dhe 90 m² ndërtesë, lëshuar certifikatë pronësie datë 18.01.2004. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 37/1, vol. 3, fq. 142, me sip. 18.75, e llojit arë, në pronësi METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013, dhe pasurinë nr. 37/2, vol. 3, fq. 143, me sip. 481.22, e llojit arë+truall, 300 m² truall dhe 90 m² ndërtesë, lëshuar certifikatë pronësie 09.02.2016. Në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

- Pasuria nr. 32/6, vo. 1, fq. 192, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2000 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1700 m², ndërkohë që me Ref 0119, është bërë saktësimi pasurisë në 1200 m², dhe për këtë sipërfaqe është lëshuar certifikatë pronësie datë 07.12.2015.

- Pasuria nr. 98/27/1, vo. 2, fq. 19, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1500 m² sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1550 m² arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 18.01.2004. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 27/1, vol. 3, fq. 144, me sip. 1416.01, e llojit arë, në pronësi METE, lëshuar certifikatë datë 14.01.2016, dhe pasurinë nr. 98/28/1, vol. 3, fq. 145, me sip. 133.99, e llojit arë, me pronar B.C, lëshuar certifikatë pronësie 11.02.2016. Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

AMTP nr. 16, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, me sipërfaqe 5350 m².

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 16**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 155/1, vol. 1, fq. 59, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2590 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2500 m², **lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013. Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2580.8 m², ndërkohë që sipas faktit Librit të ngastrave është 2500 m² **pra 80.08 m² më shumë se fakti**.

- Pasuria nr. 143/15, vo. 1, fq.60, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 500 m² arë sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1700 m² arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, në seksionin përshkrimi i vecantë ka shënimin “ka diferencë ndërmjet Tapis dhe Azhurnimit”.

- Pasuria nr. 91/6, vol. 1, fq. 61, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 960 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 900 m², lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004.

- Pasuria nr. 163/3, vo. 1, fq. 62, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1000 m² sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 950 m² arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004.

Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

AMTP nr. 12, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të D.Kl, me sipërfaqe 5200 m². AMTP nuk është e rregullt nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës, nuk janë të rregullta.

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 12**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 155/4, vol. 1, fq. 43, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2700 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2700 m², **palëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013, për sipërfaqen 2440 m².

- Pasuria nr. 143/13, vo. 1, fq.44, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1200 m² arë sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1250 m² arë, lëshuar certifikatë pronësie 15.03.2013.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

- Pasuria nr. 147/2, vol. 1, fq. 45, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1000 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1700 m², **palëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2012, për sipërfaqen 2295 m². Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2295 m², ndërkohë që sipas faktit Librit të ngastrave është sipërfaqja 1700 m², pra 595 m² më shumë se fakti.

Në total shtetasi D.K ka përfituar 5985 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 4900 m² tokë arë, pra 1085 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 190,960 lekë.

Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

AMTP nr. 3, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të T.R, me sipërfaqe 5200 m². AMTP nuk është e rregullt nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës, nuk janë të rregullta.

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 3**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 146/9, vol. 1, fq. 12, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1915 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1710 m², **palëshuar certifikatë pronësie**. Me Ref. 008, datë 10.10.2000, pasuria ka kaluar në pronësi të A.B, në sistemin hipotekor, **pa certifikuar**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013, për sipërfaqen 1641.66 m².

- Pasuria nr. 56/6, vo. 1, fq.13, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1000 m² arë sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1600 m² arë, pa lëshuar certifikatë pronësie. Me Ref. 049, është bërë saktësimi, përcaktuar sipërfaqja 600 m². Me Ref. 008, datë 10.10.2000, pasuria ka kaluar në pronësi të A.B, lëshuar certifikatë pronësie datë 30.05.2006.

- Pasuria nr. 70/4, vol. 1, fq. 14, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truall, me sip. 955 m² + 300 m² truall sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1250 m² tokë arë, 300 m² truall dhe 68 m² ndërtesë, pa lëshuar certifikatë pronësie.

- Pasuria nr. 165/15, vol. 1, fq. 15, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 1000 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 650 m² tokë arë, pa lëshuar certifikatë pronësie. Me Ref. 008, datë 10.10.2000, pasuria ka kaluar në pronësi të A.B, në sistemin hipotekor, pa lëshuar certifikatë pronësie.

Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

AMTP nr. 80, datë 17.05.1994, Drizë Gramsh, në emër të F. C, me sipërfaqe **5400 m², nga të cilat 5100 m² arë dhe 300 m² truall.**

Nga verifikimi i regjistrimeve në kartelë u konstatua se **Akti nr. 80**, është regjistruar në pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. 5/10, vol. 2, fq. 58, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 4100 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 4550 m², **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Kjo pasuri Me Ref. 082, datë 04.02.2011, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 5/6, vol. 3, fq. 109, me sip. 4100 e llojit arë, në pronësi të F.C, **pa lëshuar certifikatë** dhe pasurinë nr. 5/17, vol. 3, fq.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

110, me sip. 450, e llojit arë, në pronësi shtet, **pa lëshuar certifikatë**. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, të dyja pasuritë janë bashkuar duke vijuar në pasurinë nr. 5/24, vol. 3, fq. 179, me sip. 7418. 71 m², në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013. Në këtë pasuri janë bashkuar dhe pasuritë 5/18, vol. 3, fq.113, me sip. 2600 m² e llojit arë, në pronësi të I.C **e pacertifikuar**, pasuria nr. 5/19, vol. 3, fq.114, me sip. 400 m² e llojit arë, në pronësi të shtetit, **pa lëshuar certifikatë**. Në total 4 pasuritë e bashkuara japin sipërfaqen 7550 m², ndërkohë pasuria që i është nënshtruar procesit të shpronësimit nr. 5/24, vol. 3, fq. 179, ka sip. 7418. 71 m², pra 131.29 m² më pak, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë se ku është regjistruar.

- Pasuria nr. 3/1, vol. 2, fq. 59, zk. 1556-Drizë, e llojit arë me sip. 1000 m² arë sipas Akit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 1200 m² arë, **pa lëshuar certifikatë pronësie**. Kjo pasuri Me Ref. 082, datë 04.02.2011, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 3/7, vol. 3, fq. 111, me sip. 1000 e lojit arë, në pronësi të F. C, **pa lëshuar certifikatë** dhe pasurinë nr. 3/8, vol. 3, fq. 112, me sip. 200 m², e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, në pronësi shtet. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 3/7, vol. 3, fq. 111, e lojit arë, ka kaluar në pronësi METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013, për sipërfaqen 1182 m². Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 1182 m², ndërkohë që regjistrimit në volume është 1000 m², **pra 182 më shumë se Akti**, përfituar padrejtësisht.

- Pasuria nr. 5/7, vol. 2, fq. 60, zk. 1556-Drizë, e llojit truall, me sip. 300 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 300 m² truall, 57 m² ndërtim. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, për sipërfaqen 290.78 m² truall dhe 57 m² ndërtesë, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. **Në total shtetasi F. C ka përfituar 5282 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 5100 m² tokë arë, pra 182 m² tokë është e pajustificuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 32,032 lekë.**

Në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, gjithashtu mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues.

Sa sipër veprimet bien në kundërshtim me ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësi së mbi tokën bujqësore", Nenet 23, 45, 59, 74 të Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", Pikën 3 dhe 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Punuar dhe hedhur veprimet në KPP nga zj. N. Zh me detyrë Specialiste Hartografe, miratuar nga ish Regjistruesi G.T dhe ish-Regjistruesi z. F. H.

Për problemet e trajtuara më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 4, datë 30.05.2019.

Në lidhje me procesverbalin nr. 4, datë 30.05.2019, si dhe pjesën takuese në Projekt Raport janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 3981/1 prot, datë 08.07.2018, si vijon:

Përsa i përket Procesit të shpronësimit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës ju sqarojmë se shpronësimi i gjithë zonës objekt shpronësimi është bërë me VKM Nr. 656 datë 16.10.2012 "Për shpronësimin për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, prona private që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit të proketit të hidrocentralit në lumin Devoll", informacioni është dhënë nga ana e ZVRPP Gramsh



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

në rrugë manuale dhe dixhitale për cdo pasuri të cilën ata kanë listuar sipas pronarëve dhe fshatrave duke përcaktuar të gjitha të dhënat për cdo pasuri dhe shpronësimi është bërë në bazë të VKM NR. 656 viti 2012 nga ana e Zyrës Vendore ato pasuri që janë çertifikuar janë të bazuara në aktin e fitimit në zbatim të Ligjit 7501.

Duke rishqyrtuar edhe njëherë projekt raportin e auditimit për pasuritë e paçertifikuara dhe të shpronësuara sipas VKM-së së mësipërme sqarojmë se kompania D.H Sh. A. është bazuar në kartelat dhe hartat treguese të pasurive duke mbrojtur interesat e pronarëve dhe duke mos penalizuar pronarët të cilët nuk e kishin filluar procesin e çertifikimit të parcelave dhe shpronësimi është bërë në bazë të aktit të fitimit të pronës. Ky shpjegim vlen për të gjithë korpusin e shpronësimit për ndërtimin e hidrocentralit të banjës.

Në Qëndrimin e Audituesve Shtetërorë të KLSH argumentojmë se: Observacioni juaj është i përsëritur me ato të paraqitura për procesverbalet, ku është sqaruar se nga ana e Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish- ZVRPP Gramsh) nuk është bashkëpunuar me ish ZQRPP Tiranë dhe institucionet e tjera për verifikimin e ligjshmërisë së përfitimit të titujve të pronësisë sipas AMTP-ve, që kanë përfituar nga procesi i shpronësimit.

Pika 3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga privatizimi për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018 dhe transaksioneve të kryera me këtë prona, bazuar kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Bashkitë dhe ish-Njësit Vendore) dhe bazuar kontratave të shitblerjes me EKB-në.

Për këtë pikë programi për periudhën e auditimit 01.01.2017-31.12.2018, nga të dhënat e paraqitura nga ZVRPP Gramsh rezulton se nuk janë regjistruar transaksione të kryera dhe të rrjedhura nga privatizimet sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Bashkitë dhe ish-Njësit Vendore dhe bazuar kontratave të shitblerjes me EKB-në.

Pika 4. Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve”, i ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri 31.12.2018.

Mbi auditimin e ushtruar në ish-ZVRPP Gramsh në bazë të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01/04/2019, mbajtur në datë 30/05/2019.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit “Nr. 209/1, datë 01/04/2019”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Kartelat e pasurisë së paluajtshme, sipas volumeve në zonat kadastrale përaktëse.
- 2) Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur referencave përkatëse, si dhe korespondencat shpresore me institucionet përkatëse, vendime gjykatash, etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

3) Regjistrat hipotekor si dhe dokumentacioni shoqërues për regjistrimet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e ish-ZVRPP Gramsh nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përse i përket regjistrimit të pasurive të përfituara me leje ndërtimi, referuar:

- 1) Nenit 23, 49, 59, 60 të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.
- 2) Udhëzimit Metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.
- 3) Pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”,
- 4) Kreu VI, pika 3- Pranimi dokumenteve për regjistrim, nënpika 3.1 dhe 3.2, si dhe pika 5.1 dhe 5.2 të Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”,

Neni 23-Përgjegjësia ligjore e punonjësve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kryeregjistruari, regjistruarit dhe çdo punonjës tjetër i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet dhe aktet e lëshuara prej tyre.....

Neni 49- Regjistrimi i objekteve të legalizuara

1. Regjistruari bën regjistrimin e objektit të legalizuar menjëherë pas përcjelljes për regjistrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, të lejes së legalizimit dhe dokumentacionit, të përcaktuar në nenin 29 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integritetin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

2. Regjistrimi kryhet në favor të subjektit, të cilit i është lëshuar leja e legalizimit.

Kreu VI- Trajtimi i pasurive të paluajtshme pas regjistrimit fillestar,

Pika 3- Pranimi i dokumentave për regjistrim, nënpikat 3.1. Te gjitha Aktet ligjore (ku përfshihet dhe plan-rilevimi i bashkëlidhur) të jenë dokumenta origjinale, 3.2. Dokumenta të tjera mbeshetese mund të jenë origjinale ose kopje të njësuar me origjinalin....., etj.....

Nga Auditimi rezultoi që:

- **Me Ref. 9256, datë 16.10.2018,** është regjistruar pasuria nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, zk. 1842-Gramsh me sip. 77 m² ndërtesë dhe sipërfaqe parcele ndërtimore 297.8 m², godinë banimi 1 Kat, në pronësi të R. M, me adresë Bashkia Gramsh, Llapushaj, trualli është në pronësi të shtetit në pritje të daljes së VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. B.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

Objekti informal është ndërtuar mbi truallin me numër pasurie nr. 4/24, vol. 14, fq. 144, zk. 1842-Gramsh, në pronësi shtet Bashkia Gramsh me sip. 596 m².

Referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se regjistrimi është kryer me parregullsi:

- Nga ZVRPP Gramsh, nuk janë plotësuar **shtojca 2 dhe 3**, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”.

- Aplikimi nr. 567, datë 16.10.2018, nga shtetasi N. B, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5- Lëshim kopje karte të pasurisë, I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës, R8- Regjistrim i objekteve të legalizuara.

- Me shkresën nr. 2526 prot, datë 29.03.2018 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin nr. 4660, datë 29.03.2018, Av-0.

- Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se Leja e legalizimit është dhënë për objektin Godinë banimi 1 Kat, me sip. të parcelës ndërtimore 297.8 m² dhe ndërtesë 77 m². Sipërfaqja e parcelës ndërtimore është më shumë se trefishi i bazës së ndërtimit, pra 66.8 m² më tepër mbi normën ligjore, veprime këto që bien në kundërshtim me Neni 17- Kalimi i së drejtës së pronësisë dhe mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore, Kreu IV të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Gjithashtu subjekti për sipërfaqen mbi trefishin e bazës së ndërtimit nuk duhet të trajtohet me cmim favorizues sipas përcaktimeve të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”, por duhet të paguajë sipas çmimit të tregut për sipërfaqen 66.8 m², që llogaritet në **vlerën 165,304** lekë (66.8 m² * 2478 lekë/m²), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në **vlerën 12,447 lekë** (77 m² * 32,331 lekë * 0.5 %), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për **fondin e kompensimit**, jo sipas përcaktimeve të nenit 27, pika “ç” dhe Nenin 45 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, si dheme VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1, c dhe pika 2.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Zh, miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 8871, pa datë,** është regjistruar leje legalizimi nr. 3040276, datë 29.08.2016, në pronësi të N.C, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, godina e kombinuar 3 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 153 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 120.4 m², dhe sipërfaqe totale për ndërtim 380 m², pasuria nr. 10/300, vol. 20, fq. 108, zk. 1842-Gramsh, truall është në pronësi të vet me certifikatë pronësie.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. Bardha Zhupani me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

- Me shkresën nr. 4022 prot, datë 25.04.2017 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Në dosje administrohen dy aplikime nr. 740, datë 02.05.2017, nga shtetasi N.K, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara. Dhe aplikimi nr. 741, datë 02.05.2017, R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 19500 lekë (3*6500 lekë).

Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Në dosje administrohet deklarata noteriale nr. 618 rep, nr. 301 kol, datë 14.04.2017, sipas së cilës shtetasi N.K, deklaroi se ndërtesa e vjetër me sipërfaqe 77.2 m² është prishur dhe është ndërtuar objekti ri, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet **në vlerën 61,428 lekë** (380 m² * 32,331 lekë * 0.5 %), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për **fondin e kompensimit**.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8517, datë 25.01.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 5758060, datë 17.10.2016, në pronësi të Luan Xhevit Hoxha, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, godina e kombinuar 2 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 137.7 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 118.3 m², nga të cilat 99.3 m² për banim dhe 118.3 për aktivitet, sipërfaqe totale për ndërtim 217.6 m², pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, trualli është në pronësi të vet pjesërisht për sipërfaqen prej 128 m², ndërkohë që për 9.7 m² është në pritje të VKM-së.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. B. Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

- Me shkresën nr. 9317 prot, datë 12.12.2017 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga specialistët e Sektorit të Cështjeve të Pronësisë, gjithashtu planimetrit e kateve nuk janë firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohen tre aplikime nr. 49, datë 09.01.2017, për L1- Lëshim çertifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje kartelet të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara, aplikimi nr. 50, datë 09.01.2017, për R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 13000 lekë (2*6500 lekë) dhe aplikimi nr. 51, datë 09.01.2017, nga shtetasi L.H. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet **në vlerën 35,176 lekë** (217.6 m² * 32,331 lekë * 0.5 %), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për **fondin e kompensimit**.

Nga verifikimi rezulton se është plotësuar shtojca nr. 3, datë 09.01.2017, ndërkohë që certifikata është lëshuar në datë 27.01.2017, duke tejkaluar afatin 10 ditë të përcaktuar në aplikim dhe në Udhëzimin nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e trafivave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Regjistrimi i lejes së legalizimit është bërë në kartelën e pasurisë truall, duke bërë shënimet në seksionin B- Përshkrimi i pasurisë.

Pasuria truall me sipërfaqe 128 m², është regjistruar fillimisht në pasurinë nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, sipas Ref. 3526, datë 14.06.2002, në pronësi të bashkëpronarëve D, lëshuar certifikatë pronësie datë 14.06.2002. Kjo pasuri ka ardhur nga bashkimi i pasurive nr. 9/89, vol. 13, fq. 115, zk. 1842, me sip. 51.5 m², e llojit truall, në pronësi të bashkëpronarëve D dhe pasurisë nr. 9/186, vol. 16, fq. 31, zk. 1842, me sip. 76.47 m², e llojit truall, në pronësi të bashkëpronarëve Dervishi, regjistruar sipas Ref. 3526, datë 14.06.2002.

- Me Ref. 3538, datë 24.06.2002, është regjistruar kontrata e shitjes nr. 1120, nr. 130, datë 17.06.2002, duke kaluar pronësia në favor të L.H, lëshuar certifikatë pronësie datë 24.06.2002, hedhur veprimet nga specialistja N.Z.

Në kartelën e pasurisë veprimet nuk janë të rregullta pasi fillimisht duhet të hapej kartelë e re për regjistrimin e objektit të legalizuar në kundërshtim me Udhëzimin Metodik Nr. 76 Prot. datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme", Kreu VI, pasi duhej bërë shënim në seksionin D të KPP-së të pasurisë truall se mbi këtë truall është ndërtuar objekti regjistruar sipas lejes së legalizimit, si dhe shënimin përkatës në KPP e pasurisë ndërtësë për pasurinë truall mbi të cilën është ndërtuar objekti dhe më pas duke bërë bashkimin e pasurisë truall me pasurinë godinë. Gjithashtu korigjimi i bërë në kartelë duke vendosur vizë mbi rubrikën "data e lëshimit të certifikatës", nuk është i rregullt, pasi në këtë seksion të kartelës në rast se do regjistrohen transaksione të reja duhet të hiqet vizë mbi të gjithë rrjeshtin ku është regjistruar transaksioni mëparshëm dhe më pas vijohet me regjistrimin e transaksionit të ri.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Zh, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8944, datë 22.06.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 8090038, datë 22.06.2017, në pronësi të F.C, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, shtesë anësore shërbimi kati përdhe në pallatin 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 29.1 m², për aktivitet, numri kateve mbi tokë 2, pasuria nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, zk. 1842-Gramsh, trualli sipas shënimit të bërë në lejen e legalizimit është regjistruar me certifikatë pronësie vol. 11, fq. 65.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje janë konstatuar këto mangësi:

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. B.Zh me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP".

- Me shkresën nr. 5789 prot, datë 13.06.2017 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

Në volum 11, faqe 65, zk. 1842, është regjistruar pasuria nr. 9/27-N2, e llojit Njësi, me sip. 33.7 m², fillimisht sipas Ref. 2264, datë 10.08.2000. Me Ref. 2655, datë 10.09.2000, është regjistruar kontrata e shitjes duke kaluar pronësia në favor të M.D, lëshuar certifikatë pronësie datë 17.05.2004. Me Ref. 5420, datë 24.09.2007, është regjistruar kontrata e shitjes duke kaluar pronësia në favor të F.C, lëshuar certifikatë pronësie datë 24.09.2007.

Trualli nën objektin e legalizuar shtesë anësore është pjesë e pasurisë truall pallat nr. 9/27, vol. 5, fq. 149, zk. 1842, regjistruar fillimisht me Ref. 1148, datë 01.04.1997, me sipërfaqe 867.3 m².



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Në dosje administrohen dy aplikime nr. 1137, datë 22.06.2017, për L1- Lëshim çertifikatë pronësie, I4- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, I5-Lëshim kopje karteletë të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara, aplikimi nr. 1138, datë 09.01.2017, për R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 13000 lekë (2*6500 lekë) dhe B-Regjistrim prokure. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.
- Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësor **kati përdhe** në pallatin 5 Kat, ndërkohë në leje përcaktohet se numri i kateve mbi tokë është 2, pra ka mospërputhje.
- Mungon gentplani ardhur nga ALUIZNI, ndërkohë që sipas plan rievimit të hartuar në topograf privat S.X, sip. ndërtimit është 28.3 m², ndërsa sipërfaqja takuese e truallit është 16.5 m².
- Me shkresën nr. 5739/4 prot, datë 13.09.2017 (*bashkangjitur praktikës me Nr Ref. 8878*) ALUIZNI Elbasan ka përcjellë lejen e legalizimit dhe gent planin të korigjuar. Përsëri në lejen e re cilësohet se numri i kateve mbi tokë është 2, ndërkohë që korigjimi i sipërfaqes së ndërtimit nga 29.1 m² në 28.3 m², është bërë mbi lejen ekzistuese. ALUIZNI Elbasan ka ridërguar praktikën e korigjuara, por në dosje administrohet leja e vjetër me sipërfaqe të gabuar dhe korigjimin me dorë të sipërfaqes së ndërtimit. Nga ZVRPP Gramsh nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.
- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Nga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objekti informal është ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore dhe trotuarin në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2 ku është përcaktuar:

“2. Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

gj) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

pika 4/8/1 ku përcaktohet:

8/1. *Në vlerësimin e kriterëve për rrugët ekzistuese, verifikimi i trupit të rrugës kryhet mbi bazën e dokumentacionit të gjendjes faktike dhe të klasifikimit të rrugës, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ose nga autoriteti vendor i zhvillimit të territorit. Nëse nuk disponohet*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

dokumentacion, konstatimi i trupit të rrugës bëhet sipas evidentimit faktik në terren, të kryer nga vetë drejtoria e ALUIZNI-t. Në kuadër të këtij vendimi, “qendra të banuara” konsiderohen zonat e urbanizuara (zonat e ndërtushme), sipas vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të KKT-së.

nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8878, datë 22.06.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 8090040, datë 16.05.2017, në pronësi të K dhe R.C, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, shtesë anësore 2 kat e kombinuar në pallatin 5 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 68.3 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi 58.3 m2, për aktivitet 58.3 m2, numri kateve mbi tokë 2, pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, trualli në pritje të VKM-së.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje janë konstatuar këto mangësi:

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. N.Z me detyrë specialiste Juriste dhe zj. B.Z me detyrë Specialiste Financës, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

- Me shkresën nr. 5789 prot, datë 13.06.2017 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Në dosje administrohen dy aplikime nr. 1130, datë 21.06.2017, për L1- Lëshim çertifikatë pronësie, I4- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, I5-Lëshim kopje kartelet të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara, aplikimi nr. 1131, datë 21.06.2017, për R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 13000 lekë (2*6500 lekë). Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Në dosje administrohen dy leje legalizimi, përkatësisht nr. 8090040, datë 16.05.2017, shtesë anësore 2 kat e kombinuar në pallatin 5 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 68.3 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi 58.3 m2, për aktivitet 58.3 m2, numri kateve mbi tokë 2, në emër të F.C, K.C dhe F.C, si dhe leja nr. 8090039, datë 16.05.2017, shtesë anësore banimi kati parë në pallatin 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 58.3 m2, për banim 58.3 m2, numri kateve mbi tokë 2, në emër të K.C dhe F.C.

- Me shkresën nr. 5739/4 prot, datë 13.09.2017 ALUIZNI Elbasan ka përcjellë lejet e legalizimit dhe gent planin të korigjuar, por në dosje administrohen lejet e vjetra me sipërfaqe të gabuar dhe korigjimin me dorë të sipërfaqes së ndërtimit. Nga ZVRPP Gramsh nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Gent plani nuk është i rregullt pasi nuk është firmosur nga të gjithë specialistët, gjithashtu nuk përputhen me lejen e legalizimit për sa i përket sipërfaqeve të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqes së ndërtimit, pasi në gent plan përcaktohet sip. Parcele 68.3 m² dhe sip. Ndërtimore 46 m², ndërkohë në asnjë prej lejeve nuk përmendet me asnjë vend sipërfaqja ndërtimore 46 m².
- Nga veprimet e kryera në Kpp rezulton se me Ref. 8878, datë 21.06.2017, është regjistruar leja legalizimit në emër të K dhe F.C, sipërfaqe ndërtimore 51.8 m², dhe sipërfaqe takuese trualli 17.34 m², lëshuar certifikatë pronësie datë 21.08.2017. Sipërfaqja ndërtimore regjistruar në KPP nuk përputhet me atë të përcaktuar në lejen e legalizimit nr. 8090039, datë 16.05.2017. Trualli nën objektin e legalizuar shtesë anësore është pjesë e pasurisë truall pallat nr. 9/27, vol. 5, fq. 149, zk. 1842, regjistruar fillimisht me Ref. 1148, datë 01.04.1997, me sipërfaqe 867.3 m².
- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Nga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objekti informal është ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore dhe mbi trotuarë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2 ku është përcaktuar:

“2. Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

gj) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

pika 4/8/1 ku përcaktohet:

8/1. Në vlerësimin e kriterëve për rrugët ekzistuese, verifikimi i trupit të rrugës kryhet mbi bazën e dokumentacionit të gjendjes faktike dhe të klasifikimit të rrugës, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ose nga autoriteti vendor i zhvillimit të territorit. Nëse nuk disponohet dokumentacion, konstatimi i trupit të rrugës bëhet sipas evidentimit faktik në terren, të kryer nga vetë drejtorja e ALUIZNI-t. Në kuadër të këtij vendimi, “qendra të banuara” konsiderohen zonat e urbanizuara (zonat e ndërtushme), sipas vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të KKT-së.

nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 9140, datë 22.06.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Holta, Godinë e Kombinuar 3 kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 20 – 145.6 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 100 m², sipërfaqe totale për ndërtim 332.7 m², nga të cilat 232.7 m² për banim dhe 100 m² aktivitet, pasuria nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, trualli pjesërisht në pronësi të vet dhe pjesërisht në pritje të VKM-së.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje janë konstatuar këto mangësi:

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga znj. N.Z me detyrë specialiste Juriste dhe zj. B.Z me detyrë Specialiste Financës, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

- Me shkresën nr. 2968 prot, datë 19.04.2018 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Në dosje administrohet deklarata noteriale nr. 1462 rep, nr. 730 kol, datë 07.09.2017, sipas së cilës shtetasi R.M, deklaroi se ndërtesa e vjetër me sipërfaqe 20 m² është prishur dhe është ndërtuar objekti ri, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në vlerën 53,782 lekë (332.7 m² * 32,331 lekë * 0.5 %), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit.

- Trualli mbi të cilën është ndërtuar objekti informal bie pjesërisht në pasurinë nr. 7/96, vol. 14, fq. 216, zk. 1842, e llojit truall në pronësi të R.M, me sip. 20 m² dhe pjesërisht në pasurit shtet nr. 7/102, 7/104 dhe 12/13, për sipërfaqen 145.6 m².

- Regjistrimi i pasurisë nr. 7/96, vol. 14, fq. 216, zk. 1842, fillimisht është bërë me Ref. 5975, aplikimi nr. 2277-2580, datë 08.07.2009, me leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 1, datë 01.12.1992, të Këshillit të Rregullimit të Territorit, ku është miratuar sheshi i ndërtimit për sipërfaqen prej 16 m², për ndërtimin repartit mekanik në favor të shtetasit H.C. Në dosje nuk administrohet kontrata e blerjes së truallit pas viti 1991, mbi të cilin është ndërtuar objekti repart mekanik, si një nga 3 dokumentet që duhet për regjistrimin e pronës dhe pajisjen me certifikatë pronësie në përputhje me përcaktimet e Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12. Gjithashtu sipërfaqja e regjistruar në KPP pas hedhjes nga sistemi hipotekor dhe e certifikuar, datë 29.12.2009 është 20 m², ndërkohë që në asnjë prej dokumenteve të pronësisë nuk përmendet sipërfaqja 20 m² por 16 m², pra regjistrimi **i sipërfaqes prej 4 m² është i pa justifikuar me dokumente ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në kundërshtim** me përcaktimet e Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni 38, shfuqizuar me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12.

Për veprimet më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. N.Z me detyrë Specialiste dhe z. G.T me detyrë ish-Regjistruar.

- Me Ref. 7510, aplikim 3926-3927, datë 15.08.2013, është regjistruar kontrata e shitjes së truallit me nr. 4446 prot, nr. 914 rep, datë 24.07.2013, ndërmjet palës shitëse Ministrisë së Financave/Drejtorisë Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, dhe shtetasit R.M në cilësinë e palës blerëse, për sipërfaqen e truallit në objekt 16 m², autorizim nr. 9766 prot, datë 17.06.2013, përcjellë me shkresën nr. 11897 prot, datë 25.06.2013.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

- Në dosje nuk administrohet dokumentacion për likuidimin e qerasë mbi truallin për periudhën nga data 01.12.1992-deri në momentin e privatizimit të truallit. Në kushtet e mungesës së të gjithë dokumentacionit vërtetues dhe justifikues lidhur me marrëdhëniet me truallin, prezumohet i mirëqenë fakti se gjatë periudhës 01.12.1992- deri në momentin e privatizimit të truallit deri më 24.07.2013 (pra 23 vjet) subjekti pronar i repartit mekanik, nuk e ka blerë apo nuk ka kryer asnjë pagesë qiraje për truallin në përdorim prej 16m², gjë që ngarkon me përgjegjësi, veç institucioneve të tjera, edhe ZVRPP Gramsh, e cila ka ligjëruar një pronësi të tillë.

Duke llogaritur qiranë e papaguar nga subjektivetëm për 3 vjet, pra për periudhën 24 Korrik 2010 deri në 24 Korrik 2013, sipas Kap III, "Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë", pika 2 të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", rezultoni:

-Për sipërfaqen nën objekt [16 m² x 100 lekë/m² x 36 muaj] = 57,000 lekë

Pra, si rezultat i mos pagesës së qirasë, **konstatohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 57,000 lekë**, të ardhura të llogaritura të cilat do të realizoheshin nëse do të ishte lidhur dhe zbatuar kontrata e qirasë mbi truallin pronë "Shtet", vetëm për periudhën 24.07.2010 deri më 24.07.2013, dhe ngarkon me përgjegjësi specialisten e cili ka punuar praktikën znj. N. Z dhe ish-Regjistruesin z. D.K.

- Me Ref. 6133, aplikim 3926-3927, datë 15.08.2013, është regjistruar kontrata e shitjes me nr. 2318 prot, nr. 723 rep, datë 21.12.2009, duke kaluar pronësia në favor të shtetasit R.M, lëshuar certifikatë pronësie 24.12.2009.

Regjistrimi në kartelë është bërë për sipërfaqen 20 m² truall dhe 20 m² ndërtesë, pra nuk përputhet me dokumentin ligjor të pronësisë si për truallin ashtu dhe ndërtesën.

Me Ref. 9140, datë 03.05.2018, në kartelën e pasurisë truall është bërë regjistrimi i lejes së legalizimit, lëshim certifikatë pronësie datë 11.05.2018. Regjistrimi i lejes së legalizimit është bërë mbi kartelën e pasurisë truall. Në kartelën e pasurisë veprimet nuk janë të rregullta pasi fillimisht duhet të hapej kartelë e re për regjistrimin e objektit të legalizuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit Metodik Nr. 76 Prot. datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme", Kreu VI, pasi duhej bërë shënimi në seksionin D të KPP-së të pasurisë truall se mbi këtë truall është ndërtuar objekti regjistruar sipas lejes së legalizimit, si dhe shënimin përkatës në KPP e pasurisë ndërtesë për pasurinë truall mbi të cilën është ndërtuar objekti dhe më pas duke bërë bashkimin e pasurisë truall me pasurinë godinë.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 8632, datë 28.02.2017**, është regjistruar leje legalizimi nr. 1020833, datë 15.11.2016, në pronësi të V.S, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Holta, godina e kombinuar 4 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 176 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 176 m², nga të cilat 365 m² për banim dhe 358.5 m² për aktivitet, sipërfaqe totale për ndërtim 723.5 m², pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, truallin është në pronësi të vet pjesërisht për sipërfaqen prej 105.93 m², ndërkohë që për sipërfaqen prej 70.07 m² është në pritje të VKM-së.

- Është bërë inventarizimi i dosjes datë 16.04.2017, nga znj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Me shkresën nr. 9317 prot, datë 12.12.2017 të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga specialistët e Sektorit të Cështjeve të Pronësisë, gjithashtu planimetrit e kateve nuk janë firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në vlerën 116,957 lekë ($723.5 \text{ m}^2 * 32,331 \text{ lekë} * 0.5 \%$), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit.

- Nga verifikimi rezulton se është plotësuar shtojca nr. 3, datë 28.02.2017, ndërkohë që certifikata është lëshuar në datë 07.04.2017, duke tejkaluar afatin 11 ditore të përcaktuar në aplikim dhe në udhëzim.

Nga verifikimi i marrëdhënieve me truallin rezulton se kjo pasuri bie mbi pasuritë si vijon:

- **nr. 7/135+1-4, vol. 1, fq. 102, zk. 1842**, e llojit apartament me sip. 46.83 m², regjistruar sipas Ref. 0102, datë 31.03.1997, përfituar nga privatizimi në emër të X dhe Q.B, kaluar në pronësi të H.S me kontratë shitje sipas Ref. 4592, datë 15.09.2005, kaluar në pronësi të Vullnet Shahini me kontratë shitje sipas Ref. 5423, datë 29.09.2007, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.09.2017,

- **nr. 7/135+1-3, vol. 1, fq. 98, zk. 1842**, e llojit apartament me sip. 59.1 m², regjistruar fillimisht sipas Ref. 098, datë 31.03.1997, në pronësi shtet, kaluar me privatizim sipas Ref. 2326, datë 21.01.2000 në emër të A, N dhe N.Ag, më pas kaluar në pronësi të V dhe P.S me kontratë këmbimi sipas Ref. 5215, datë 06.04.2007, më pas kaluar në pronësi të V. S me kontratë shitje sipas Ref. 6519, datë 14.04.2011, lëshuar certifikatë pronësie datë 15.04.2011.

- Ndërkohë që sipërfaqja e mbetur prej **70.07 m²**, pjesë e pasurisë truall mbi të cilën është ndërtuar objekti informal, është pjesë e pasurisë **nr. 7/133, vol. 9, fq. 127, me sip. 918.3 m²**, e llojit truall, në pronësi të shtetit. Në seksionin D, sipas Ref. 6402, datë 02.12.2010, është bërë shënimi *“Me VKM nr. 431, datë 11.07.2007, kjo pasuri i jepet në përdorim Bashkia Gramsh”*.

Me Ref. 6402, datë 02.12.2010, është bërë regjistrimi i VKM-së nr. 431, datë 11.07.2007, *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të Qarkut Elbasan”*, aplikim nr. 3653-3835, datë 02.12.2010, sipas shkresës nr. 2045 prot, datë 03.09.2010 të Bashkisë Gramsh drejtuar ZVRPP Gramsh.

Në dosje nuk administrohet shkresë e Bashkisë Gramsh që jep konfirmimin për legalizimin e objektit informal veprime këto që bien në kundërshtim me pikën 2, Neni 15/1, Neni 39-Përfundimi nga legalizimi, të Ligjit nr.9482 datë 3.4.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar*, nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”* si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 *“Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”*.

Me Ref. 7374, datë 08.04.2013, pasuria nr. 7/133, vol. 9, fq. 127, është ndarë duke vijuar në pasuritë nr. 7/328, vol.20, fq. 134, me sip. 891.3 m², në pronësi shtet dhe pasurinë nr. 7/329, vol.20, fq. 135, me sip. 27 m². Në seksionin D të dyjave pasurive bija është mbartur shënimi më sipër. Ndërkohë që mbi këto pasuri nuk është kryer asnjë veprim tjetër apo shënim edhe pas regjistrimit të lejes së legalizimit nr. 1020833, datë 15.11.2016, në pronësi të V.S.

Mbi pasurinë nr. 7/329, vol.20, fq. 135, me sip. 27 m², me Ref. 8441, datë 07.01.2016 është bërë regjistrimi i lejes së legalizimit nr. 3004018, datë 18.08.2016, në pronësi të N.D, zk. 1842,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Holta, shtesë anësore soc-ekonomike 1 Kat në pallatin ekzistues, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 27.8 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 27.8 m², nga të cilat 27.8 m² për aktivitet, trualli është në pritje të VKM-së. Gjithashtu dhe në këtë rast në dosje nuk administrohet shkresë e Bashkisë Gramsh që jep konfirmimin për legalizimin e objektit informal mbi truallin që është në përdorim të Bashkisë.

Regjistrimi i lejes së legalizimit është bërë në kartelë më vete në pasurinë nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842, me sip. 176 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, lëshuar certifikatë pronësie datë 07.04.2017.

Konstatohet se për dy pasuritë **nr. 7/135+1-4, vol. 1, fq. 102, zk. 1842**, e llojit apartament me sip. 46.83 m² dhe **nr. 7/135+1-3, vol. 1, fq. 98, zk. 1842**, e llojit apartament me sip. 59.1 m², nuk është bërë asnjë veprim nga ZVRPP për mbylljen e kartelave, si dhe ndryshimin e zërit kadastral nga apartament në ndërtesë sipas lejes së legalizimit. Gjithashtu në dosje nuk administrohet dokumentacion apo shkresa nga institucionet vendore për prishjen e dy apartamenteve dhe ndërtimin e objektit informal në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, Neni 49.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8679, datë 10.03.2017**, është regjistruar leje legalizimi nr. 6654236, datë 22.04.2016, në pronësi të V dhe M.D, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, shtesë anësore 1 Kat për banim dhe 5 Kat në godinë ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 37.7 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 37.7 m², nga të cilat 37.7 m² për banim, trualli është në pritje të VKM-së.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N. Zh me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Në dosje administrohen dy aplikime nr. 456, datë 10.03.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje kartelet të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara, aplikimi nr. 457, datë 10.03.2017, për R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 6500 lekë, nga shtetasi S.X. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në vlerën 6094 lekë (37.7 m² * 32,331 lekë * 0.5 %), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit.

Nga verifikimi rezulton se është plotësuar shtojca nr. 3, datë 10.03.2017, ndërkohë që certifikata është lëshuar në datë 27.03.2017, duke tejkaluar afatin 13 ditë të përcaktuar në aplikim dhe në udhëzim.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z, miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8646, datë 21.02.2017**, është regjistruar leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve Tace, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Godinë banimi 2 Kat +1 Kat nën tokë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 340.2 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 113.4 m², nga të cilat 349.7 m² për banim, trualli miratuar sipas VKM nr. 117, datë 17.02.2011.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N. Z me detyrë specialiste Juriste, dhe zj. B.Z, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

- Me shkresën nr. 1719 prot, datë 14.02.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 352, datë 21.02.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje kartelet të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara.

- Planimetrit e kateve nuk janë të rregullta pasi nuk janë firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në vlerën 56,530 lekë ($349.7 \text{ m}^2 * 32,331 \text{ lekë} * 0.5 \%$), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit.

Nuk është plotësuar shtocja nr. 3, sipas përcaktimeve të pikës 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit".

Në lidhje me marrëdhëniet me truallin, në seksionin D të pasurisë është bërë shënimi se kjo pasuri bie mbi pasurinë nr. 9/421, vol. 21, fq. 190, Zk. 1842, me sip. 855 m², e llojit truall, në pronësi të bashkëpronarëve D dhe pasurinë nr. 9/69, vol. 15, fq. 3, zk. 1842, me sip. 98.8 m², e llojit truall, në pronësi të shtetit.

Sipas VKM nr. 117, datë 17.02.2011, (përmendur në lejen e legalizimit) sipërfaqja e miratuar për parcelën ndërtimore për bashkëpronarët Tace është 302.5 m² ($3.22 + 299.3$) ndërkohë që sipërfaqja e miratuar në leje është 340.2 m², pra nuk dokumentohet se si është përfituar sipërfaqja e mbetur prej 40 m². Gjithashtu mbi pasurinë nr. 9/421, vol. 21, fq. 190, Zk. 1842 me sip. 855, e llojit truall, është regjistruar në favor të bashkëpronarëve Dervishi, me Ref. 8662, datë 15.07.2015, Vendimi i Gjykatës nr. 5001, datë 21.04.2014, lëshuar certifikatë pronësie datë 21.12.2015, ndërkohë që për një pjesë të kësaj pasurie ekziston një VKM për kalimin e parcelës ndërtimore nga shteti në favor të bashkëpronarëve Tace, e dhënë më parë në kohë nga vendimi gjykatës.

- ZVRPP Gramsh nuk duhej të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit deri në saktësimin e marrëdhënieve me truallin, dhe vazhdimin e procedurave të shpronësimit nga ALUIZNI Elbasan si dhe korrigjimin e lejes së legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit".

- Aplikimi mban datën 21.02.2017, ndërkohë që certifikata është lëshuar me datë 31.05.2018, me vonesë më shumë se një vit, duke mos respektuar afatin prej 11 ditë pune në kundërshtim me afatin e përcaktuar në aplikim dhe Udhëzim.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z dhe ish-Regjistruar z. F.H, miratuar nga z. Xh.B me detyrë Regjistruar.

- **Me Ref. 8598, datë 21.02.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9974860, datë 11.07.2016, në pronësi të B. Z, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Holta, Godinë banimi 1 Kat, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 121.6 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 43.5 m², nga të cilat 43.5 m² për banim, trualli është miratuar sipas VKM nr. 805, datë 22.07.2009.

- Është bërë inventarizimi i dosjes datë 08.07.2017, nga zj. N. Z me detyrë specialiste Juriste, dhe zj. B.Z, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 284, datë 08.02.2017, për R11- Regjistrim përfundimtar i objekteve të reja. Nga ZVRPP Gramsh është aplikuar gabimisht tarifa e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.
- Planimetria e katit përdhe nuk është e rregullt pasi nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.
- Në dosje nuk administrohet mandati që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila llogaritet në vlerën 70,319 lekë ($43.5 \text{ m}^2 * 32,331 \text{ lekë} * 0.5 \%$), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit.
- Nga verifikimi i veprimeve në kartelë rezulton se fillimisht pasuria nr. 7/43, vol. 9, fq. 77, zk. 1842, është pasqyruar në kartelë sipas Librit të Ngastrave Mars 1997, me sipërfaqe truall 38.7 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 38.7 m². Ndërkohë që në seksionin ndërtesë është bërë fshirja me korrektor të sipërfaqes së ndërtimit në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Metodik Nr. 76 Prot. datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme", si dhe pa shoqëruar me dokumente që argumentojnë fshirjen nga regjistrat, apo prishjen e ndërtimit të vjetër në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 8405 datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, Neni 49.
- Aplikimi mban datën 08.02.2017, gjithashtu dhe shtojca nr. 3 është plotësuar dhe miratuar nga Regjistruesi në të njëjtën datë, ndërkohë që lëshimi i certifikatës së pronësisë është bërë në datë 26.02.2017, me vonesë duke mos respektuar afatin prej 11 ditë pune të përcaktuar në aplikim dhe në udhëzim.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8876, datë 14.04.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595606, datë 07.10.2016, në pronësi të F.M, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtese Anësore Banimi Kati parë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 65.8 m², nga të cilat 65.8 m² për banim, truall do të miratohet me VKM.
- Është bërë inventarizimi i dosjes datë 08.07.2017, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, dhe zj. B.Z, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.
- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.
- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.
- Në dosje administrohen dy aplikime nr. 649, datë 14.04.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, aplikimi nr. 650, datë 14.04.2017, për R11-Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja në vlerën 6500 lekë, nga shtetasi Fadil Merzherku. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.
- Shtojca numër. 3 është firmosur nga Regjistruesi në datë 14.04.2017, shënimi në KPP për lëshimin e certifikatës është bërë në datë 27.04.2017, ndërkohë që sipas kopjes së kartelës së administruar në dosje rezulton se kartela është lëshuar në datë 07.05.2017, që duhet të përkohë dhe me datën e lëshimit të certifikatës së pronësisë, pra ka mospërputhje.

Marrëdhëniet me truallin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *"Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI"*, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *"Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit"*.

- Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirëfilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Theksojmë se leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi 1 Kat në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e nenit 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit".

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 9126, datë 08.03.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595614, datë 08.10.2016, në pronësi të X.K, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtese Anësore Banimi Kati Tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 120.3 m2, nga të cilat 120.3 m2 për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është firmosur nga Specialisti Arkivës dhe nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-10, vol. 22, fq. 128, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 120.3 m2, regjistruar në datë 08.03.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 15.03.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N. Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 141, datë 08.03.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi X.K.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*”.

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi 1 Kat në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 9110, datë 19.02.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595607, datë 07.10.2016, në pronësi të D.B, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë Anësore Banimi Kati katërt në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 65.8 m2, nga të cilat 65.8 m2 për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është firmosur nga Specialisti Arkivës dhe nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-14, vol. 22, fq. 127, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 65.8 m2, regjistruar në datë 19.02.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 05.03.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Zh.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 105, datë 09.02.2018, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi D. B.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*”. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati katërt në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z miratuar nga Regjistruesi z. X. B.

- **Me Ref. 9148, datë 12.04.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595631, datë 09.10.2016, në pronësi të A.R, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë Anësore Banimi Kati tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 65.8 m2, nga të cilat 65.8 m2 për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-11, vol. 22, fq. 138, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 65.8 m2, regjistruar në datë 12.04.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 26.04.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 207, datë 12.04.2018, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi A.R.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

nga *ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënimi se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*”.

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Zh miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 9246, datë 21.09.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9505609, datë 07.10.2016, në pronësi të V.Dë, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë Anësore Banimi Kati tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 118.5 m2, nga të cilat 118.5 m2 për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 2873 prot, datë 17.04.2018, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-12, vol. 22, fq. 173, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 118.5 m2, regjistruar në datë 21.09.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 25.09.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 514, datë 21.09.2018, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi V.D.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënimi se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin-Përshkrimin i vecantë ka shënimin “Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”.

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 9134, datë 16.03.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595626, datë 08.10.2016, në pronësi të H.M, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 120.3 m², nga të cilat 120.3 m² për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z. me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-1, vol. 22, fq. 131, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 120.5 m², regjistruar në datë 16.03.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 26.03.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët si dhe nga Drejtori i ALUIZNI-t.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 514, datë 21.09.2018, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi H.M.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënimi se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”*.

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati tretë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 9023, datë 13.10.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595608, datë 08.10.2016, në pronësi të B. J, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati dytë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 65.8 m², nga të cilat 65.8 m² për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N. Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 11437 prot, datë 29.09.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-8, vol. 22, fq. 91, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 65.8 m², regjistruar në datë 13.10.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 26.10.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N. Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 1339, datë 13.10.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi B.J.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”*, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”*. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati dytë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 9259, datë 09.08.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595627, datë 08.10.2016, në pronësi të Xhevdet Koci, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 65.8 m², nga të cilat 65.8 m² për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. Nërënxa Zhupani me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13164 prot, datë 14.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-2, vol. 22, fq. 189, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 65.8 m², regjistruar në datë 09.08.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 05.11.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Zh.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 435, datë 09.08.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi F.K.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, gjithashtu aplikimi mban datën 09.08.2018, ndërkohë që lëshimi i certifikatës së pronësisë është bërë në datë 05.11.2018, me vonesë duke mos respektuar afatin prej 15 ditë pune të përcaktuar në aplikim dhe Udhëzim.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”*, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m²



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”*.

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 9205, datë 17.07.2018,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595613, datë 08.10.2016, në pronësi të D.D, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 118.5 m², nga të cilat 118.5 m² për banim, trulli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. Nërënxa Zhupani me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-3, vol. 22, fq. 158, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 118.5 m², regjistruar në datë 17.07.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 31.07.2018, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Zh.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohet aplikimi nr. 385, datë 17.07.2018, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, nga shtetasi V.B.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, gjithashtu aplikimi mban datën 09.08.2018, ndërkohë që lëshimi i certifikatës së pronësisë është bërë në datë 05.11.2018, me vonesë duke mos respektuar afatin prej 15 ditë pune të përcaktuar në aplikim dhe udhëzim.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin *“Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”*, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z miratuar nga Regjistruesi z. X.B.

- **Me Ref. 8952, datë 13.10.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595612, datë 08.10.2016, në pronësi të H.S, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati parë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 120.3 m², nga të cilat 120.3 m² për banim, truall do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-4, vol. 22, fq. 77, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 120.3 m², regjistruar në datë 29.06.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 01.08.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohen dy aplikime, nr. 1150, datë 29.06.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje kartelet të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, dhe nr.1151, datë 29.06.2017, R 11- Regjistrim përfundimtar i ndërtimeve të reja, nga shtetasi H.S. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Nuk është plotësuar shtojca nr. 3, gjithashtu aplikimi mban datën 29.06.2017, ndërkohë që lëshimi i certifikatës së pronësisë është bërë në datë 01.08.2017, me vonesë duke mos respektuar afatin prej 13 ditë pune të përcaktuar në aplikim dhe udhëzim.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin "*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*", ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin "*Pallati 5 kate, me 1 shkallë 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirefilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP-Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8660, datë 05.05.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595628, datë 08.10.2016, në pronësi të F.H, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati dytë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 118.5 m², nga të cilat 118.5 m² për banim, trulli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes datë 22.03.2017, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-9, vol. 22, fq. 49, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 118.5 m², regjistruar në datë 09.03.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 22.03.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N. Zh.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohen dy aplikime, nr. 434, datë 09.03.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, dhe nr. 435, datë 09.03.2017, R 11- Regjistrim përfundimtar i ndërtimeve të reja, nga shtetasi F. H. Konstatojmë se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin "*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*", ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënimi se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin "*Pallati 5 kate, me 1 shkallë 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit*".

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 8594, datë 05.05.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595624, datë 08.10.2016, në pronësi të D.B, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati katërt në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 118.5 m2, nga të cilat 118.5 m2 për banim, trualli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes datë 22.02.2017, nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 651 prot, datë 20.01.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-15, vol. 22, fq. 36, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 118.5 m2, regjistruar në datë 03.02.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 22.02.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, gjithashtu planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët.

- Në dosje administrohen dy aplikime, nr. 257, datë 03.02.2017, për L1- Lëshim certifikatë pronësie, I5-Lëshim kopje karte të pasurisë, R8-Regjistrim i objekteve të legalizuara dhe I4-Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, dhe nr. 258, datë 03.02.2017, R 11- Regjistrim përfundimtar i ndërtimeve të reja, nga shtetasi F.H. Konstatohet se nga ZVRPP Gramsh janë aplikuar gabimisht dy tarifa, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit.

- Shtojca nr. 3, nuk është firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, gjithashtu aplikimi mban datën 03.02.2017, ndërkohë që lëshimi i certifikatës së pronësisë është bërë në datë 22.07.2017, me vonesë duke mos respektuar afatin prej 13 ditë pune të përcaktuar në aplikim dhe udhëzim.

- Me Ref. 9109, datë 16.02.2018, pasuria ka kaluar në favor të M. dhe V.E, sipas kontratës së shitjes nr. 213 prot, nr. 117 Kol, datë 16.02.2018, lëshuar certifikatë pronësie datë 16.02.2018.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin "*Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI*", ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim i kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m2 truall dhe 297.6 m2 ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

ka shënimin “Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”.

Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirefilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 9063, datë 14.12.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595610, datë 07.10.2016, në pronësi të S.D, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati parë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 118.5 m², nga të cilat 118.5 m² për banim, truall do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-6, vol. 22, fq. 98, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 118.5 m², regjistruar në datë 14.12.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 19.12.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N.Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët, gjithashtu nuk është plotësuar shtojca nr. 3.

- Me Ref. 9143, datë 30.03.2018, është regjistruar dëshmia e trashëgimisë në favor të bashkëpronarëve R, D, V, M dhe V. D, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.04.2018.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin “Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistit që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin “Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjme me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirefilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati parë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N. Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- **Me Ref. 9095, datë 14.12.2017,** është regjistruar leje legalizimi nr. 9595629, datë 08.10.2016, në pronësi të S. C, zk. 1842, Adresa Bashkia Gramsh, Lagja Sporti, Shtesë anësore banimi kati dytë në pallatin ekzistues 5 Kat, me sipërfaqe ndërtimi 120.3 m², nga të cilat 120.3 m² për banim, trulli do të miratohet me VKM.

- Është bërë inventarizimi i dosjes pa datë nga zj. N.Z me detyrë specialiste Juriste, por nuk është plotësuar me numër rendor progresiv.

- Me shkresën nr. 13249 prot, datë 16.11.2017, të Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, drejtuar ZVRPP-Gramsh, është përcjellë dokumentacioni për regjistrimin e lejes së legalizimit, shoqëruar me aplikimin Av-0.

- Leja e legalizimit është regjistruar në pasurinë nr. 9/321+1-7, vol. 22, fq. 95, zk. 1842, zëri kadastral Apartament, me sip. Ndërtimi 120.3 m², regjistruar në datë 01.12.2017, lëshuar certifikatë pronësie datë 06.12.2017, hedhur veprimet në KPP nga Specialistja N. Z.

- Gent plani është i parregullt pasi është i pafirmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, planimetria e katit nuk është firmosur nga të gjithë specialistët, gjithashtu nuk është plotësuar shtojca nr. 3.

Marrëdhëniet me truallin

Pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin -Përshkrimi i vecantë ka shënimin *"Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI"*, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189. Nga ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistit që ka hedhur veprimet.

Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin -Përshkrimin i vecantë ka shënimin *"Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit"*.

Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjmë me shtesa në objekt ekzistues por regjistrim i mirefilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati dytë në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore. ZVRPP Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Punuar praktika nga specialistët zj. N.Z miratuar nga ish-Regjistruesi z. F.H.

- Gjithashtu nga auditimi i praktikave të regjistrimit të lejeve të legalizimit rast pas rasti dhe evidencës së të ardhurave nga shërbimet për vitet 2017 dhe 2018, rezulton se nga ZVRPP Gramsh gjatë vitit 2017 janë aplikuar gabimisht dy tarifa për regjistrimin e lejeve të legalizimit, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit, ***e cila llogaritet në vlerën totale 741,000 lekë (114*6500 lekë), tarifuar gabimisht.***

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 5, datë 30.05.2019.

Për këtë çështje nga personat përgjegjës me shkresën nr. 2981/1 prot, datë 09.07.2019, administruar në KLSH me nr. 209/4 prot, datë 11.07.2019, janë bërë komente dhe shpjegime nga z. Xh.B me detyrë ish-Regjistrues aktualisht Përgjegjës Zyre, zj. N.Z me detyrë Specialiste Hartografe, të cilat sqarojnë si vijon:

- Fleta e Inventrit është format TIP i dërguar nga ZQRPP Tiranë, nga ana jonë janë plotësuar të gjitha rubrikat me nr. Progresiv dhe nr. Rendor si dhe me nr. Reference. Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të fletë së inventarit dhe kjo vlen për të gjitha praktikant në të cilat është konstatuar mangësi nga ana juaj.

- Leja e legalizimit është regjistruar në regjistër në Zk 1842 nr. Pas. 4/179 vol.22 faqe 184 indeks harte Gr-H-4 lagja "Xhile Lici" e llojit ndërtesë, me sip 77m², objekti banimi 1kat në pronësi të shtetasve R.M, B.M dhe e certifikuar nga zyra.Dokumentacioni i përcjellë për regjistrim është bërë në bazë të ligjit nr 33/2012 date 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" pasi i plotëson kushtet si në formë dhe në përmbajtje, ndërsa lidhur me sip. të parcelës ndërtimore me sip 297.8 m² dhënë 66.8 m² më tepër se trefishi i bazës së ndërtimit, sqarojmë se nuk është përgjigjësia e Zyrës por e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI- t Elbasan pasi nga ana jonë është certifikuar vetëm ndërtesa 77m² dhe jo parcela ndërtimore.

- Në dosje nuk administrohet mandati që verteton pagesën e taksës së infrastrukturës nga ana jonë sqarojmë se nuk është detyrë e Zyrës Vendore të kërkojë pagesë e taksës së ndikimit në infrastrukturë por kjo pagesë e dërgon Bashkia pranë ALUIZNI- t Elbasan pasi Zyrës Vendore kjo e drejtë është hequr në vitin 2017.

Të njëjtën përgjigje shprehim dhe në lidhje me referencën nr 8871 me aplikant N. K, dhe me referencën nr. 8517 me aplikant L.H.

- Lidhur me referencën nr. 8944 datë 22.06.2017 është regjistruar leja e legalizimit me pronar F.C sqarojmë se mënyra e regjistrimit është kryer në bazë të lejes së legalizimit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan të përcjellë në ZVRPP Gramsh për objektin shtesë anësore shërbimi kati përdhe në pallat 5 kat Zk. 1842 nr pas. 9/278/2 vol. 22 faqe 84 me sip.29.1m². Objekti është konfiguruar saktë dhe nga përshtatja dhe hedhja në hartën treguese të punës kjo pasuri nuk krijon mbivendosje me pasuri të tjera rrugë apo trotuare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

- Lidhur me referencën nr. 8878 datë 22.06.2017 është regjistruar leja e legalizimit nr. 8090040 datë 16.05.2017 në pronësi të shtetasit K dhe R. C Zk.1842 bashkia Gramsh, lagja Sporti shtesë anësore 2 kat e kombinuar në pallat 5 kat me sip. 58.3m². Regjistrimi i pasurisë është kryer në bazë të lejes së legalizimit genplanit si dhe parcelës ndërtimore. Korigjimet në lejen e legalizimit janë bërë nga ky institucion për të cilën ka vendosur vulën e institucionit sipër. Nga ana jonë leja e legalizimit i është kthyer dhe është ridërguar tre herë dhe po ti kushtosh vëmendje lejeve të rikthyera përsëri në dosje nga ky institucion janë depozituar tre leje legalizimi por që të trija të korigjuara dhe për pasojë duke bërë korigjime të njëpasnjëshme ka ndodhur dhe gabimi material në sipërfaqe 58.3 m² që është në lejen e legalizimit në 51.3 që kemi vendosur në seksionin "B" të kartelës.
- Nga auditimi është konstatuar se inventarizimi i dosjes është bërë pa datë, por referuar fletës së inventarit e cila mban datën 11.05.2018 është bërë konform ligjit.
- Deklarata e prishjes për 20 m² është administruar në drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan dhe nuk është në kompetencën e ZVRPP Gramsh për të kërkuar deklaratën e prishjes së objektit të vjetër.
- Nuk është në kompetencën e ZVRPP Gramsh për administrimin e mandatit që vërteton pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, por është kompetencë e ALUIZNI-t.
- Regjistrimi i pasurisë mr nr. 7/96 vol. 14 fq.216 në zk 1842 është bërë me referencën 5975 sipas aplikimit 2277-2280 dt. 08.07.2009 sipas lejes së ndërtimit, kontratës së hipotekimit e dt. 17.03.1995 me hipotekues H.C adresa Gramsh. Me dokumentin ligjor 7510 , Kontratë shitje e pasurisë së plauajtshme të truallit të objektit repart mekanik nr. Rep 1446 , nr. Kol 914 , datë 24.07.2013 me palë shitëse Ministria e Financave dhe palë blerëse Z. R.M, objekt kontrate është shitja e truallit të objektit Repart Mekanik me sip. totale 16 m², por nga dokumentacioni i ndodhur pranë zyrës rezulton të jetë 20 m². Likuidimi i qerasë mbi truallin bëhet nga Drejtoria Rajonale Tatimore për periudhën 07.06.2010 deri në momentin që do të kryejë pagesën e plotë të truallit të lëshuar nga zyrat Rajonale Tatimore, pra nuk është në kompetencën e ZVRPP-së depozitimi i një mandati të tillë, por kompetencë e Ministrisë së Financave.
- Me referencën nr. 6133 dt. 22.12.2009 me nr. Aplikimi 3851-3855 shtetasi R.M ka aplikuar pranë zyrës së regjistrimit dt. 22.12.2009 për regjistrimin e kontratës së shitjes me nr. Rep. 2318 nr. Kol 723 dt. 21.12.2009 me palë shitëse H.C palë Blerëse R. M për pasurinë me nr. 7/96 e llojit truall me sip. totale 20 m² për të cilën është pajisur edhe me certifikatë pronësie. Regjistrimi prej 20 m² është bërë në bazë të dokumentacionit të depozituar pranë zyrës. Regjistrimi i leje së legalizimit me refernce 9140 dt. 03.05.2018 është bërë në seksionin "B" të kartelës ku është regjistruar sipërfaqja totale 100 m² nga kjo 20 m² truall dhe 100 m² ndërtesë, të përfutur sipas lejes së legalizimit, ndërsa për parcelën ndërtimore në seksionin "D" të kartelës është regjistruar shënimi se shteti është pronar i truallit mbi të cilin ndodhet ndërtesa, mbi pasuritë me nr. 7/102, 7/104 dhe 12/13. Regjistrimi është bërë në përputhje të plotë të ligjit 33/2012 dt. 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".
- Me referencën nr. 8876 dt. 14.04.2017 është regjistruar leje legalizimi nr. 9595606 dt. 07.10.2016 në pronësi të F.M, Zk 1842, Bashkia Gramsh, lagja "Sporti" shtesë anësore banimi kat i parë në pallatin egzistues 5 kat me sip ndërtimi 65.8 m² nga të cilat 65.8m² për banim. Trualli do të privatizohet me VKM.
- Në lidhje me referencën sqarojnë se dokumentacioni i dërguar nga ALUIZNI Elbasan shprehet për objektin shtesë anësore banimi kati i parë në pallat egzistues 5 kat me pronar F.M ne ZK 1842 me nr. Pasurie 9/321 +1-5 me sip. totale 65.8 m². Trualli do të privaktizohet me VKM.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Bashkangjitur Genplani, Planimetria, Lista Emërore e banorëve të Apartamenteve nr. Pas. 9/321 zk. 1842, Bashkia Gramsh ku janë të renditur 15 Pronarët e apartamenteve duke filluar nga nr. E pasurive 9/321+1-1 deri në 9/321+1-15 dhe emrat e pronarëve. Referuar listës me emrat e cituar si më sipër janë depozituar të gjitha lejet e legalizimit, është paguar tarifa për regjistrim dhe lëshim çertifikate, janë hapur kartelat për çdo pasuri nga pasuria me nr. 9/321+1-1 deri në 9/321+1-15 pra gjitshej 15 apartamente sipas sipërfaqeve të ndërtimit të dhënë me leje legalizimi ndërsa trualli nën objekt për të 15 apartamentet është në pronësi të shtetit me shënimin do të privatizohet me VKM.

Leja e Legalizimit për të 15-të pronarët e mësipërm shprehet për shtesë anësore banimi në pallat egzistues 5 kat, ku faktikisht nuk është shtesë anësore por janë pasuri të llojit apartament pasi bashkangjitur nga ALUIZNI Elbasan shprehimisht është shprehur në listë bashkangjitur banorët e Apartamenteve dhe nga ana jonë lloji i pasurisë është regjistruar apartament.

Nga verifikimi i dokumentacionit këto pasuri rrjedhin nga pasuria me nr. 9/52 vol. 14 fq 250 e llojit truall e regjistruar me librin e ngastrave ne gusht te vitit 2000 me sip. totale 388.5 m2 dhe ndërtesë 297.6 m2 në pronësi të shtetit me datë përfundimtare 16.01.2001 në seksionin përshkrim i veçantë mban shënimin pallati 5 kate me një shkallë dhe 15 apartamente, nuk është depozituar leje ndërtimi. Nisur sa me sipër konstatohet se pallati ka pas qenë i regjistruar para vitit 1991. Drejtoria Rajonale ALUIZNI Elbasan ka kërkuar statusin juridik për pasurinë nr. 9/52 dhe nga ana jonë i është vënë në dispozicion kartela dhe harta treguese. Të njëjtin shpjegim japim për të 15 pronarët që ndodhen në këtë pallat. Regjistrimi i Lejeve të legalizimit për të 15 pronarët e mësipërm është bërë konform ligjit 33 dt. 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

- Ndërsa në lidhje me mbajtjen dhe arkëtimin e tarifës prej 6500 leke si tarifë për ndërtimet e reja nga ana jonë sqarojmë se gabimisht është arkëtuar kjo tarifë pasi drejtoritë e ALUIZNI- t kanë ngritur shqetësim në këtë periudhë që ZVRPP- të duhet të dorëzojnë vërtetimin e pagesës së taksës në infrastrukturë dhe arkëtimin e tarifës së shërbimit të regjistrimit fillestar si kusht për regjistrimin e lejës së legalizimit dhe nga ana jonë është kuptuar jo saktë ky moment dhe ndaj ka ndodhur kjo vjelje pagese vetëm për disa persona derisa çështja u zgjidh ndërmjet bashkërendimit të punës midis ALUIZNI-t dhe ZQRPP Tiranë kjo tarifë më pas nuk është aplikuar në asnjë rast nga ana e zyrës.

Në Qëndrimin e Audituesve Shtetërorë të KLSH argumentojmë se: - Në lidhje me inventarin e dosjeve osbervacioni juaj do të merret në konsideratë për ato raste kur keni paraqitur dokumentacionin- fletë inventari, por nga Zyra Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh duhet të merren masa për hartimin e inventarëve të dosjes në përputhje me përcaktimet ligjore.

- Në lidhje me pretendimin se taksa e ndikimit në infrastrukturë arkëtohet nga Bashkia pas njoftimit zyrtar të ALUIZNI-t, sqarojmë para dhënies së lejes së legalizimit duhet të plotësohen dokumentacioni në përputhje me neni nr. 27, të Ligjit 9482/2006 me ndryshime.

- Në lidhje me deklaratën e prishjes së objektit të vjetër sqarojmë se nuk është deklarata noteriale e personit interesuar që vërteton prishjen e objektit, pasi për këtë rast zbatohet procedura ligjore në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 8405 datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, Neni 49.

- Në lidhje me pretendimin se korigjimi i lejeve të legalizimit nuk është bërë nga ZVRPP Gramsh por nga vetë institucioni që i ka lëshuar ato ALUIZNI Elbasan, sqarojmë nga ZVRPP Gramsh



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korrigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- Në lidhje me mosrespektimin e trefishit të bazës së ndërtimit për sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sqarojmë se subjektet nuk duhet ti shmangen pagesës sipas cmimit të tregut për rastet kur janë mbi kufirin e përcaktuar ligjor, duke përfituar nga cmimi favorizues në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Trajtimi me cmim favorizues nuk është përgjegjësi direkte e ZVRPP, por e ALUIZNI që ka lëshuar aktin, por nga ZVRPP Gramsh duhet të merreshin masa duke kërkuar dorëzimin e dokumentacionit shtesë që vërteton pagesën e plotë për parcelën apo vendosjen e kufizimit në ato raste kur është regjistruar vetëm ndërtesa deri në saktësimin e pagesës.

- Në lidhje me pretendimin se objektet e ndërtuara nga F. dhe R.C janë konfiguruar saktë dhe nga përshtatja dhe hedhja në hartën treguese të punës për këto pasuri nuk krijon mbivendosje me pasuri të tjera rrugë apo trotuare, sqarojmë se këto pasuri janë ndërtuar në një distancë të afërt me pasuri të llojit rrugë dhe trotuarë, trajtuar hollësisht në pjesën takuese në material pa respektuar kriteret e caktuara urbanistike.

- Për sa i përket ligjshmërisë së procedurave të legalizimit për rastet e referencave të tjera në material sqarojmë se nga ish-ZVRPP Gramsh nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet ligjore trajtuara hollësisht në pjesën takuese në material, gjithashtu nuk është paraqitur dokumentacion shtesë nga ai i administruar në dosje dhe ai i paraqitur për procesverbalet.

Pika 5. Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.

Mbi auditimin e ushtruar në ZVRPP Gramsh (sot Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) në bazë të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01/04/2019, mbajtur në datë 28/05/2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Nga ana e ZVRPP Gramsh nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra për sa i përket regjistrimit të pasurive të përfituara me vendime gjyqësore të formës së prerë referuar nenit 45, pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012” dhe pikës 2 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 në të cilin percaktohet që:

“Regjistrimi i fitimit apo kalimit të drejtes së drejtes së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të njohura apo të fituara me anë të ligjit , vendim gjyqësor, aktit administrativ ose me parashkrim fitues, në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” behet nga ZVRPP pas verifikimit të plotë të elementëve të aktit që njih ose permban fitimin e të drejtën e pronësisë për efekt të plotësisht të kushteve të regjistrimit të percaktuara në nenin 193 të Kodit civil të RSH.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Nga auditimi rezultoi se:

1.Me refencën nr. 9175, pa Aplikim, është regjistruar pasuria nr. 9/400 sipërfaqe truall dhe ndertim 92.7 m², v. 20, faqe 123 me vendim Gjykata Apelit Durrës nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017 dhe ka nëshkruar në KPP N.Z dhe regjistrues X.B. Inventari pa datë nga N. Z. Vendimi i gjykatës Elbasan nr. 1332, datë 02.11.2016 i ndryshuar nga Gjykata Apelit Durrës me Vendim nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017

Paditës: S. X

i paditur: I.X, D.X

Objekti: Njohje bashkpronar të paditësit nga të paditurit mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 9/331 e ndodhur në ZK 1842 me sip. 92.7 m² me një kat mbi tokë(sip. Totale 185.4m²).

Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 1332, datë 02.11.2016 ka vendosur:

-Rrezimin e kërkesë padisë së paditeses S.X.

Kunder ketij Vendimi Gjykate ka bere ankim Paditësi S. X dhe ka kërkuar si:ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesë padisë

Gjykata e Apelit Durrës me Vendim nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017 ka vendosur se vendimi 1332 është i pabazuar në prova e ligj dhe si i tillë duhet ndryshuar.

Me shkresën Urdhër nr7, datë 08.03.2018 Përmbaruesi ka kërkuar: 1. ZVRPP Gramsh të kryej veprimet përkatëse mbi regjistrimin e pasurisë së paluajtshme sipas dispozitivit të vendimit, duke regjistruar në kartelën përkatëse të pasurisë edhe shtetasin S.X, si bashkëpronar në ½ pjesë të pasurisë së paluajtshme me nr. 9331 në ZK 1842. 2. S.X të paraqitet pranë sportelit të ZVRPP për të bërë pagesat e tarifave përkatëse.

Rezulton se ZVRPP Gramsh ka vepruar në papajtueshmëri me ligjin, duke qënë se ka kryer regjistrim e vendimit të gjykatës pa aplikim të kërkuarit, duke shkaktuar shmangjen e detyrimeve financiare për regjistrimin e aktit, në papajtueshmëri me Ligjin 33/2012 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Njëherazi nga transaksionet e kryer rezulton se i padituri D.X, bashkpronar i pasurisë nuk është pasqyruar në kartelën e hapur nga ZVRPP Gramsh, duke lënë pronar me pjesë të papërcaktuara në kartelë I.X dhe S.X.

2.Me refencën nr. 0483, me Aplikim, është regjistruar sip. Prej 6334m² me vendim Gjykatës Elbasan nr. 157, datë 03.02.2016 lënë në fuqi nga Gjykata Apelit Durrës. Ka nëshkruar në KPP N.Z dhe regjistrues F.H. Inventari pa datë nga N.Z.

Paditës: Q.G

I paditur: AKKP

Personi tretë: AVSH Durrës

Objekti: Ndryshimin e vendimit nr. 347, datë 07.07.2011 të AKKP Tiranë, a. Duke i kthyer në natyrë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Kaso Guri, sip. Tokës të njohur dhe trajtuar prej vendimit nr. 559, datë 15.05.1996 të KKKP Gramsh.

Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan me vendimin 157, datë 03.02.2016 ka vendosur:

-Pranimin e kërkesë padisë së paditesit Q.G kundër palës paditur AKKP Tiranë. Kthimin në natyrë të sip. Prej 6334m² e cila ndodhet brenda sip. Prej 20000 m², të njohur me Vendimin nr. 559, datë 15.05.1996 të KKKP Gramsh. Në vendim sipërfaqja e kthyer është e ndarë në 17 parcela, konkretisht:

Parcela nr. 1, me S= 152m²; Parcela nr. 2, me S= 1050 m²; Parcela nr. 3, me S= 660m²;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Parcela nr. 4, me S= 67m²; Parcela nr. 5, me S= 572 m²; Parcela nr. 6, me S= 297m²; Parcela nr.7, me S= 147m²; Parcela nr. 8, me S= 355m²; Parcela nr. 9, me S= 274m²; Parcela nr. 10, me S= 202m²; Parcela nr. 11, me S= 136m²; Parcela nr. 12, me S= 505m²; Parcela nr. 13, me S= 1200m²; Parcela nr. 14, me S= 462m²; Parcela nr. 17, me S= 120m²; Parcela nr. 18, me S= 148m²; Parcela nr. 19, me S= 278m²;

Me shkresën datë 12.06.2017, ZVRPP Gramsh i është drejtuar ZQRPP me Projekt Urdhër Refuzimin pjesërisht të sipërfaqes prej 733.84 m², me arsyetimin se parcelat krijojnë mbivendosje, konkretisht:

Parcela nr. 1 me S = 152 m² e cila ndodhet në pasurinë nr .121/18 vol. 1 faqe 238 me pronar shtetin e llojit eroduar, kjo parcelë rezulton të jetë 145.5 m² e cila ka mbivendosje me pasurinë nr. 121/2 vol 1 fq. 47 me sip 96 m² e llojit truall me pronar shtetin në seksionin “ C” të kartelës posedues është pronari B.T i cili është banues i kësaj banese nga sip totale 145m² kjo pasuri ka mbivendosje 49.99 m² me pas. 121/2.

Parcela nr. 2 me S= 1050 m² me skanim 1048 m² e cila bie në pas. Nr 121/18 ka mbivendosje me pasuritë me nr 121/4 vol.1 fq. 235 e llojit truall me sip 300m² ndërtesë 81.6 me pronar G dhe K.G ka mbivendosje 40m². Mbivendosje ka në pas.nr. 121/6 vol. 1 faqe 236 e llojit truall me sip 300m² ndërtesa 81.6m² me pronar E dhe E.G ne siperfaqe 40.5m² . Mbivendosje ka në pasurinë nr 121/7 vol.1 faqe 36 e llojit truall me sip 300m² ndërtesa 81.6m² e regjistruar në pronësi të 4/bashkëpronarëve B, I, A, P.G mbivendosje ka 24 m². Mbivendosje ka ne pas.nr. 121/5 vol.1 faqe 127 e llojit truall me sip 9m² ndertese 9m² me pronar shtetin posedues Murat Shuli.

Parcela nr.3 me S= 660 m² e skanuar 675.34m², bie në pas. Nr 122/1 vol.1 faqe 239 me pronar shtetin e llojit shkëmbore me sip. 13800m² ka mbivendosje me pas. Nr. 123/3 vol.1 faqe 241 e llojit rruge me sip 2950 m² me pronar shtetin mbivendosje ka për rreth 125.2m². Mbivendosje ka me pasurinë nr. 171 vol. 2 faqe 20 me sip 660m² me pronar shtetin mbivendosje ka 52m².

Parcela nr. 4 me S= 67 m² bie ne pas. Nr 12/1 me pronar shtetin e llojit shkembore nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 5 me S = 572m² me skanimim është 568.58 m² e cila ka mbivendosje me pas. Nr. 12/4 vol. 1 faqe 64 e llojit truall me sip 96m² ndërtesa 96m² me pronar shtetin mbivendosje ka 21m² . Mbivendosje ka ne pas. Nr. 122/5 vol.1 faqe 41 e llojit truall me sip. 96 m² ndertesa 96m² me pronar shtetin mbivendosje ka 11 m² .

Parcela nr. 6 me S = 297 m² me skanimim është 291.14m² e cila ka mbivendosje me pasurinë nr. 122/6 vol.1 faqe 27 e llojit truall me sip 96m² ndërtesa 96 m² me pronar shtetin mbivendosje ka 26.3 m².

Parcela nr. 7 me S = 147 me skanim është 163m² e cila ka mbivendosje me pas nr. 122/12 vol. 1 Faqe 114 me pronar shtetin e llojit truall me sip. 96m² ndërtesa 96 m² mbivendosje ka 25 m².

Parcela nr. 8 me S = 355 m² e skanuar 358.4m² ka mbivendosje me pas. Nr 122/10 vol. 1 faqe 97 e lojit truall me sip. 96 m² ndërtesa 96 m² mbivendosje ka 18 m² . Mbivendosje ka në pas nr. 122/3 e llojit rrugë me pronar shtetin për nje sip prej 18m² .

Parcela nr. 9 me S = 274 m² e skanuar 270.5m² ka mbivendosje me pas. Nr 122/3 e llojit rrugë me pronar shtetin me sip të mbivendosur 87.75m².

Parcela nr. 10 me S = 202 m² e skanuar 206.5m² bie në pas nr. 122/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 11 me S= 136 m² e skanuar 130.5 m² bie në pas nr 122/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin e llojit shkëmbore nuk ka mbivendosje.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Parcela nr. 12 me nr. 12 me sip 505 e skanuar është 492 m² bie në pas. Nr. 122/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 13 me S = 1200 m² e skanuar është 1180 m² bie në pas. Nr 122/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 14 me S = 462 m² e skanuar është 457 m² bie ne pas. Nr. 112/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 17 me S = 120 m² ka mbivendosje me pasurinë nr. 171 e llojit rrugë me pronar shtetin mbivendosje ka në sip 41.2m².

Parcela nr. 18 me S= 148 m² në pas. 122/1 e llojit shkëmbore me pronar shtetin nuk ka mbivendosje.

Parcela nr. 19 me S = 287 m² e është 280 m² ka mbivendosje me pas. Nr 122/11 vol 1 faqe 11 e llojit truall me sip 96m² truall ndërtesa 96 m² me pronar shtetin ka mbivendosje në sip 53.8 m². Mbivendosje ka dhe me pas. Nr 122/3 e llojit rrugë me pronar shtetin mbivendosje në sip 51.3 m².

ZQRPP me shkresën nr. 4000/3, datë 09.10.2017, *kthim akti në lidhje me Projekt-Urdhrin e Refuzimit të kërkesës së z. Q.G, i ka rekomanduar* ZVRPP Gramsh, fillimin e korrespondencës me Drejtorinë e Regjistrimit Fillestar për fillimin e procesit për Përmirësimin e Përditësimin në referim të përcaktimeve ligjore të bëra nga VKM nr. 245/2014, pas kryerjes së kësaj procedure të vijohet me trajtimin e kërkesës së aplikuesit.

ZVRPP Gramsh, me Urdhër nr. 4492, datë 15.11.2017, të ish-Regjistruarit F.H, ka bërë Përmirësimin dhe Përditësimin e bllokut nr. 121, 122 të ndodhur në fshatin Qerret, NJA Pishaj, Bashkia Gramsh.

Nga auditimi rezulton se ZVRPP Gramsh ka vepruar në papajtueshmëri me ligjin me trajtimin e kërkesës së shtetasit Q. G, pasi vendim Gjykatës Elbasan nr. 157, datë 03.02.2016, ka mos pëputhje të sipërfaqes së kthyer fizikisht paditësve, konkretisht, në dispozitiv gjykata shprehet për 6334m², ndërsa shuma e parcelave përbën një sipërfaqe totale prej 6634m², pra një difference prej 300m².

Në këto rrethana, ZVRPP Gramsh, duhet të kishte kthyer vendimin kërkuar me kërkimin për saktësimin e sipërfaqes, në zbatim të përcaktimeve ligjore të nenit 45 të ligjit 33/2012 dhe Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012.

Njëherazi, procedura e Përmirësim e Përditësimin nuk është bërë në pajtueshmëri me kërkesat e VKM n. 245, datë 30.4.2014, "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" pasi nuk janë respektuar përcaktimeve të pikës 8 e në vijim të VKM-së.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 4) Nenin 45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
- 5) Pikën 8 e në vijim të VKM 245/2014
- 6) Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012
- 7) Kreun e IV-të të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. F.H me detyrë ish-regjistruar.

Z. N.Z me detyrë specialiste

Z. X.B me detyrë Regjistruar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

II-Ndjekja dhe pjesëmarrja e ZVRPP Gramsh në proceset gjyqësore:

Nga Auditimi rezultoi që:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si evidencat e vendime gjyqësore në lidhje me ecurinë e tyre, përfaqësimin e zyrës në këto procese për periudhën 01.01.2017 deri në 31.12.2018, u konstatua se:

- Nga ZVRPP Gramsh nuk mbahet dhe administrohet në dosje më vete çdo praktikë gjyqësore, nuk ka evidencë për ecurinë, pjesëmarrjen sipas procesverbaleve të seancave gjyqësore si dhe ankimimet që janë bërë për cdo proces.

- ZVRPP Gramsh ka qenë palë në 24 procese gjyqësore, si palë e paditur apo palë e tretë nga të cilat në 4 prej tyre ka qenë në mungesë, më hollësisht paraqitur në tabelën ***“Përmbledhëse e procesve gjyqësore periudha 01.01.2017-31.12.2018”***, në seksionin Shtojca.

Pra sa më sipër rezulton se ZVRPP Gramsh nuk ka ndjekur ecurinë e proceseve gjyqësore sipas përcaktimeve të bëra në Nenin 391, 442, 443, 444 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për të cilat ngarkohen me përgjegjësi zj. N. Z me detyrë Specialiste, dhe ish-Regjistruesi z. F. H.

Për problemet e trajtuar më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 1, datë 28.05.2019.

Në lidhje me procesverbalin nr. 1, datë 28.05.2019, si dhe pjesën takuese në Projekt Raport janë paraqitur observacionet me shkresën nr.2981/1 prot, datë 09.07.2019, administruar në KLSH me nr. 209/4 prot, datë 11.07.2019, si vijon:

ZVRPP Gramsh referuar proceseve gjyqësore ku rezulton të jetë palë e paditur, person i tretë apo person i interesuar nuk rezulton në asnjë rast të jetë debitor në vlerë monetare, çka vërteton se për cdo proces gjyqësor nga ana jonë janë përfaqësuar dhe janë dërguar prapsimet apo prova shkresore në lidhje me objektet e padive në cdo shkallë të gjykatës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit të KLSH^{së}: *Observacioni juaj qëndron pjesërisht pasi ndjekja e proceseve gjyqësore nuk nënkupton vetëm të qenit debitor për shkak të mosankimimit të vendimeve, por dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme në proceset gjyqësore dhe ndjekjen e ecurisë së tyre duke bërë ankimimet përkatëse. Observacioni juaj do të merret në konsideratë në adresimin e përgjegjësisë individuale në raport me mangësit e konstatuara.*

Pika 6. Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.

Në zbatim të pikës “6” të programit të auditimit ***nr. 209/1, datë 01.04.2019***, u konstatua:

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Referencat, VKM për transferimin e pasurive publike
- Korespondenca shkresore me institucionet përkatëse

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Gjatë periudhës së auditimit 01.01.2017- 31.12.2018, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për regjistrim pranë ZVRPP Gramsh në lidhje me pasuritë publike të transferuara në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

pronësi apo në administrim, rezulton se nga ana e Bashkisë Gramsh është aplikuar pranë ish-ZVRPP Gramsh sipas aplikimit nr. 1240, datë 29.08.2017, Ref. 0857, për regjistrimin e VKM nr. 58 dt. 27.01.2016, “Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrotjtjes te Bashkia Gramsh”, të pasurive të pasqyruara sipas të dhënave në tabelë si më poshtë:

Nr.	ZK	Nr. i Pasurisë	Vol	Faqe	Referenca	VKM	Data e lëshimit të certifikatës	Pronar
1	2167	297	2	217	08 57	58	06.09.2017	Bashkia Gramsh
2	2167	295	2	215	08 57	58	06.09.2017	Bashkia Gramsh
3	2167	296	2	216	08 57	58	06.09.2017	Bashkia Gramsh
4	2167	294	2	214	08 57	58	06.09.2017	Bashkia Gramsh
5	2167	293	2	213	08 57	58	06.09.2017	Bashkia Gramsh

Të gjitha pasuritë më sipër janë pajisur me certifikatë pasurie dhe mbi to nuk janë kryer transaksione të tjera.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në ZVRPP Gramsh mbi regjistrimin e pasurive të transferuara dhe administrimi i tyre ndër vite, u konstatua se me numër reference 6402, datë 03.12.2010 dhe aplikim 0455794, datë 02.12.2010, Bashkia Gramsh, në përputhje dhe në zbatim të VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore” që transferohen, në pronësi, ose në përdorim, ka aplikuar për regjistrimin në pronësi dhe përdorim të pronave:

1. Kolektorët e ujërave të bardha dhe të zeza;
2. Rrjeti i ndricimit publik;
3. Trojet dhe hapësirat publike;
4. Sheshet, trotualet, lulishtet, etj.

Në këto katër grupime përfshihet një numër total prej 221 pasurish të regjistruara në zbatim të VKM-së së sipërcituar.

Nga pronat e lartpërmendura, në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar aplikimet e Bashkisë Gramsh pranë ZVRPP Gramsh, në përputhje dhe në zbatim të VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 me referencë nr. 0161110 datë 28.07.2008, ku nga nga ana e ZVRPP Gramsh janë regjistruar pasuritë si më poshtë:

Nr.	Nr. reference	VKM Nr.	Aplikimi nr.	Zona kadastrale nr.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e pasurisë	Lloji i pronës	Pajisur me certifikatë
1	5780	431 dt. 11.07.2007	0160796 dt. 31.10.2008	1842	5/196 vol 8 fq. 242	107 m ²	Truall ndërtesë	Po
2	5776	431 dt. 11.07.2007	0160794 dt. 31.10.2008	1842	5/131 vol 9 fq. 243	27 m ²	Truall ndërtesë	Po
3	5775	431 dt. 11.07.2007	0160793 dt. 31.10.2008	1842	8-77 – 11/4 vol 18 fq. 2013	256 m ²	Truall ndërtesë	Po



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

4	5779	431 dt. 11.07.2007	0160789 dt. 31.10.2008	1842	9/144 vol 15 fq. 15	253 m ²	Truall ndërtesë	Po
5	5781	431 dt. 11.07.2007	0160792 dt. 31.10.2008	1842	7/142, 7/141 vol 18 fq. 31	56.4 m ²	Truall ndërtesë	Jo
6	5777	431 dt. 11.07.2007	0160788 dt. 31.10.2008	1842	8/40 vol 9 fq. 177	14 m ²	Truall ndërtesë	Po
7	5778	431 dt. 11.07.2007	0160787 dt. 31.10.2008	1842	5/73 vol 8 fq. 185	394 m ²	Truall ndërtesë	Po
8	5782	431 dt. 11.07.2007	0160795 dt. 31.10.2008	1842	5/195 vol 8 fq. 243	150 m ²	Truall ndërtesë	Po
9	6044	431 dt. 11.07.2007	0123197 dt. 10.09.2009	1842	6/32 vol 9 fq. 13	2876.1 m ²	Truall ndërtesë	Po
10	6045	431 dt. 11.07.2007	0123196 dt. 10.09.2009	1842	10/47 vol 15 fq. 45	242.8 m ²	Truall ndërtesë	Po
11	6043	431 dt. 11.07.2007	0123198 dt. 10.09.2009	1842	1/63 vol 8 fq. 21	797 m ²	Truall ndërtesë	Po
12	6042	431 dt. 11.07.2007	0123190 dt. 10.09.2009	1842	8/156 vol 10 fq. 164	440 m ²	Truall ndërtesë	Po
13	6041	431 dt. 11.07.2007	0123191 dt. 10.09.2009	1842	10/139	39 m ²	Truall ndërtesë	-
14	6046	431 dt. 11.07.2007	0123195 dt. 10.09.2009	1842	8/35 vol 9 fq. 172	398m ²	Truall ndërtesë	Po
15	6036	431 dt. 11.07.2007	0123186 dt. 10.09.2009	1842	8/36 vol 9 fq.	398 m ²	Truall ndërtesë	Po
16	5698	431 dt. 11.07.2007	0161110 dt. 28.07.2008	1842	17 pasuri			

Në tabelën e mësipërme sipas numrit rendor 16 nga ana e Bashkisë Gramsh është aplikuar pranë ZVRPP Gramsh dhe në përputhje e në zbatim të VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 me referencë nr. 0161110 datë 28.07.2008, pasuritë:

1. Pasuria 10/33-2, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 36 m²
2. Pasuria 9/103, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 687.6 m²
3. Pasuria 8/25, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 32 m² (lëshuar çertifikatë pronësie)
4. Pasuria 7/142, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 56.4 m²
5. Pasuria 7/9, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 50m²
6. Pasuria 7/130, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 200 m² (lëshuar çertifikatë pronësie)
7. Pasuria 6/53, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 332 m² (lëshuar çertifikatë pronësie)
8. Pasuria 9/104, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 986.1 m²
9. Pasuria 9/104, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 28 m²
10. Pasuria 8/15, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 275 m² (lëshuar çertifikatë pronësie)
11. Pasuria 8/38, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 240 m²
12. Pasuria 8/33, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 31.5 m²
13. Pasuria 8/17, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 89 m²
14. Pasuria 8/14, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 146.5 m²
15. Pasuria 8/43, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 24 m²
16. Pasuria 9/49-2, “truall”, me sipërfaqe 900 m²
17. Pasuria 9/49, “truall ndërtesë”, me sipërfaqe 10175.5 m².

Për pasuritë e sipërcituara në tabelën e mësipërme (32 gjithsej) rezulton se është bërë aplikimi për regjistrimin e tyre dhe pajisjen me çertifikatë pronësie nga Bashkia Gramsh,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

dhe janë pajisur me certifikatë 19 pasuri, për 3 pasuri nuk ka informacion, ndërsa për 10 pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie, pasi nuk është paguar tarifa e shërbimit.

Për pjesën tjetër të pasurive (gjithsej 189) nuk është kryer asnjë veprim nga ana e Bashkisë Gramsh në ish-ZVRPP Gramsh për sa i takon aplikimit për pajisjen me certifikatë të tyre, edhe pse ka kaluar shumë kohë që nga dalja e VKM nr. 431, datë 11.07.2007.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 7, datë 30.05.2019.

Pika 7- Mbi përputhshmërinë e Aktivitet financiar. Përdorimi me efektivitet i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Nxjerrja e përgjegjësisë për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me Degën e Thesarit për arkëtimet nga legalizimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Pagat dhe shpërblime etj). Administrimi, ruajtja. Dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe aktiveve. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

Në zbatim të pikës “7” të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i kërkuar për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mbajtjen e kontabilitetit, **në bazë të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01.04.2019 .**

1-Projekt buxheti, evidencat e treguesve të realizimit të planit të buxhetit dhe detajimet në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën/artikulli.

Nga auditimi i dokumentacionit i vendosur në dispozicion në lidhje me hartimin dhe miratimin e buxhetit të njësisë shpenzuese ZVRPP Gramsh për periudhat 2017 dhe 2018 rezultoi sa më poshtë:

Projektbuxheti për periudhat raportuese 2017 dhe 2018 është hartuar mbi bazën e kërkesave që dërguara nga ZVRPP Gramsh, të cilat janë miratuar nga ZQRPP brenda afateve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave.

Ndarja e plan buxheteve dhe detajimet janë kryer në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën/artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

Programimi shpenzimeve është bërë në nivel, titulli, kapitulli dhe artikulli e nën artikulli, ndërsa realizimi i tyre paraqitet sa më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2017				
		Plan Fillestar	Shtesa pakesi me	Plani gjithsej	Fakt	%
1	Llog.(600) “Paga e shperblime”	2,514	+52	2566	2,546	99.2
2	Llog.(601) “Kontribute Sig.Shoq shendetsore”	420	11	431	425	98.6
3	Llog.(602) “Shp.operative”	1,260	-	1260	1260	100
4	Llog. (606) “Trnasfert për ndihm familje”					
	Totali	4,194	63	4257	4232	99.4

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë rezulton se fondet e buxhetit për periudhën raportuese të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

institucionit janë në vlera shumë të ulëta, duke bërë të pamjaftueshm realizimin dhe funksionin e institucioni dhe të objektivave dhe strategjive në ZVRPP.

Për periudhën raportuese bazuar në PBA të vitit 2017 ZQRPP(Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) me shkresë nr. 7224/1 datë 06.11.2017 ka dërguar detajimin e ndryshimeve të shpenzimeve koherente të buxhetit për vitin 2017 dhe detajimin limit mujor në zbatim të ligjit nr.147/2015, datë 15.01.2016 “Për buxhetin e vitit 2017” i miratuar nga MF, ndërsa realizimi i buxhetit sipas fondeve dhe natyrës së shpenzimeve pasqyrohet sa më poshtë;

në 000/lekë

Periudha raportuese 2017	Llogarit e analizuara			Totali	
	7112300		7029200	Plan	Fakt
Të ardhurat nga shërbimet	8064	-	-	8064	8064
-Nga taksa e kalimit pronësisë 3 %	-	2		2	2
Te ardhura nga tatimi I kalimit pronësisë	-		2014	2014	2014
Të tjera nga rivlersimi dhe gjoba penalitete	-	-	38	38	38
Totali	8064	2	2052	10118	10118

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë rezulton se, realizimi i fondeve të alokuara është në masën 100 %, me realizim me të ulët paraqitet fondi i destinuar për pagesën e kontributeve sigurime shoqërore e shëndetsore të punonjësve i realizuar në masën 98.6 %, në të cilën ka ndikuar pakësimi i fondit të pagave për mos plotësim organike, ndërsa nuk është pasqyruar ndryshim në llog.(601). Fondet e çelura nga Dega e Thesarit janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limiti.

-Miratimi i plan buxhetit për periudhën raportuese të vitit 2018.

Për periudhën raportuese të vitit 2018, bazuar në PBA afat mesëm ZVRPP Gramsh me shkresën nr.2253/1 datë 24.08.2017 ka dërguar detajimin e shpenzimeve koherente të buxhetit për vitin 2018 dhe detajimin limit mujor në zbatim të ligjit të buxhetit për vitin 2018 i cili është miratuar nga ZQRPP Tiranë.

Plani dhe realizimi i buxhetit sipas fondeve dhe natyrës së shpenzimeve pasqyrohet sa më poshtë:

000/lekë

Periudha raportuese 2018	Llogarit e analizuara			Totali		
	7112300		7029200	Plan	Fakt	%
Të ardhurat nga shërbimet	7200			7500	5130	68.4
-Nga taksa e kalimit pronësisë 3 %	-	10	-	10	10	100
Te ardhura nga tatimi kalimit pronësisë			5200	5200	10450	200
Të tjera nga rivlersimi dhe gjoba		-	-	-	561	-
Totali			-	12710	16142	127



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Nga auditimi rezulton se të ardhurat janë krijuar nga se ZVRPP Gramsh aplikon 51 lloje tarifash shërbimi, të cilat derdhen 100 % në buxhetin e shtetit veprim ky i rakorduar me bankën sipas tabelave mujore dhe progressive të firmosura respektivisht nga palët.

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2018			
		Plan Aprovuar	Shtuar pakesuar	Plani perfundimtar	Fakti
1	Llog.(600) "Paga e shperblime"	2,487	+401	2888	2839
2	Llog.(601) "Kontribute Sig.Shoq shende"	414	+70	484	438
3	Llog.(602) "Shp.operative"	1,300	-	1300	1299
4	Llog. (606) "Trnasfert për ndihm familje"				
	Investime	60	396	456	282
	Totali	4261	867	5128	4859

Parashikimi fillestar i buxhetit për periudhën raportuese të vitit 2018 është bërë nga ZQRPP sipas shkresës nr. 9131 datë 29.12.2018. Gjatë zbatimit të buxhetit janë bërë ndryshime me shtesa konkretisht sipas shkresës nr. 7225 datë 10.09 .2018 për zërin "paga" pasi është shtuar në organikë me kontratë juristja e institucionit dhe me shkresën 9807/1 datë 27.12.2018 për zërin paga dhe sigurime në shumën 190 mijë lekë. Mbi bazën e të dhënave të ZVRPP Gramsh është rakorduar me degën e thesarit të rrethit çdo muaj, mbështetur në udhëzimet respektive të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore. Realizimi shpenzimeve operative është dokumentuar sipas nën/artikuj llogaria. (602) "Shpenzime operative" sa më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
1	Kancelari	241	241	100
2	Shpenzime telefonike dhe internet	-	-	-
3	Posta dhe shërbime korrieri	106	106	100
4	Shpenzime për taksa të institucioni	100	100	100
5	Shpenzime udhëtimi brenda vendit	127	127	100
6	Energji elektrike	172	172	100
7	Ujë	14	14	100
8	Komisione bankare	21	21	100
9	Investime	282	282	100
	Totali	822	822	100

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelë për dy vitet rezulton se realizimi fondeve në llogaria (602) "Shpenzime operative" në nivel artikulli dhe në nivel nënartikujsh kanë ruajtur të njëjtin nivel realizimi. U bë krahasimi i pasqyrave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet me aktrakordimet nuk u konstatuan deviacione.

Sa më sipër për periudhat raportuese objekt auditimi arrihet në konkluzionin se;
-ZVRPP Gramsh si pjesë e programit PBA-n e hartuar nga ZQRPP Tiranë, ka hartuar projektbuxhet vjetore për periudhën afatmesme 3 vjeçare për të ardhurat dhe shpenzimet të cilat janë dërguar në Zyrës Qëndore Tiranë. Hartimi dhe zbatimi i buxheteve vjetore është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

bërë në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimet vjetore përkatëse”.

Nga auditimi dhe analiza e fondeve buxhetore nga ZVRPP Gramsh dhe Ministria e Drejtësisë, për njësinë shpenzuese në fjalë rezultoi se fondet e alokuara janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të Institucionit, sepse ka mungesa investimesh kryesisht për paisje elektronike dhe kaceleri të ndryshme.

-Zbatimi dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës e pagave.

-Respektimi strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin. Respektimi dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Respektimi dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçant, dhënien e shpërblimeve për ndihmë e fatkeqësie etj.

ZVRPP Gramsh është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimeve (QKR) më datë 26.04.2005 si institucion publik në varësinë e Ministrisë së Drejtësisë ndryshuar së fundi në vartësi të Kryeministrit. Aktiviteti kryesor i saj është regjistrimi i pasurive të paluatshme dhe funksionimi bazohet në ligjin 33/2012 dhe Urdhërin e Kryeministrit nr.109, datë 12.07.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së sistemit të regjistrimit të pasurive të paluatshme.”

Në zbatim të ligjit të Shërbimit Civil dhe MFK e dispozitave të tjera ligjore për pagat e punonjësve, nga titullari ZQVRPP në bashkëpunim me burimet mbështetëse dhe njerëzore, janë miratuar struktura organizative, procedurat e rekrutimit të stafit, përgatitja e procedurave për punësim dhe plotësimi organikë, ndërsa specialisti financës ka realizuar përputhjen e shpenzimeve të programuara me ndjekjen e zbatimit të buxhetit duke siguruar zbatimin e dispozitave ligjore të pagave. Në mbështetje të urdhrit të të lartpërmendur të Kryeministrit “Për periudhën raporesh të viteve 2017; 2018, numri punonjësve në organikë të ZVRPP-së është miratuar me 4 punonjës, konkretisht 1 regjistruar, 1 specialist regjistrimi dhe hatografisë 1 punonjës i financës dhe 1 jurist me kontratë,

Nga auditimi dokumentacionit vënë në dispozicion (listë pagesat, libri i pagave, shkresat e emërimit, si fotokopje të dosjeve të personelit, etj) konstatohet se, numri punonjësve me organikë të miratuar është i plotësuar, ndërsa janë respektuar kategoritë e pagave përkatëse. Gjatë periudhës objekt i auditimit ka patur lëvizje në pozicionin e regjistruar.

Në strukturën organike të miratuar mungon përfshirja e pozicionit arkivist/protokollist, rol të cilin e kryen specialistja e financës e patrajnua në këtë fushë, ndërsa arkiv/protokolli duhet të funksionojë mbështetur në zbatimin e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivën” dhe Manualit rregullator “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Miratimi i strukturës dhe nivelit të pagave për secilin pozicion janë sipas lidhjes 2/2 të përcaktuara në kategoria III-b me grupin 1 Drejtor dhe IV-b grupi 1, ose 2 ose 3 duke përcaktuar dhe kushtet e punës.

Struktura organizative e miratuar për periudhën 2017-2018) përbëhet nga:

Nr	Emërtimi	Viti 2017			Viti 2018		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Numri i Punonjësve	4	4		4	4	
2	Llog (600) Pagat	2566	2,547	99.2	2888	2839	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

3	Llog. (601) Sigurime Shoq e Shëndet	431	425	98.6	484	439	
	Totali	2997	2972	98.3	3332	3278	98.4

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese në total për 2017 është 98.3%, dhe për 2018 është 98.4 %. Mosrealizimi i fondit të pagave është më masë të papërfillshme, kryesisht ka ardhur si rezultat i parashikimit me rezerva në drejtim të kualifikimeve, vjetërsisë në punë etj.”. Po kështu edhe mosrealizimi fondit në zërin “Sigurime shoqërore” ka ardhur si rezultat i mosplanifikimit të saktë të pagave, mbi të cilën janë përllogaritur fondi për kontributin e sigurimeve shoqërore. Njësia shpenzuese nuk ka përllogaritur shpenzime për vendime gjyqësore.

-Krahasimi përmbledhës së listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer.

U bë krahasimi përmbledhës së listë pagesave me likuidimet ku nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nënpunësi urdhërues, zbatues (kontabilisti) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit Gramsh.

-Respektimi dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja e azhurnimi periodik i rregjistrimit të punëmarrësve (libri pagave).

Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 589, datë 17.07.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit”, lidhja 1 “Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimtë të këtij vendimi” dhe lidhja nr. 9/4 “Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në drejtoritë e e ZVRPP-ve ndryshuar me VKM nr.109, datë 12.07.2007. Nga Financa është mbajtur libri pagave, janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën nga emërimi dhe fillimi i marrëdhënieve të punës, të rakorduar me listë pagesat.

Nga auditimi me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori I-rë 2017, 3/mujori II-të 2018) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezë e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përllogaritjet e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë sipas klasave përkatëse për çdo kategori punonjësish si dhe ndalesat janë përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimet e të ardhurave, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës, në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.09.2013 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në UMF nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve. Për periudhën objekt auditimi nuk rezultuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës, si dhe nuk janë kryer pagesa dhënie ndihmë ekonomike për punonjës nga zëri “fondi veçantë”.

-Administrimi i dosjeve të personelit dhe regjistrimit të personelit.

Mbështetur në VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së personelit” janë kryer veprime në regjistrin themeltar në bazë të shkresave të emërimeve dhe lirimeve nga ZQRPP. Regjistri i nëpunësve është mbajtur dhe azhurnuar periodikisht sipas nëpunësve. Janë mbajtur dosjet e punonjësve ku janë të kompletuar me dokumentacionin e duhur. Nga auditimi i dosjeve të personelit (te cilat mbahen si kopje të identifikuar me ato origjinale që administrohen në ZQRPP), rezulton se administrimi dhe inventarizimi i dosjeve ishte bërë në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”. Për periudhën e audituar është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të punonjësve dhe është bashkëlidhur në çdo dosje të nëpunësve. Nga verifikimi i dosjeve rezulton se punonjësit nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, por të kontratës së punës.

Personeli sipas pozicioneve dhe arsimimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pozicioni	Dt. Emerimi	Dt. Lirimi	Emer	Mbiemer	Arsimi (Bachelor/MSC)	Lloji Diplomes
Drejtor	18.01.2018	=	Xhilson	Bajrami	MSC	Jurist
Hartograf	01.01.1999	=	Nerenxa	Zhupani	MSC	Agr-Juriste
Juriste	12.09.2018	=	Marije	Veliu	MSC	Juriste
Specialiste e Financave	1.10.1996	=	Behare	Zhupani	MSC	Financë

- Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

-Auditimi mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare e letrave me vlerë nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, në lidhje me veprimet ekonomike të kryera me pagesat nëpërmjet bankës.

Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se; veprimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të çdo urdhër shpenzimi i nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuara nga nëpunësi i degës Thesarit Gramsh dhe të vulosura nga dy palët.

Urdhër shpenzimet në të gjitha rastet kanë bashkëlidhur dokumenta vërtetues, autorizuese, justifikues sipas natyrës së shpenzimit përfshirë; (autorizim, urdhër prokurimi, procesverbal, oferta ekonomike, kontrata, fatura furnitori, preventiva e situacione, etj, etj), ndërsa për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletëhyrja e artikullit të blerë. Vlerat e shënuara në urdhër



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin. Kontabilizimi veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit e natyrës së shpenzimit llog.(602), ndërsa totali shpenzimit mujor e progresiv kuadron me konfermat bankare mujore.

-ZVRPP Gramsh evidentimin e organizimin e procedurës së blerjeve me vlerë të vogël, për periudhat objekt auditimi të viteve 2017 dhe 2018, ka vepruar duke mbajtur regjistrat e parashikimit të prokurimeve publike të cilët i ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 janar të çdo viti, si dhe shtesat për gjatë vitit me regjistra shtesë, në përputhje me nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pasqyruar paraqiten e prokurimeve me vlerë të vogël;

Nr	Periudha	Objekti	Fondi në 000/lekë	Koha	Procedura	Financimi
1	2017	Kancelari	455	Gjatë vitit	B.Vogël	Buxheti
2	2018	Kancelari	461	Gjatë vitit	B.Vogël	Buxheti
		Totali	916			

Për organizimin e procedurës së blerjeve Titullari ka nxjerr urdhërat e prokurimit për krijimin e komisioni të blerjeve me vlerë të vogël i përbërë nga Behare Zhupani kryetare, Erion Mullai dhe Nerenxa Zhupani anëtar.

Në regjistrat e prokurimeve janë parashikuar shpenzime për t’u kryer me procedurë “blerje e vogël”, por konstatohet se komisioni i autorizuar për realizimin e procedurës së blerjes në vitin 2017 në asnjë rast nuk ka evidentuar dhe kryer procedurën me prokurim elektronik, për pasojë edhe njoftim për klasifikimi ofertave konkurruese nuk është njoftuar ofertuesi që nuk janë kualifikuar për mungesa në dokumentacion.Në të gjitha rastet e prokuruar fituese është ofertuesi i pare veprim në përputhje me Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, dhe nuk ka qenë e nevojshme zbatimi i pikës 5 e riformuluar ku citohet qartë; “Kur Autoriteti Kontraktor kalon tek ofertuesi i renditur në vend të dytë dhe në vijim, ka detyrimin ta njoftojë atë menjëherë nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës”, në mospërputhje me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” i ndryshuar.

Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera për “blerje evogëla” për likuidimin e faturave të subjektit furniture nëpërmjet veprimeve me bankë,” nuk u konstatuan mangësi e shkelje.

Konkretisht në analizë për çdo shpenzim :

1-Me Urdhër shpenzim nr.14, datë 24.02.2017 është kryer pagesa në shumën 9,980 lekë me përfitues A.C me status Person fizik” për likuidimin e faturës me objekt; “blerje kancelari material pastrimi”. Kjo pagesë bashkangjitur është shoqëruar me urdhër prokurimin nr.2, datë 20.02.2017 (blerje e vogël); fatura e thjeshtë tatimore nr.61, datë 24.02.2017 me vlerë 9980 lekë; urdhëri titullarit nr.2 datë 18.02.2017 “Për ngritje komisioni marrje në dorëzim të punimeve” i përbërë nga B. Z, kryetar, E. M dhe N. Z, anëtar, me procesverbalin e marrjes në dorëzim datë 24.02.2017.08.2015 me arsyetimi se; “malli plotëson specifikimet e kërkuara”me analizë për specifikimet).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Nga auditimi i procedurës së prokurimit e realizuar “blerje me vlerë e vogël” rezulton se, shpenzimi është kryer me procedurë me vlerë nën 9980 lekë (formulari 5), ndërsa referimi ligjor i pasqyruar në urdhërin e prokurimit i përket procedurës “blerje e vogël” me sistem elektronik ku bashkëlidhur janë ; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese, procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, tërheqje nga operatori i ofertës fituese nuk ka pasur, veprimet janë kryer në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24; 10; 11; 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, si dhe Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar.

2-Me Urdhër shpenzimi nr.15, datë 17.02.2017 është kryer pagesë në shumën 99,800 lekë me përfitues subjekti “Sinteza CO” shpk Tiranë për likuidimin e faturë blerje me objekt “riparim fotokopjuesi”. Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimi nr.1, datë 14.02.2017 (blerje e vogël); procesverbalin me vlerë nën 100000 lekë (formulari 5) me formular oferta testim tregu, nuk ka procesverbal për shpallje fitues i mbajtur nga KBVV i përbërë B.Z kryetar, E.M dhe N.Z, anëtar.

Fatura tatimore me tvsh nr.292 , datë 15.02.2017 e shoqëruar me kasë fiskale; kaluar në shpenzime sipas procesverbali marrjes në dorëzim nr.1, datë 15.02.2017 firmosur nga komisioni lartpërmendur me arsyetim se; “u bë marrja në dorëzim e mallit sipas ofertës dhe plotëson të gjitha specifikimet e duhura”.

Nga auditimi i procedurës së realizuar “blerje vogël” rezulton se, blerja është kryer me procedurë me vlerë nën 100,000 lekë (formulari 5), ndërsa referimi ligjor i pasqyruar në urdhërin e prokurimit i përket procedurës “blerje e vogël” jo elektronik. Por sipas ftesës për ofertë me kërkesat kualifikuese, procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, nuk ka tërheqje nga subjekti fitues i ofertës, veprime janë kryer në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24; 10; 11; 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36, si dhe Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar.

3-Me Urdhër shpenzimin nr.16, datë 10.03.2017 është kryer pagesë në shumën 11000 lekë me përfitues subjekti “Piro Verueshi” me status person fizik, për likuidimin e faturë blerje me objekt “blerje materiale kancelarie”. Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimi nr.3, datë 07.03.2017 (blerje e vogël); procesverbalin me vlerë nën 100,000 lekë (formulari 5) me formular oferta për testim tregu, nuk ka procesverbal për shpallje fitues i mbajtur nga KBVV i përbërë B.Z kryetar, E.M dhe N. Z, anëtar.

Fatura tatimore e thjeshtë shitjes nr.4, datë 07.03.2017 është shoqëruar me kasë fiskale; fletëhyrja në magazinë nr. 1, datë 07.03.2017 dhe procesverbali marrjes në dorëzim datë 07.03.2017 të 13.04.2017 i firmosur nga komisioni i lartpërmendur).

Nga auditimi i procedurës së realizuar “blerje vogël” rezulton se, blerja është kryer me procedurë me vlerë nën 100,000 lekë (formulari 5), ndërsa referimi ligjor i pasqyruar në urdhërin e prokurimit i përket procedurës “blerje e vogël” me sistem elektronik ku bashkëlidhur mungojnë; ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE; procesverbali KBVV për vlerësimin e ofertave pjesmarrëse me vlerë e vogël, nuk ka asnjë njoftim nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve) për njoftim, skualifikim, apo tërheqje nga oferta, veprime në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24; 10; 11; 12 dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetve në sektorin publik”, pika 35; 36, si dhe Udhëzimi nr.3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar.

4-Me Urdhër shpenzimin nr.23, datë 21.04.2017 është kryer pagesë në shumën 10000 lekë me përfitues subjekti “ Piro Verushi” me status person fizik, për likuidimin e faturë blerje me objekt “blerje materiale kancelarie”. Kjo pagesë është shoqëruar me; urdhër prokurimi nr.4, datë 19.04.2017 (blerje e vogël); procesverbalin me vlerë nën 100,000 lekë (formulari 5) me formular oferta testim tregu, është mbajtur procesverbal për shpallje fitues i mbajtur nga KBVV i përbërë B.Z kryetar, E. M dhe N.Z, anëtar.; fatura tatimore e thjeshtë shitjes nr. 8, datë 14.09.2017 e shoqëruar me kasë fiskale; fletëhyrja në magazinë nr.2, datë 14.04.2017 dhe procesverbali marrjes në dorëzim nr.4, datë 1.04.2017 nga B.Z kryetar, E.M dhe N.Z, anëtar me arsyetim se; “u bë marrja në dorëzim e mallit sipas ofertës dhe plotëson të gjitha specifikimet e duhura”, (por pa analizë se çfarë specifikime).

-Administrimi aktiveve qarkulluese të administruara në magazinën e njësisë shpenzuese.

Njësia shpenzuese nuk ka në administrim AQT të patundshme si ndërtesa, mjete transporti, apo shpenzime në proces për rritje AQT e në proces për transferime kapitale, etj, Magazina funksionon duke administruar e dokumentuar lëvizjen e vlerave materiale sipas parashikimit në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe auditimin” dhe aktet nënligjore të dalë në zbatim. Dokumentimi vlerave materiale në kontabilitet, rakordimi dhe kuadrimi tyre në mënyrë analitike është pasqyruar dhe në pasqyrat financiar. Hyrjet dhe daljet e materialeve dokumentohen në kontabilitetit bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike në eksel. Çdo regjistrim kontabël bëhet i dokumentuar me fletë hyrje sipas faturës shitësit dhe fletë dalje me autorizim nga nëpunësi urdhërues, ndërsa dokumentacioni konfirmohet nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim, ku rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Janë hapur 3 kartela për zyrat dhe punonjësit me inventar ekonomik dhe objekte inventar të tërhequr nga magazina, mbi të cilat specialisti financës siguron kontrollin e vlerave materiale gjatë kohës që ato janë në ngarkim nga punonjësi duke dokumentuar për çdo rast lëvizje, shpërdorimi, dëmtimi, apo humbje. Në magazinë rezultoi se nuk ka diferenca ndërmjet vlerës konatabile e paraqitur në pasqyrën financiare dhe vlerës kontabile në kartelën e magazines më datat 31.12.2017 kërkesë kjo në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

-Pasqyrat financiare (bilanci kontabël) të njësisë shpenzuese ZVRPP Gramsh për periudhat raportuese 2017 dhe 2018.

U krye auditimi dhe nuk u konstatuan mangësi mbi rregullshmërinë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, shumat e llogarive të aktivitetit të pasivitetit përputhen me shumat e anekseve të pasqyrave financiare, kuadrimit të llogarive sintetike kuadrojnë me ato analitike për gjendjet e llogarive në fund të vitit. Llogaritë që evidentohen në aktiv dhe pasiv të pasqyrës financiare gjendje më datë 31.12.2017 konstatohet se, janë hedhur në pozicionet e duhura, ndërsa nga krahasimi gjendjes së llogarive të periudhës së mëparshme në fund viti 2016 me ato të paraqitura në mbyllje të pasqyrës financiare të periudhave raportuese objekt auditimi 2017 gjendjet rezultojnë si më poshtë:

në/000 lekë				
Grupet	Emërtimi	Ushtrimi parardhës 2016	Ushtrimi i mbyllur 2017	Ndryshimet
A	Aktive të qëndrueshme	4,016,021	3,840,795	175,226
B	Aktive qarkulluese	1,799,517	590,175	1,209,342



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

C	Llogari të tjera aktive	0	0	0
	Totali	5,815,538	4,430,970	1,384,568

Për periudhën ushtrimore të vitit 2017;

Për këtë periudhë raportuese si gjendje fillestare e mbartur nga periudha ushtrimore e mëparshme, është marrë gjendja kontabile e fizike e transferuar nga viti 2016 e më parë.

Aktivitet e vitit 2017 janë bërë hyrje në magazinë e dokumentuar me fletë hyrje nr.16 datë 30.12.2017, në gjendjen kontabile të njësisë shpenzuese, ndërsa llog.218) me vlerë 14,000 lekë në zbatim të urdhërit të ZQRPPP me fletë dalje nr.22, datë 31.12.2017.

Për periudhën ushtrimore 2017; Zyra e financës në përfundim të periudhës raportuese me shkresë nr. port, datë 2246/30 datë 19.02.2017 ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Gramsh përgatitjen e raportimin e pasqyrave financiare vjetore të njësisë shpenzuese me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

Të dhënat në tabelë që pasqyrojnë aktivin e bilancit kontabël në datën 31.12.2017, rezulton se “Aktivitet e Qëndrueshme” zënë 86.6 % të vlerës totale të aktivitet, e cila e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2016 “Aktivitet e Qëndrueshme” janë rritur në si pasojë vetëm e vlerës së amortizimit, ndërsa gjendja fizike është e pa ndryshuar (pa shtesa e pakësime).Në llogarinë “Aktivitet të qëndrueshme të trupëzuara” pasqyrohet vlera 1,988,161 lekë) e analizuar me llog.(214) “Instalime teknike makineri, pajisje e vegla pune” me vlerë fizike të pa ndryshuar në shumën 1,965,766 lekë dhe llog.(218) “Inventar ekonomik” me vlerë fizike të pa ndryshuar për 1,515,512 lekë.

Llogaria “Aktivitet Qarkulluese” zënë 13.3 të vlerës totale të aktivitet e cila e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2016 “Aktivitet Qarkulluese” janë pakësuar në vlerë 1,209,342 lekë (1799517-590175), kryesisht me ndryshime ku pasqyrohet llogaria 512 bnka e cila nuk është mbyllur në 31.12.2017 por është xhiruar me datë 5.01.2018.

“Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” me llog.(4342) “Të tjera operacione me shtetin (debitorë)” për shumën 250,509 mijë lekë në fund të periudhës i përket shpenzimeve për pagat e muajt të fundit të vitit raportues.

Në grupi A pasivit; llogaria “Fondet e veta” në fund të periudhës raportuese të vitit 2017 janë paraqitur në shumën 4,076,255 lekë, krahasuar me periudhën parardhëse në shumën 4,251,451 lekë, rezultojnë të jenë pakësuar për 175,196 lekë si efekt i llogaritjes së amortizimit të aktiveve.

Në grupin B të pasivit “Detyrime Qarkulluese ” në fund të periudhës raportuese në datë 31.12.2017 pasqyrohen me shumën 354,729 lekë, ndryshimi nga gjendja në fillim të periudhës në shumën 251,596 lekë rezulton me shtesë shuma 103, 133 lekë dhe e analizuar llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to” për shumën 174,412 lekë , llogaria 431 “Shteti tatim taksa” për shumën 16,206 lekë, llogaria 435 “Sigurime shoqërore” për shumën 52,593 lekë, llogaria 436 “Sigurime shendetësore” për shumën 7,298 lekë dhe vlera 93,220 lekë marrëdhnie me institucione të tjera që përfaqson letra me vlerë (pulla) të pa përdorshme dhe që duhen rigrumbulluar nga ZQRPPP.

Pjesë e bilancit është edhe pasqyra e konsoliduar e të ardhurave e shpenzimeve të funksionimit e cila paraqitet si me poshtë:

Emërtimi	Viti 2017	Viti 2016	Diferenca



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Të ardhura gjithsejt	8,358,248	7,264,210	1,094,038
Shpenzime gjithsejt	4,241,714	3,804,464	437,250
E Ardhura neto e konstatuar	4,116,534	3,549,746	566,788
Nga kjo			
Grante të konstatuara nga funksionimi	4,116,518	267,255	3, 849,,263

Nga sa sipër konstatohet se në vazhdimësi ZVRPP Gramsh ka mbuluar shpenzimet dhe ka krijuar të ardhura ku konkretisht per vitin 2017 janë rritur për shumën 3,849,746 lekë.

Për periudha ushtrimore 2018;

Zyra e financës në përfundim të periudhës raportuese me shkresë nr. 182 port, datë 22.02.2019, ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Gramsh përgatitjen e raportimin e pasqyrave financiare vjetore të njësisë shpenzuese me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

Nr	Referenca llogarive	Emërtimi	Ushtrimi mbyllur	Ushtrimi paraardhës
1	Gr A	1.Aktivet afat shkurtera	5,690,939	4,430,970
		2.Aktive qarkulluese	235,430	235,430
		3.Llogari të arkëtueshme	91,085	250,509
		4. Aktive Afat gjata jo materiale	-	-
		5 .Aktive Afat gjata materiale	4, 073,035	3,840,795
2	Gr B	Pasivet (Detyrimet) afat shkurtëra	1,382,204	354,729
	Gr C	Aktivet neto / fondet (A-B)	4,308,735	4,076,241
	Gr D	Fondi I konsoliduar	4,308,735	4,076,241
	GR E	Totali I pasiveve	5,690,939	4,430,970
	Kontgrolle	Shifra zero tregon kuadraturën		
		Aktivet neto janë të barabarta me fondin e konsoliduar	0	0
		Totali I aktiveve I barabartë me totalin e pasiveve	0	0

Përmbajtja e bilancit ka ndryshuar në krahasim me priudhat e mëparme. Të dhënat në tabelë paraqiten në aktivet gjithsejt dhe sipas natyrës së tyre “aktive afat gjata” dhe “aktive afat shkurtëra”. Në datën 31.12.2018 “Aktivet ” e krahasuar me periudhën ushtrimore parardhëse 2017 “Aktivet ” janë rritur në vlerë 1,259,969 lekë si pasojë rritjes se vetëm me vlerën e amortizimit, ndërsa gjendja fizike është e pa ndryshuar (pa shtesa e pakësime) të ndara në “Aktive afat gjata materiale e analizuar me llog 212) (në shumën 2,205,644 lekë në zerin ndërtesa konstuksione, llog .(214) “Instalime teknike makineri, paisje e vegla pune” me vlerë fizike të ndryshuar për shumën 857,448 lekë dhe llog.(218) “Inventar ekonomik” me vlerë fizike të ndryshuar për shumën 1,010,213 lekë.

Ndërsa “llogarita të arkëtueshme”, kryesishtë pasqyrohet me ndryshmet e (Klasa 4) “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” me llog.(4342) “Të tjera operacione me shtetin (debitorë)” në çelje të periudhës ushtrimore nga 91,085 lekë për veprime që akëtohen gjatë periudhave të mëvonëshme të vitit 2019 si rimbursim nga shteti për drejtat e krijuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

-Llogaritë (423-429); “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” në fund të vitit 2018 rezulton me gjendje debitore (0) lekë me të njëjtën gjendje në fillim të vitit pa analizuar sipas llogarive në aktiv të bilancit për tepricë kreditore dhe llog. (435) “Sigurime shoqërore” në fund të vitit 2017 rezulton me gjendje debitore (0) lekë, nga (0) lekë në fillim të vitit e pa analizuar sipas llogarive në aktiv për tepricën debitore.

Në grupi **B** pasivet; paraqiten detyrimet për llogari të pagueshme si detyrimet për tatim taksa, në shumën 18,809 lekë, sigurime shoqërore për 63,907 lekë, sigurime shendetësore për shumën 8,669 lekë, marrëdhënie midis institucione për 1,280,119 lekë, veprime këto kundërparti të gjendjeve të llogarivë në active të bilancit dhe që sistemohen në fillim të vitit pasardhës 2019. Pra, llogaritë kreditore (42; 435; 436) përfaqësojnë detyrime në mbyllje të vitit ushtrimor për paga, sigurime shoqërore (pa sigurim shendetësore) e tatim page të përlllogaritura të muajit dhjetor të cilat kuadrojnë me pagesat e kryera në vitit pasardhës muaji janar të 2019.

Bilanci paraqitet i kuadruar si shume e Grupit $A = B + C$

-Auditimi mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit rezultoi se:

Njësia shpenzuese ZVRPP Gramsh organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka realizuar nëpërmjet regjistrimit të veprimeve (në mënyrë manuale dhe excel) i faturave të blerjes. Njëkohësisht janë regjistruar fletë hyrjet dhe daljet përkatëse të prera për lëvizjen nga magazina. Janë regjistruar shpenzimet e kryera me rakordimet përkatëse nga specialisti fiancës dhe në fund të periudhës janë bërë azhurnimet në librat përkatës, ditar, partitar, libri i madh, ditari i veprimeve të ndryshme me regjistrimet kontabile me rakordim të pagave. Pasi bëhen regjistrimet kontabile dhe inventari fizik i aktiveve është ndërtuar pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa në fund të periudhës ushtrimore është ndërtuar “Bilanci Kontabël” i periudhës raportuese përkatëse me konfirmim nga dega e thesarit Gramsh

Inventarizimi i pronës shtetërore, sipas llogarive të aktiveve e pasurisë publike dhe regjistrimi në zyrat e pasurisë.

-Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të aktiveve, pasurisë publike rezultoi se:

Në zbatim të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”, pika 1, neni 7 “Inventari aktiveve e detyrimeve”; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve”, si dhe Udhëzimi nr.28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike” në ZVRPP Gramsh u audituan procedurat e ndjekura nga njësia shpenzuese për kryerjen e inventarizimit të pasurisë “aktive të qëndrueshme të trupëzuara”; “gjendje inventari”; “materiale” e “objekte inventar”.

1-Komisionet e inventarizimit të ngritura me urdhërin e titullarit, në fillim të procesit të inventarizimit, kanë në dispozicion listën e aktiveve për inventarizim e hartuar nga Nënpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në regjistrat kontabël të njësisë, në mospërputhje me pika 81 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni inventarizimit.

2-Në momentin e fillimit në objekt të procesit të inventarizimit, anëtarët e komisionit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata, në se kanë ose jo konflikt interesi me punonjësin me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive edhe në rastin kur anëtar komisioni inventarizimi është drejtuesi i njësisë që inventarizohet, njëkohësisht dhe përgjegjës material,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82, ku përcaktohet se: “.. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi..”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

3-Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar aktrakordim për të përcaktuar dhe fiksuar në cdo objekt që inventarizohet, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, veprim në mospërputhje me pika 83 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e cila përcakton qartësisht se: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dylllosja e magazinës. Hapja e mbyllja bëhet në prani të komisionit e përgjegjësi material”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

4-Komisioni në asnjë fletë inventarizimi fizik i kryer në objektet të njësisë shpenzuese ZVRPP Gramsh, nuk ka pasqyruar në lidhje me gjendjen cilësore me evidentim (jashtë përdorimi) të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave materiale mbi të cilën njësia shpenzuese të bëjë vlerësimin e gjendjes cilësore të tyre, veprim në mospërputhje me pika 85, gërma (a); 86 dhe 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion në zbatim të urdhërit të titullarit për realizimin inventarizimit fizik të aktiveve, pasurisë, aseteve e gjendjes materiale rezultoi se; Komisioni në përfundim të procesit të inventarizimit ka evidentuar gjendjen fizike të krahasuar me gjendjen kontabile e pasqyruar në fletët e inventarizimit fizik, sipas objekteve të inventarizuara me llogari inventariale dhe ka përpiluar përmbledhëse me rezultatet e inventarizimit, duke pasqyruar e shqyrtuar gjendjen fizike në datë 31.12.2017 sipas llogarive të inventarizuara sa më poshtë;

Me urdhër të ish Dreejtorit F.H nr. 1 datë 30.12.2017 është ngritur komisioni për inventarizimin e pasurive të paluajtshme i përbërë nga B.Z kryetare dhe E.M dhe N.Z antar.

-Grupi A-Kreu II “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

-llog.(214) me gjendje fizike prej 1,965,766 lekë.

-llog.(218) me gjendje fizike prej 1,515,512 lekë.

-Grupi B-Aktive Qarkulluese, Kreu I “Gjendje inventari”.

-llog.(32) me gjendje fizike prej 235,430 lekë.

Totali inventarizimit fizik 3,716,708 lekë

Referuar rezultateve të pasqyruara në përmbledhësen e inventarizimit fizik, gjendja fizike e vlerave të aktiveve të pasurisë dhe aseteve të institucionit në datën 31.12.2017, e krahasur me gjendjen e kontabile e pasqyruar në përfundim të periudhës raportuese në pasqyrën financiare datë 31.12.2017, për 3 llogaritë e inventarizuara, rezulton e barabartë pa diferenca.

Në periudhën raportuese objekt auditimi në vitin 2017, referuar formularit nr.6 bashkëlidhur pasqyrës financiare konstatohet senjësia shpenzuese nuk ka nxjerr jashtë përdorimit vlera materiale të sygjëruara nga komisioni vlerësimit.

Për sa sipër nuk ka qenë e nevojshme të krijohen Komisioni për vlerësimin për tu nxjerr jashtë përdorimit, si dhe komisioni i asgjësimit të materialve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Për vitin 2018

Me urdhër të Drejtorit X.B nr. 1 datë 30.12.2018 është ngritur komisioni për inventarizimin e pasurive të palujtëshme i përbërë nga B.Z kryetare dhe E.M dhe N.Z antar. Komisioni i inventarizimit është njëjtë me atë të vitit të mëparshëm ç'ka është në kundërshtim me ligjin, por për mungesë personash praktikisht ka qenë e pamundur.

-Grupi A-Kreu II “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

-llog.(214) me gjendje fizike prej 857, 448 lekë.

-llog.(218) me gjendje fizike prej 1,010,213 lekë.

-Grupi B-Aktive Qarkulluese, Kreu I “Gjendje inventari”.

-llog.(32) me gjendje fizike prej 235,430 lekë.

Totali inventarizimit fizik 2,103,091 lekë

Referuar rezultateve të pasqyruara në përmbledhësen e inventarizimit fizik, gjendja fizike e vlerave të aktiveve të pasurisë dhe asetëve të institucionit në datën 31.12.2018 e krahasur me gjendjen e kontabile e pasqyruar në përfundim të periudhës raportuese në pasqyrën financiare datë 31.12.2018, për 3 llogarit e inventarizuara rezulton e barabartë pa diferenca.

Në periudhën raportuese objekt auditimi të vitit 2018, referuar formularit nr.6 bashkëlidhur pasqyrës financiare, njësia shpenzuese nuk ka nxjerr jashtë përdorimit vlera materiale të sygjera nga komisioni vlerësimit,

Për sa sipër nuk ka qenë e nevojshme të krijohet komisioni për vlerësimin për t'u nxjerr jashtë përdorimit, si dhe komisioni i asgjësimit të materialve.

Për problemet e trajtuara u mbajt akt konstatimi nr. 3, datë 31.05.2019.

Pika 8. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit “Nr. 209/1, datë 01/04/2019”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

4) Praktikë në proces, shoqëruar nga relacionin përkatës.

5) Dokumentacioni i paraqitur nga përgjegjësit e sektorëve përkatës dhe specialistët për praktikë në proces.

6) Dokumentacioni i administruar në arkivë, praktikë, referencat dhe Av.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e ish-ZVRPP Gramshnuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përsa i përket administrimit të praktikave në proces dhe dhënien e shërbimit të kërkuar qytetarit, referuar:

5) Nenit 20 të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”,

6) Ligjit nr. 9154, datë 06.01.1993 “Për Arkivat”,

7) Pikës 7 të Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për Punën në ZVRPP”, të ndryshuar, Udhëzimit Metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

8) Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,

9) Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP”, në të cilat ndër të tjera përcaktohet:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Nenin 20 i ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, *Regjistruesi ka këto kompetenca:*

a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për realizimin e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të saj, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi;

ç) të kërkojë me shkrim ose me shkresë zyrtare nga personi i interesuar që, brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë, të paraqesë dokumentet e pronësisë, certifikatat, çdo dokument tjetër apo plan rievimi, të lidhur me pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën në fjalë. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar kërkesa për regjistrim refuzohet;

d) të thërrasë çdo person të interesuar që të paraqitet tek ai ose te ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, për të dhënë informacion ose shpjegim për pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën;

dh) t'i propozojë Kryeregjistruesit refuzimin e regjistrimit kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj;

e) të administrojë dhe të verifikojë të dhënat e përcaktuara në shkronjat "c", "ç", "d" dhe "dh" të këtij neni;

ë) t'i kërkojë personit, që paraqet një informacion jo të rregullt, që t'ia paguajë zyrës së regjistrimit shpenzimet që ajo ka kryer në procesin e verifikimit të këtij informacioni jo të rregullt.

Pika 7 –Arkiva, e Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për Punën në ZVRPP”, të ndryshuar,

7.1. Arshivon dokumentat e pershkrura ne piken 4: (4/2, 4/3, 4/4, 4/6, 4/7, 4/9,4/11),

7.3. Pas perfundimit te te gjitha procedurave te regjistrimit dhe nenshkrimit teAplikimit nga Regjistruesi, dokumentin dhe dy kopjet e Aplikimit i pranon per arkivim. Ploteson kuadratin “Arkivimi Manual” te Aplikimit dhe vendos ne zarfin perkates dokumentin bashke me kopjen e pare te Aplikimit. Kopja e dyte i jepet Aplikantit.

7.4.I pergjigjet me dokumentacionin e nevojshem punonjesve te ZRPP sipas kerkesave paraprake te bera prej tyre. Cdo levizje ditore e dokumentave apo hartave jashte arshives regjistrohet ne “Regjistrin e veprimeve ditore te dokumentave te arkivit”, etj.....

Nga Auditimi rezultoi që:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me auditimin e gjendjes, evidentimit nga ZVRPP dhe ecurinë e regjistrimit të pasurive që lidhen me aplikimet e qytetarëve por që nuk kanë marrë zgjidhje dhe të mbetura në proces, për periudhën 01.01.2017 deri në 31.12.2018, sipas pikës nr. 8, të programit të auditimit nr. 209/1, datë 01/04/2019, u konstatua se:

1. Nuk ka një rregullore të brendshme të Funksionimit të Administratës së ish- ZVRPP Gramsh, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2017-2018, të bazuar në organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr.33, datë 2.4.2013, Të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, dhe Urdhrave nr. 58, datë 23.04.2009, nr. 33, datë 02.04.2014 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", përveç se është një rregullore tekniko ligjore e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësisë të secilit specialist sipas sektorëve, Regjistruesit, lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur me administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj, pra mungon **Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB)**, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

2- Nga Regjistruesit marrës në dorëzim dhe dorëzues të detyrës nuk u paraqitën akt-dorëzimet apo procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe dorëzimin e detyrës për praktikën dhe dokumentacionin nga secili Regjistrues-dorëzues dhe regjistrues-marrës detyre. Theksojmë se mos dorëzimi dhe mosmarrja e detyrës me procesverbal bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe me udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Përgatitja, ndjekja, dhe raportimi i evidencave përmendur më sipër, në një masë të konsiderueshme shprehin performancën e punës së secilit punonjësi por mbi të gjitha performancën e shërbimit të kësaj zyre ndaj qytetarëve duke rritur dhe transparencën e kësaj zyre shtetërore për cilësinë e shërbimit dhënë ndaj publikut.

II. Mbi administrimin e kërkesave dhe aplikimeve të qytetarëve për të cilat është paguar shërbimi por që nuk është marrë.

Nga sa trajtuar ka munguar e nuk është vendosur i shprehur në rregullore detyrimi ndaj sektorëve të krijimit të data-base, për evidentimin e referencave të regjistrimit, aplikimet dhe paraqitjen e dokumentimit të kërkesave të qytetarëve, aplikimeve dhe administrimin e praktikave me aktverifikim për periudhën deri 01.01.2017-31.12.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit nxjerrë nga evidenca kontabile e zyrës së Financës, formulari të ardhurave, si dhe i rakorduar me të dhënat sipas librit të pranimeve për regjistrim të pasurive që i përket 1 zone urbane (qytetit) dhe 92 zonat Rurale për periudhën e auditimit prej 2 vjetësh periudha 01.01.2017 deri 31.12.2018, nga ZVRPP evidentohet të jenë kryer gjithsej 10051 transaksione në total me një vlerë të ardhurash të arkëtuara 26,257,038 lekë, konkretisht gjatë vitit 2017 janë kryer 5841 transaksione me vlerë të ardhurash të arkëtuara 10,114,993 lekë dhe në vitin 2018 janë kryer 4210 transaksione me vlerë të ardhurash të arkëtuara 16,142,045 lekë.

Sipas informacionit të kërkuar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së gjendja e praktikave në proces për periudhën 01.01.2017-31.12.2018, paraqitet e pasqyruar në tabelën nr. 2, "Përmbledhje e praktikave me AV", në seksionin Shtojca.

- Sa sipër rezulton se gjatë periudhës së auditimit ka një numër të vogël të praktikave në proces gjithsej 39 cop me AV, një pjesë e të cilave është mbartur që nga viti 2010.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Të ardhurat e vjela nga aplikimet e qytetarëve dhe duke mbetur praktikat pa zgjidhur dhe në proces, janë të ardhura të arkëtuara të pamerituara sa kohë që shërbimi-produkt nuk është kryer nga kjo zyrë ndërsa qytetari ka paguar duke mos marrë produktin- shërbimin e kërkuar.

Nuk është rregulluar me urdhër të titullarit apo rregullore çelja e llogarisë “Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”, ku të evidentoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkiv, e duke mos i lënë në duar të punonjësve me afate nga 1 e më shumë vite, në kundërshtim me afatin e Kodit të Procedurave Administrative (KPA).

Dorëzimi dhe arkivimi në arkiv i praktikave në proces menjëherë pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, bashkë me njoftimin ti bëhet e ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditore ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i arkivuar pranë ZVRPP.

Ish-ZVRPP Gramsh nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite. Nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit.

Mangësitë e mësipërme në disa raste kanë ardhur edhe për shkak të mosdorëzimit dhe marrjes së detyrës me procesverbal në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13 ku citohet se “Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve”.

Për mangësit e trajtuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. F. H me detyrë ish-Regjistruar, z. X.B me detyrë Regjistruar dhe zj. N.Z me detyrë Specialist.

Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 5, datë 30.05.2019.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0157, ka regjistruar Vendimin nr. 128, datë 07.04.1995 të Komisionit të Kthimit të Kompensimit të Pronave Gramsh, për kthimin dhe kompensimin e pronave z. H.R, i cili i ka njohur dhe kthyer në natyrë në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, neni 16/c, sipërfaqen prej 4116 m², e regjistrua në KPP, vol. 2, fq 178, pasuria nr. 90/4, arë, me sip. 800 m²; KPP, vol. 2, fq 179, pasuria nr. 90/5, arë, me sip.850 m²; KPP, vol. 2, fq 180, pasuria nr. 90/6, arë, me sip.1000 m² KPP, vol. 3, fq 228, pasuria nr. 90/10, arë, me sip.1466 m². Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasi nuk është bërë verifikimi i titullit të pronësisë në ATP, duke qënë se vendimi nuk është përcjellë për regjistrim nga organi që ka nxjerrë aktin, por është dorëzuar nga vetë përfituesi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 35-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

1.1- Rekomandim: Dejtari i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë nr. 90/4, vol. 2, fq 17, nr. 90/5, vol. 2, fq 179, nr. 90/6, vol. 2, fq. 180 dhe nr. 90/10, vol. 3, fq. 228, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.10.2019

2- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish- ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurive “Truall” dhe “Ndërtesë”, në zonën kadastrale 2184, fshatit Zgjupe Kodër, me mangësi në dokumentacion pasi listat emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive janë të pafirmosura nga pronarët e trojeve dhe ish-kryetarët e komunave. Lista përmban gjithsej 42 pronarë dhe nuk ka asnjë shënim mbi numrin e familjeve që janë banuese në fshat me datë 01.08.1991. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1- Rekomandim: Drejtari i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bashkëpunim me Zyrat e Gjendjes Civile, të rakordojë mbi numrin e familjeve që kanë qenë banor me datën 01.08.1991 në fshatrat në juridiksionin administrativ të ish-ZVRPP Gramsh për sa i përket regjistrimit të tokave bujqësore të përfituara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar.

Brenda datës 31.10.2019

3- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer transaksionin e ndarjes së pasurisë mëmë regjistruar sipas AMTP nr. 648, datë 25.02.1992, përfituar sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, duke vijuar në pasurit nr. 389/1, adresa Zgjupe Gramsh, e llojit arë, me sipërfaqe totale 3300 m², regjistruar në vol 2, faqe 161, nr. 340, adresa Gramsh Zgjupe, e llojit arë me sipërfaqe 1425 m², regjistruar në vol 1, faqe 51, nr. 266, me adresë Zgjupe Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 300 m² truall nga e cila ndërtesë 128 m², nr. 339, me adresë Zgjupe Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 1650 m², regjistruar në vol. 1, faqe 50, nr. 264, me adresë Zgjupe Gramsh, e llojit arë me sipërfaqe totale 1000 m², regjistruar në vol 1, faqe 184, nr. 273, adresa Zgjupe Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 1200 m², regjistruar në vol 2, faqe 86; bashkëpronari G.M për sipërfaqen 3300 m², pasuria 364 sipas nr. 207 rep, nr 188 kol, datë 22.03.2000 dhe kartelës nr. serial 567738, pasuria 389/1, vol 2, faqe 161, tokë e llojit arë; - bashkëpronari N.M nr. pasurie 389 sipërfaqe 1500 m², nr. 149 rep, nr. 9 kol, datë 3.02.1999, pa verifikuar më parë respektimin e normës për frymë, pasi në emër të pronarit të familjes bujqësore S.M ekzistojnë dy AMTP, një me nr. 648 datë 25.02.1992 për sipërfaqen gjithsej 10 800 m², me pasuritë nr. 364, 389, dhe 293 si dhe AMTP tjetër me sipërfaqe totale 7800 m². Gjithashtu në ZVRPP mungon lista e ndarjes së tokës për frymë sipas fshatrave. Në ZVRPP Gramsh mungon AMTP origjinale ku sipërfaqja e përgjithshme e familjes bujqësore rezulton të jetë regjistruar 13025 m². Pra nga ZVRPP është regjistruar me shumë **2225 m² tokë bujqësore**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

3.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të verifikohet deri në origjinë kërkesa e qytetarit S.M për ndarjen e pasurisë së regjistruar sipas AMTP nr. 648, datë 25.02.1992, për pasuritë e fituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, konkretisht pasuria nr. 389/1, regjistruar në vol 2, faqe 161, nr. 340, vol 1, faqe 51, pasuria nr. 266, vol 1, faqe 50, pasuria nr. 264, vol 1, faqe 184, pasuria nr. 273, vol 2, faqe 86, pasuria nr. 389/1, vol 2, faqe 161 dhe pasuria nr. 389.

Brenda datës 31.10.2019

4- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë të shtetasit N.M, zona kadastrale 1392, sipas ref. 0418, të fituara sipas AMTP nr. 6726, datë 23.07.1993, për pasurinë nr. 37/1 sip. 1400 m²; nr. 6/49, sip 2000 m²; nr. 7310, sip 2800 m²; nr. 71/23, sip 1500 m²; nr. 32/29, sip 1260 m²; nr. 17/24, sip 1400 m² dhe pasuria 24/4 sip 600 m², gjithsej sipërfaqe 10960 m², ndërkohë që në zonën kadastrale 1392 janë regjistruar pasuritë me nr. 38/39 për sipërfaqe 1500 m², vol 2, faqe 63; nr. 17/24 për sipërfaqe 1400 m², vol 2, faqe 64; nr. 6/49 me sipërfaqe 1900 m², vol 2, faqe 60; nr 73/10 me sipërfaqe 2800 m², vol 2, faqe 61; nr. 66/1, vol 2, faqe 15, me sipërfaqe 1600 m² gjithsej sipërfaqe 9200 m² pra më shumë sipërfaqe 1600 m² se sa është çertifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Bashkisë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi si dhe të verifikohet deri në origjinë kërkesa e qytetares N.M për pasurit nr. 38/39, vol 2 faqe 63, zk. 1392, nr. 17/24, vol 2, faqe 64, zk. 1392, nr. 6/49, vol 2, faqe 60, nr 73/10, vol 2, faqe 61, zk. 1392 dhe nr. 66/1 vol 2 faqe 15, zk. 1392.

Brenda datës 31.10.2019

5- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në ZK. 2167, ref. 0887, fshati Kocaj, të shtetasit P.K, të fituar sipas AMTP nr. 6447, datë 10.10.1993, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, për pasuritë nr. 6213, sipërfaqe 2500 m²; nr. 53/14 sip. 800 m², nr.55/9, sip pemtore 2000 m²; nr. 12/11, sip 2000 m²; nr. 1236, sip. 900 m² (me korrigjim me bojë të kuqe), nr. 154/29 sip. 1000 m² si dhe pasuri pa numër, sipërfaqe 400 m² dhe 1000 m², gjithsej sipërfaqe 10600 m². Faktikisht në zonën kadastrale 2167, janë regjistruar pasuritë me nr. 55/14 për sipërfaqe 2000 m², vol 1, faqe 92; nr. 62/22 për sipërfaqe 1000 m², vol 1, faqe 91, regjistruar fillimisht pronë shtet; nr. 62/15 me sipërfaqe 1000 m², vol 1, faqe 69 me shënimin në seksionin E të kartelës si pasuri e okupuar nga shtetasi P.K; nr. 55/15 me sipërfaqe 1200 m², vol 1, faqe 93 dhe nr. 55/9, vol 1, faqe 134, me sipërfaqe 3200 m², gjithsej 8400 m². Në krahasim të këtyre AMTP-ve dhe veprimeve të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në Bashki, ZVRPP Gramsh nuk duhej të vepronte për regjistrimin e pasurive mbasi dokumentacioni i paraqitur ka shkelje dhe mangësi të theksuara, si njoftimi ndaj kufitarëve për ndryshime të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

pronës së certifikuar, AMTP duhej dërguar në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë për verifikimin e ligjshmërisë së saj dhe nuk është përgatitur relacioni në lidhje me këtë AMTP nga ZVRPP, veprime që nuk plotësojnë elementët e formës dhe të përmbajtjes në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për pasuritë me nr. 55/14, me sipërfaqe 2000 m2, vol 1, faqe 92; nr. 62/22, me sipërfaqe 1000 m2, vol 1, faqe 91, regjistruar fillimisht pronë shtet; nr 62/15, me sipërfaqe 1000 m2, vol 1, faqe 69 me shënimin në seksionin E të kartelës si pasuri e okupuar nga z Petrit Koci; nr. 55/15, me sipërfaqe 1200 m2 vol 1 faqe 93, nr 55/9 vol 1 faqe 134, me sipërfaqe 3200 m2, si dhe të njoftohen kufitarët për ndryshimet e pronës së certifikuar.

Brenda datës 31.10.2019

6-Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në zonën kadastrale 3337, ref. 0216, fshati Gurrë, për pasurinë e qytetarit N.M, të fituar sipas AMTP nr. 1624, datë 24.04.1993 për sipërfaqen gjithsej 8695 m2, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", i ndryshuar. Nga auditimi rezulton se praktika nuk ka bashkëlidhur deklaratën e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore duke kërkuar dhe lidhur praktikës deklaratën e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit që nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar.

Menjëherë

7- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasës H.Z, me ref. 1409, zona kadastrale 2764-fshati Cingar i Sipërm, nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë nga trashëgimlënësi S. L. Pasuritë janë të fituara sipas AMTP nr.154, datë 16.03.1991 për sipërfaqen gjithsej 12000 m2. Kjo AMTP, sipas shkresës së Bashkisë Gramsh nr. 816/1 datë 05.02.2018, është certifikuar nga Komisioni për përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe plan vendosjen e pronave për sipërfaqen gjithsej sipas AMTP, 11700 m2 tokë arë dhe truall më pak nga AMTP sipërfaqe 300 m2. Nga auditimi konstatohet se praktika nuk ka



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

bashkëlidhur deklaratën noteriale të pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve për tu shprehur se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Gjithashtu praktikës i është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991, e përbërë prej 5 vetave. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës të fshatit Cingar i Sipërm rezulton se është 1700 m². Familja e S.L ku është anëtar edhe trashëgimlënësi S.L, është e përbërë prej 5 vetash dhe i takon 8500 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe certifikimit nga KV në Bashki ka përfituar 11700 m², pra me shumë sipërfaqe 3200 m², në papajtueshmëri me përcaktimet e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore si dhe dorëzimin e deklaratës së kufitarëve për dakordësinë e ndryshimeve. Gjithashtu të nxjerrë urdhër korigjimi mbështetur në certifikatën familjare të pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë prej 5 vetave dhe tabelës së Komunës Pishaj mbi normativën e ndarjes së tokës për frymë të fshatit Cingar i Sipërm, duke zbritur familjes së shtetasit S.L sipërfaqen 3200 m² dhe kthimin në pronësi shtet.

Menjëherë

8- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka kryer regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit I.M, me ref. 0021, zona kadastrale 2143-fshati Kërpicaq, të fituar sipas AMTP nr. 2351, datë 20.12.1999 për sipërfaqen gjithsej 5174 m², me mangësi në dokumentacion pasi mungon deklarata noteriale e pronarit për dakordësinë e ndryshimeve dhe njoftimin e kufitarëve të pronarit se nuk kanë pretendime ndaj pronës së certifikuar. Gjithashtu praktikës është bashkëlidhur certifikata familjare e pronarit me datë 01.08.1991 e përbërë nga 1 person. Nga të dhënat e tabelës së Komunës Kërpicaq mbi normativën e ndarjes për frymë të tokës rezulton se është 1700 m² dhe familjes Idajet Shaban Mukës e përbërë prej 1 personi i takon 1700 m². Në fakt sipas AMTP së lartpërmendur dhe certifikimit nga KVVTP pranë Bashkisë ka përfituar 5174 m², regjistruar në ZK 2143, veprime këto në papajtueshmëri me përcaktimet e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 20/3, vol 2, faqe 138, në pronësi të I. M, deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe dorëzimin e deklaratës së kufitarëve për dakordësinë e ndryshimeve, duke zbritur sipërfaqen 3474 m² përfituar padrejtësisht dhe kthimin në pronësi shtet.

Brenda datës 31.10.2019

9- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në ZK.2331-fshati Kuretë, sipas ref. 0030, për pasurinë në emër të shtetasit E.H, të fituar nëpërmjet aktit të trashëgimërisë nga babai tij V. H sipas AMTP nr. 3290, datë s'ka, për sipërfaqen gjithsej 24120 m². Kjo AMTP është regjistruar në pronësi të ndjerit në vol 1, faqe 66, pasuria nr. 144, me sipërfaqe 300 m²; nr. 152, faqe 67 me sipërfaqe 8250 m²; nr. 151, faqe 68, me sipërfaqe 1100 m²; nr. 156, faqe 69, me sipërfaqe 3550 m²; nr. 168, faqe 70, me sipërfaqe 1900 m²; nr. 149, faqe 71, me sipërfaqe 2650 m², nr. 155, faqe 72, me sipërfaqe 2350 m², gjithsej 20100 m². Nga auditimi i praktikës konstatohet se duke krahasuar normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës me certifikatën familjare të datës 01.08.1991, nr. 010325762, rezulton se përbërja familjare e V. H është prej 3 veta dhe i takojnë 6000 m² tokë. Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 14100 m² në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991, nr. 010325762, familjes V. H t'i zbritet sipërfaqja 14100 m² duke e kaluar në pronësi shtet.

Menjëherë

10- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në ZK.1994-fshati Jance Qendër, ref. 0029, për pasurinë e qytetarit A.K të fituar sipas AMTP nr. 1186, datë 08.01.1992 për sipërfaqen gjithsej 28300 m². Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës të kryer nga Komisioni i ndarjes së tokës dhe certifikatës së përbërjes familjare të datës 01.08.1991, nr. 010326518, datë 07.10.2016, rezulton se përbërja familjare e A.K është prej 8 veta dhe i takojnë 23320 (8x2915) m² tokë. Pra është regjistruar me shumë sipërfaqja 4980 m², në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

10.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, gjithashtu duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991, nr.01030326518 të familjes A.K t’i zbritet sipërfaqja 4980 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.

Menjëherë

11- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin në ZK.1593- fshati Mashan, ref. 0030, për pasurinë e qytetarit T.Z, të fituar sipas AMTP nr. 2958, datë 30.10.1992 për sipërfaqen gjithsej 20700 m2. Nga auditimi i praktikës konstatohet se bazuar në normativën për frymë të ndarjes së tokës me krahasimin e certifikatës së përbërjes familjare të datës 01.08.1991, nr. 0011843748, datë 12.04.2017, rezulton se përbërja familjare e T. Z është prej 7 veta dhe i takojnë 19600 m2 (8x2800) m2 tokë dhe jo 20700 sipas AMTP lartpërmendur. Pra, është regjistruar me shumë sipërfaqja 1100 m2, në papajtueshmëri me përcaktimet e ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, gjithashtu duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991, nr. 01030326518 të familjes T.Z t’i zbritet sipërfaqja 1100 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.

Menjëherë

12- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurisë në emër të qytetares M., zk.3461-fshati Skanderbegas Gramsh, Ref 01048, të fituar sipas AMTP nr. 2450, datë 03.02.1994. Sipas aktit noterial me nr. Rep 917 dhe nr. 432 Kol, shtetasit B. S, K. H, V.B, S.S, J.S, S.S dhe M.S kanë pjestuar pasuritë nr.179/5 ZK 3461, vol 5, faqe 226, me sipërfaqe 2700 m2 arë dhe truall 300 m2; nr. 167/24, adresa Gramsh, e llojit arë, me sipërfaqe 3200 m2, regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 224; nr. 248/2, me adresë Gramsh, e llojit arë, me sipërfaqe totale 2600 m2 regjistruar në zk. 3461, vol 1, faqe 76; nr. 254/6 adresa Gramsh e llojit arë me sipërfaqe totale 2500 m2 regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 228; nr. 259/6, Zgjupe e llojit arë me sipërfaqe totale 2000 m2, regjistruar në ZK 3461, vol 5, faqe 230, gjithsej pasuria e përpjestuar midis 7 pjestarëve sipërfaqe 13000 m2. Bazuar në certifikatën familjare të datës 02.05.2015, shtetasja A. D konfirmon gjendjen familjare të familjes bujqësore me datë 01.08.1991 dhe sipas normativës për frymë dhe numrit të anëtarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 10000 m2 (4x2500) pra më shumë sipërfaqja 3000 m2, në papajtueshmëri me përcaktimet e nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

“Për Tokën”, ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

12.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, gjithashtu duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991 të familjes T.S t’i zbritet sipërfaqja 3000 m2 duke e kaluar në pronësi shtet.

Menjëherë

13- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit M.Me, zk. 3494- fshati Sotirë Gramsh, ref. 0032. Nga auditimi i mbi arkivimin e AMTP-ve në ZVRPP u gjenden 2 AMTP me të njëjtin numër 2236, e para e vitit 1993 e cila është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e saj, ndërsa AMTP 2236 viti 2000, me komision tjetër të ndarjes së tokës nuk është e rregullt pasi pronari i tokës nuk ka firmosur. Nga ZVRPP janë kryer veprime regjistrimi sipas AMTP së parregullt çka përbën shkelje të zbatimit të ligjit 33/12 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Nga auditimi i plotë si dhe duke analizuar gjendjen e pasurive sipas AMTP, LN printimi tretë dhe plan rievimeve nga matjet në vend rezulton se nga mos trajtimi i qytetarit me AMTP e rregullt nr. 2236 të vitit 1993, nuk janë regjistruar saktë parcelat e ngastrat e përshkruara në pronësi të qytetarit Mersin Merishta, për pasurinë nr. 158 e quajtur Bizhanake, me sipërfaqe 1250 m2 dhe gropa e kajtazit *(Gliqe me sipërfaqe 1800 m2 që aktualisht qytetari e ka në shfrytëzim)*, për pasurinë sipas AMTP me nr. 192, me sipërfaqe 6400 m2, në hartën kadastrale është e paraqitur me ndarjet 192/6, me sipërfaqe 6300 ne pronësi të z. M.M, dhe pasurinë nr. 192/ 7 me sipërfaqe 1750 m2, vol 1, faqe 108 në pronësi të S.D e cila ka mbivendosje. Në këtë kartelet është vendosur shënimi që kjo pasuri sipas aktit ndodhet në pasurinë me nr. 192/10 e cila sipas LN është 1300 m2, pra regjistruar më shumë 400 m2. Nga verifikimi në hartën hipotekore rezulton se kjo pasuri është mbivendosur mbi pasurinë 192/6, e cila është pronësi të shtetasit M.M. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

13.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të fituara me AMTP me nr. 2236, viti 1993 e cila është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e saj.

Menjëherë

13.2- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, të njoftojë qytetarët M.M dhe S.D për statusin juridik të pasurisë sipas AMTP me nr. 192 me sipërfaqe 6400 m² e cila në hartën kadastrale është e paraqitur e ndarë në pasurit nr. 192/6, me sipërfaqe 6300 në pronësi të M.M dhe nr. 192/7, me sipërfaqe 1750 m², vol 1, faqe 108 në pronësi të S.D e cila ka mbivendosje.

Menjëherë

14- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka kryer regjistrimin e pasurisë në emër të qytetarit F.L, zona kadastrale nr. 1409-Fshati Cingar i Sipërm Gramsh, Ref 0020, sipas AMTP nr. 379, datë 28.07.2000 bazuar në dëshminë e tashëgimisë të hartuar për trashëgimlënësen F.L. Origjina e pasurive vjen nga regjistrimi i AMTP nr. 379(153), datë 28.07.2000, regjistruar me sipërfaqe 11250 m². Bazuar në certifikatën familjare të datës 04.01.2015 e cila konfirmon gjendjen familjare të familjes bujqësore me datë 01.08.1991, rezulton se në pronësi të pronares janë regjistruar dhe më pas janë përpjestuar pjestarëve sipërfaqja 11250 m² tokë bujqësore, nga e cila truell 300 m², pra më pak nga sipërfaqja e AMTP nr, 153 datë 16.03.1993. Në fakt sipas normativës për frymë dhe numrit të anëtarëve të familjes të paraqitur në certifikatë, i takon sipërfaqe 8500 m² (5x1700) pra përfituar më shumë sipërfaqja 2750 m², në papajtueshmëri me përcaktimet e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të rikërkojë dhe nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, duke u bazuar në certifikatën familjare të datës 01.08.1991 të familjes F.L, gjithashtu t’i zbritet sipërfaqja 2750 m² përfituar padrejtësisht duke e kaluar në pronësi shtet.

Menjëherë

15- Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pasurive të nënshtruara procesit të shpronësimit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës, rezulton se nga zbatimi i projektit janë prekur gjithsej 326 pasuri të pronarëve dhe fshatrave të ndryshëm, me sipërfaqe totale të shpronësuar 497097 m² me një vlerë totale shpronësimi 94,459,123 lekë. Nga këto pasuri rezultoi se 157 prej tyre me sipërfaqe totale 234362,53 m², edhe pse janë pasuri të pacertifikuara kanë përfituar nga procesi i shpronësimit një vlerë totale 41,013,442.75 lekë, pa u verifikuar më parë ligjshmëria e përfitimit të titujve të pronësisë me AMTP, më hollësisht trajtuar sipas tabelës nr. 1 “Pasuritë e shpronësuar për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës”, në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

15.1- Rekomandim: Dejtari i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të verifikohen rast pas rasti pasuritë të cilat janë nënshtruar procesit të shpronësimit, ligjshmëria e përfitimit të titujve të pronësisë me AMTP përpara procesit të shpronësimit, dhe në rast të konstatimit të paligjshmërive dhe përfitimit të padrejtë të individëve nga procesi i shpronësimit të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerave përkatëse.

Brenda datës 31.10.2019

16- Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, për pasuritë regjistruara sipas **AMTP nr. 16**, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, me sipërfaqe 5350 m² dhe **AMTP nr. 47**, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A.C, me sipërfaqe 9700 m², që i janë nënshtruar procesit të shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, **me sipërfaqe të përcaktuar sipas Aktit por që nuk përputhet me gjëndjen faktike sipas librit të ngastrave**, përkatësisht si vijon:

- Pasuria nr. 155/1, vol. 1, fq. 59, zk. 1556-Drizë, e llojit arë, me sip. 2590 m² sipas Aktit, ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 2500 m², lëshuar certifikatë pronësie datë 24.02.2004. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, lëshuar certifikatë datë 11.01.2013. Sa më sipër rezulton se i është nënshtruar shpronësimit sipërfaqja 2580.8 m², ndërkohë që sipas faktit Librit të ngastrave është 2500 m² pra 80.08 m² më shumë se fakti.

- Pasuria nr. 36, vol. 1, fq. 195, zk. 1556-Drizë, e llojit arë+truall, me sip. 1000 m², ndërkohë sipas LN Mars 2000 është 500 m², pa lëshuar certifikatë pronësie. Me Ref. 0103, datë 17.11.2012, pasuria ka kaluar në pronësi të METE, sipas VKM nr. nr. 656, datë 26.09.2012, lëshuar certifikatë pronësie datë 11.01.2013. Shpronësimi është bërë për të sipërfaqen 531.07 m², ndërkohë që sipas faktit Libri i ngastrave, është 500 m² pra 31.07 m² më shumë se fakti, veprime këto në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1- Rekomandim: Dejtari i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të verifikohet ligjshmëria e procedurave të shpronësimit për pasuritë regjistruara sipas AMTP nr. 16, pa datë, Drizë Gramsh, në emër të M.K, dhe AMTP nr. 47, datë 05.03.1992, Drizë Gramsh, në emër të A.C.

Brenda datës 31.10.2019

17- Gjetje nga auditimi: Në 3 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, për pasuritë nr. 10/300, vol. 20, fq. 108, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të N.C, nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gram, në pronësi të R.M, nr. 7/135+1-4, vol. 1, fq. 102, zk. 1842 dhe nr. 7/135+1-3, vol. 1, fq. 98, zk. 1842, në pronësi të Vullnet Shahini, bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në çdo rast të regjistrimit të lejeve të legalizimit për objektet informale të ndërtuara mbi objektet e vjetra, të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit ligjor lëshuar nga organet kompetente vendore për prishjen e objektit të vjetër në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

18- Gjetje nga auditimi: Në 19 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetria e objekteve informale, si dy nga dokumentet e detyrueshme për regjistrimin e lejes së legalizimit, nuk janë të rregullta pasi janë të pafirmosura nga specialistët e Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, dhe specialistët e sektorëve të tjerë, për pasuritë si vijon nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H; nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.S; nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, në pronësi të F.M; nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, në pronësi Xh ; nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, në pronësi A.R; nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, në pronësi V.D; nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, në pronësi H.M; nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, në pronësi B.J; nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, në pronësi D.D; nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, në pronësi H.S; nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, në pronësi F.H; nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-6, vol, 22, fq.98, në pronësi S.D; nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, në pronësi S.Ç; pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842; pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, zk. 1842.

Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe pikën 10 të VKM Nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet Aluizni-t dhe ZQRPP-së,dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, për pasuritë si vijon: nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

L.H; nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.S; nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, në pronësi të F.M; nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-14, vol, 22, fq. 127, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-11, vol, 22, fq. 138, në pronësi A.R; nr. 9/321+1-12, vol, 22, fq. 173, në pronësi V.D; nr. 9/321+1-1, vol, 22, fq. 131, në pronësi H.M; nr. 9/321+1-8, vol, 22, fq. 91, në pronësi B.J; nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-3, vol, 22, fq. 158, në pronësi D.D; nr. 9/321+1-4, vol, 22, fq. 77, në pronësi H. S; nr. 9/321+1-9, vol, 22, fq.49, në pronësi F.H; nr. 9/321+1-15, vol, 22, fq.36, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-6, vol, 22, fq.98, në pronësi S.D; nr. 9/321+1-7, vol, 22, fq.95, në pronësi S.Ç; pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842; pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, zk. 1842.

Brenda datës 31.10.2019

19- Gjetje nga auditimi: Në 7 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për dhënien e shërbimit të kërkuar qytetarëve, duke krijuar vonesa në disa raste deri në një vit, kjo pa shoqëruar me Aktverifikim (AV), për mangësi në dokumentacion, që do argumentonte ligjërisht vonesat e shkaktuara, veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e trafivave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në çdo rast të ofrohet në kohë shërbimi i kërkuar qytetarëve në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore dhe me qëllim rritjen e transparencës për publikun.

Menjëherë dhe në vijimësi

20- Gjetje nga auditimi: Në 2 raste nga Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në zonën kadastrale 1842-Gramsh, janë regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi konkretisht pasuria nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, pasi sipërfaqet e ndërtimit dhe parcelës ndërtimore sipas lejes së legalizimit nuk përputhen me ato të përcaktuara në gent plan dhe planimetri, gjithashtu leja e legalizimit është me korigjime dhe nga ana e ish- ZVRPP Gramsh nuk duhet të pranohej regjistrimi i lejes së legalizimit, kur titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është fituar e drejta e pronësisë është me korigjime dhe jo i saktë, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

20.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në çdo rast kur lejet e legalizimit janë me korigjime të refuzojë regjistrimin e tyre dhe të kthej dokumentacionin për korigjim, gjithashtu në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, të vendoset masa e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, në pronësi të shtetasit F.C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, deri në korigjimin e lejes së legalizimit dhe plotësimit të dokumentacionit tektoniko-ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

21- Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) ka regjistruar leje legalizimi për objekte informale të cilat nuk plotësojnë kriteret për kualifikim pasi nga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objektet informale janë ndërtuar në distancë të afërt me rrugën kryesore dhe trotuarin në kundërshtim me përcaktimet e nenit 49-“Regjistrimi i objekteve të legalizuara” të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2, pika 4/8/1, si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të vendoset masa e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/278/2, vol. 22, fq. 84, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit F. C dhe pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit K.C, të shfuqizojë certifikatat e lëshuara si dhe të rikthejë lejet e legalizimit për rishqyrtim.

Brenda datës 31.10.2019

22- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, nuk ka verifikuar origjinën e truallit mbi të cilën është ndërtuar objekti informal pasi nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se regjistrimi i pasurisë nr. 7/96, vol. 14, fq. 216, zk. 1842, pjesë e pasurisë truall, fillimisht është bërë me Ref. 5975, aplikimi nr. 2277-2580, datë 08.07.2009, me leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 1, datë 01.12.1992, të Këshillit të Rregullimit të Territorit, ku është miratuar sheshi i ndërtimit për sipërfaqen prej 16 m2, për ndërtimin repartit mekanik në favor të shtetasit H.C. Në dosje nuk administrohet kontrata e blerjes së truallit pas vitit 1991, mbi të cilin është ndërtuar objekti repart mekanik, si një nga 3 dokumentet që duhet për regjistrimin e pronës dhe pajisjen me certifikatë pronësie në përputhje me përcaktimet e Rregullores nr.184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12. Gjithashtu sipërfaqja e regjistruar në kartelë pas hedhjes nga sistemi hipotekor dhe e certifikuar datë 29.12.2009 është 20 m², ndërkohë që në asnjë prej dokumenteve të pronësisë nuk përmendet sipërfaqja 20 m² por 16 m², pra regjistrimi i sipërfaqes prej 4 m² është i pa justifikuar me dokumente ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni 38, shfuqizuar me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 12. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R. M deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

Brenda datës 31.10.2019

23- Gjetje nga auditimi: Në 2 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar pasurit nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.S dhe nr.7/329, vol.20, fq. 135, në pronësi të N.D, bazuar në lejet e legalizimit për objektet informale të ndërtuara mbi troje në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh sipas VKM-së nr.431, datë 11.07.2007, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të Qarkut Elbasan”, **pa marrë më parë miratimin nga Bashkia Gramsh për legalizimin e objektit informal veprime këto që bien në kundërshtim** me pikën 2, Neni 15/1, Neni 39- Përfashtimi nga legalizimi, të ligjit nr.9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar, nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1-Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurit nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V. S dhe nr. 7/329, vol.20, fq. 135, në pronësi të N.D, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin.

Brenda datës 31.10.2019

24- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, Ref. 8646, datë 21.02.2017, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin pasi sipas VKM nr. 117, datë 17.02.2011, sipërfaqja e miratuar për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

parcelën ndërtimore për bashkëpronarët Tace është 302.5 m² (3.22+299.3) ndërkohë që sipërfaqja e miratuar në leje është 340.2 m², **pra nuk dokumentohet se si është përfituar sipërfaqja e mbetur prej 40 m²**. Gjithashtu mbi pasurinë nr. 9/421, vol. 21, fq. 190, Zk. 1842 me sip. 855, e llojit truall, është regjistruar në favor të bashkëpronarëve D, me Ref. 8662, datë 15.07.2015, Vendimi i Gjykatës nr. 5001, datë 21.04.2014, lëshuar certifikatë pronësie datë 21.12.2015, ndërkohë që për një pjesë të kësaj pasurie ekziston një VKM për kalimin e parcelës ndërtimore nga shteti në favor të bashkëpronarëve T, e dhënë më parë në kohë nga vendimi gjykatës. ZVRPP Gramsh nuk duhej të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit deri në saktësimin e marrëdhënieve me truallin, dhe vazhdimin e procedurave të shpronësimit nga ALUIZNI Elbasan si dhe korrigjimin e lejes së legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1-Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr.102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin.

Brenda datës 31.10.2019

25- Gjetje nga auditimi: Në 14 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka regjistruar leje legalizimi mbi pasuritë si vijon: nr. 9/321+1-5, vol 22, fq. 55, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të F.M; nr. 9/321+1-10, vol, 22, fq. 128, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-14, vol. 22, fq. 127, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D. B; nr. 9/321+1-11, vol. 22, fq. 138, zk. 1842-Gramsh, në pronësi A.R; nr. 9/321+1-12, vol. 22, fq. 173, zk. 1842-Gramsh, në pronësi V.D; nr. 9/321+1-1, vol. 22, fq. 131, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.M; nr. 9/321+1-8, vol. 22, fq. 91, zk. 1842-Gramsh, në pronësi B.J; nr. 9/321+1-2, vol, 22, fq. 189, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-3, vol. 22, fq. 158, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.D; nr. 9/321+1-4, vol. 22, fq. 77, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.S; nr. 9/321+1-9, vol. 22, fq.49, zk. 1842-Gramsh, në pronësi F.H; nr. 9/321+1-15, vol. 22, fq.36, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-6, vol. 22, fq.98, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.D; nr. 9/321+1-7, vol. 22, fq. 95, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.Ç; pa verifikuar më parë marrëdhëniet me truallin, pasi pasuria nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, e llojit Pallat, nuk ka asnjë të dhënë për sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës, në seksionin Përshkrimi i veçantë ka shënimin “Pallati nuk ka ardhur nga ALUIZNI”, ndërsa në seksionin C- Pronësia, është vendosur shënim se kjo pasuri vijon në vol. 22, faqe 36, 49, 55, 77, 91, 95, 96, 98, 127, 135, 138, 158, 173 dhe 189.

Nga ish-ZVRPP Gramsh nuk disponohet asnjë dokument për regjistrimin e pallatit më sipër apo se nga vijon pasuria, gjithashtu në kartelë nuk është vendosur data dhe nënshkrimi i specialistët që ka hedhur veprimet. Nga verifikimi i pozicionit hartografik të hartës rezulton se pallati i hapur në pasurinë nr. 9/321, vol. 22, faqe. 35, zk. 1842, bie mbi pasurinë nr. 9/52, vol. 14, fq. 250, e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

llojit truall, hapur në volum sipas Librit të ngastrave LN Gusht 2000, me sipërfaqe 388,5 m² truall dhe 297.6 m² ndërtesë, në pronësi shtet, datë regjistrimi 16.01.2001. Në seksionin - Përshkrimin i vecantë ka shënimin *“Pallati 5 kate, me 1 shkalle 15 apartamente, nuk është depozituar leja e ndërtimit”*. Gjithashtu nga verifikimi i planimetrive të lejeve të legalizimit të depozituara për regjistrim, rezulton se nuk kemi të bëjmë me shtesa në objekte ekzistues por regjistrim i mirëfilltë i apartamenteve ekzistuese në objektin 5 Kat që nuk kanë pasur dokumente origjine për regjistrim. Leja e legalizimit është dhënë për objektin shtesë anësore banimi kati përdhe në pallatin ekzistues 5 Kat, ndërkohë që për pallatin ekzistues 5 Kat nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrim, pra nuk është certifikuar, gjithashtu regjistrimi në kartelë i lejes së legalizimit është bërë në zërin kadastral Apartament, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë për shtesë anësore.

ZVRPP-Gramsh nuk duhet të procedonte me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasi titulli i pronësisë nuk përputhet me statusin juridik të pasurisë veprime në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, nenin 36, 36/1 dhe 37 të ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuarsi dhe pikën 5 të Udhëzimit nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

25.1-Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin për pasuritë si vijon: nr. 9/321+1-5, vol. 22, fq. 55, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të F.M; nr. 9/321+1-10, vol. 22, fq. 128, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-14, vol. 22, fq. 127, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-11, vol. 22, fq. 138, zk. 1842-Gramsh, në pronësi A.R; nr. 9/321+1-12, vol. 22, fq. 173, zk. 1842-Gramsh, në pronësi V.D; nr. 9/321+1-1, vol. 22, fq. 131, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.M; nr. 9/321+1-8, vol. 22, fq. 91, zk. 1842-Gramsh, në pronësi B.J; nr. 9/321+1-2, vol. 22, fq. 189, zk. 1842-Gramsh, në pronësi X.K; nr. 9/321+1-3, vol. 22, fq. 158, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.D; nr. 9/321+1-4, vol. 22, fq. 77, zk. 1842-Gramsh, në pronësi H.S; nr. 9/321+1-9, vol. 22, fq.49, zk. 1842- Gramsh, në pronësi F.H; nr. 9/321+1-15, vol. 22, fq.36, zk. 1842-Gramsh, në pronësi D.B; nr. 9/321+1-6, vol. 22, fq. 98, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.D; nr. 9/321+1-7, vol. 22, fq. 95, zk. 1842-Gramsh, në pronësi S.Ç.

Brenda datës 31.10.2019

26- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), gjatë vitit 2017 ka aplikuar gabimisht dy tarifa për regjistrimin e lejeve të legalizimit, duke i ngarkuar qytetarëve dhe tarifën e ndërtimeve të reja, tarifë e cila aplikohet për lejet e ndërtimit dhe jo për lejet e legalizimit, **e cila llogaritet në vlerën totale 741,000 lekë (114 aplikime*6500 lekë), tarifuar gabimisht** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

26.1-Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të kthej shumat e tarifuara gabimisht qytetarëve, gjithashtu në çdo rast të aplikojë tarifat për shërbimet e kërkuara sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

27- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2018 ka qenë palë në 24 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat ka qenë në mungesë në 4 raste, duke mos ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 391, 442, 443, 444 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligji nr.33/2012, datë 29.04.2012“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 93-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa të menjëhershme të caktojë me urdhër të brendshëm një specialist i cili do të përfaqësojë zyrën në proceset gjyqësore, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit duke bërë ankimimet përkatëse si dhe të krijojë database duke evidentuar të gjitha proceset gjyqësore si dhe ecurinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

28- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 9175, pa aplikim, ka regjistruar pasurinë nr. 9/400 sipërfaqe truall dhe ndërtim 92.7 m², volum 20, faqe 123, në emër të I.X dhe S.X, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Apelit Durrës nr. 10-2017-2660/1010, datë 01.11.2017. Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 pika 5 të Ligji nr.33/2012, datë 29.04.2012“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasi ka kryer regjistrim e vendimit të gjykatës pa aplikim të kërkuarit, duke shkaktuar shmangien e detyrimeve financiare për regjistrimin e aktit dhe i padituri D.X, bashkëpronar i pasurisë nuk është pasqyruar në kartelën e hapur nga ZVRPP Gramsh, duke lënë pronar me pjesë të papërcaktuara në kartelë I.X dhe S. X (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 93-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 9/400 regjistruar në volum nr. 20, faqe nr.123 ZK 1842, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të nenit 27, pika b e ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.10.2019

29- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), me referencën nr. 0483, me aplikim, ka regjistruar Vendimin e Gjykatës nr. 157, datë 03.02.2016 i cili ka vendosur kthimin në natyrë të sipërfaqes prej 6334 m², brenda sipërfaqes 20000 m², të njohur me Vendimin nr. 559, datë 15.05.1996 të KKKP Gramsh, kjo sipërfaqe e kthyer është e ndarë në 17 parcela(pasuri) sipas dispozitivit të vendimit të gjykatës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

Veprimet e kryera nga ZVRPP Gramsh konstatohen në papajtueshmëri me nenin 45 pika 5 të Ligji nr.33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për trajtimin e kërkesës së shtetasit Q.G, pasi vendim Gjykatës Elbasan nr. 157, datë 03.02.2016, ka mos përputhje të sipërfaqes së kthyer fizikisht paditësve, konkretisht, në dispozitiv gjykata shprehet për 6334 m2, ndërsa shuma e parcelave përbën një sipërfaqe totale prej 6634 m2, pra një diferencë prej 300 m2. Njëherazi, procedura e Përmirësimit e Përditësimit nuk është bërë në pajtueshmëri me kërkesat e VKM nr.245, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimit të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” pasi nuk janë respektuar përcaktimet e pikës 8 e në vijim të VKM-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 93-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara në zbatim të Vendimit të Gjykatës nr. 157, datë 03.02.2016, sipas referencës nr. 0483, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të nenit 27, pika b e ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.10.2019

30- Gjetje nga Auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) mbi regjistrimin e pasurive të transferuara dhe administrimi i tyre ndër vite, u konstatua se me numër reference 6402, datë 03.12.2010 dhe aplikim 0455794, datë 02.12.2010, Bashkia Gramsh, në përputhje dhe në zbatim të VKM nr. 431 dt.11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore”, që transferohen, në pronësi, ose në përdorim, ka aplikuar për regjistrimin në pronësi dhe përdorim të pronave, kolektorët e ujërave të bardha dhe të zeza, rrjeti i ndricimit publik, trojet dhe hapësirat publike, sheshet, trotualet, lulishtet, etj. Për 32 pasuri rezulton se është bërë aplikimi për regjistrimin e tyre dhe pajisjen me certifikatë pronësie nga Bashkia Gramsh dhe janë pajisur me certifikatë 19 pasuri, për 3 pasuri nuk ka informacion, ndërsa për 10 pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie, pasi nuk është paguar tarifa e shërbimit. Gjithashtu për 189 pasuri nuk është kryer asnjë veprim nga ana e Bashkisë Gramsh në ish-ZVRPP Gramsh për sa i takon aplikimit për pajisjen me certifikatë të tyre, edhe pse ka kaluar shumë kohë që nga dalja e VKM nr. 431, datë 11.07.2007. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 24 e 25 të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 97-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh në bashkëpunim me Bashkinë Gramsh, të marrë masa të menjëhershme duke dërguar shkresë drejtuar Bashkisë Gramsh për aplikim për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pasurie të 189 pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Gramsh në zbatim të VKM nr. 431 dt. 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore”.

Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

31- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) për periudhat raportuese objekt auditimi në procesin e hartimit të buxhetit bazuar në programin e Projekt Buxheti Afatmesëm hartuar nga ish-ZQRPP Tiranë, rezultoi se nuk janë parashikuar plotësisht nevojat e institucionit pasi fondet e alokuara janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të institucionit sepse ka mungesa investimesh kryesisht për pajisje elektronike dhe kanceleri të ndryshme, në mospërputhje të përcaktimeve të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", si dhe udhëzimet vjetore përkatës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 100-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1- Rekomandim: Dejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa që bazuar në nevojat e konstatuara për investime dhe shërbime të ndryshme, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të planifikojë në periudhat e ardhshme fondet e nevojshme për plotësimin me pajisje dhe shërbime konkrete.

Menjëherë dhe në vijimësi

32- Gjetje nga auditimi: Në Zyrën Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në strukturën organike të miratuar mungon përfshirja e pozicionit arkivist/protokollist, rol të cilin e kryen specialistja e financës e patrajnuar në këtë fushë, ndërsa arkiv/protokolli duhet të funksionojë mbështetur në zbatimin e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivën" dhe Manualit rregullator "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 100-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh në bashkëpunim me ZQRPP Tiranë, bazuar në mangësitë e konstatuara dhe në kuadrin ristrukturimit të institucionit, të marrë masa për plotësimin e strukturës organike duke përfshirë pozicionin arkivist/protokollist, me qëllim funksionimin e plotë të institucionit në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivën" dhe Manualit rregullator "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

33- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) në organizimin e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël, për periudhat objekt auditimi të viteve 2017 dhe 2018, nuk ka respektuar plotësisht procedurat e prokurimit pasi komisioni i autorizuar për realizimin e procedurës së blerjes me vlerë të vogël në vitin 2017 në asnjë rast nuk ka evidentuar dhe kryer procedurën me prokurim elektronik, për pasojë edhe njoftim për klasifikim i ofertave konkurruese nuk është njoftuar ofertuesve, që nuk janë kualifikuar për mungesa në dokumentacion, kur kontraktori është i detyruar të njoftojë operatorët nëpërmjet sistemit elektronik, mbi klasifikimin e ri të procedurës, veprime këto në mospërputhje me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 100-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

33.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masat e nevojshme në vazhdimësi për nxjerrjen e urdhër prokurimeve për zbatimin e procedurës “blerje me vlerë e vogël” duke përcaktuar referimin ligjor për “blerje e vogël” me sistem elektronik sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

34- Gjetje nga auditimi: Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk ka zbatuar procedurat ligjore lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe zbatimin e afateve ligjore për kryerjen e shërbimeve të faturuara, ndaj qytetarëve, si vijon:

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 9 vitesh deri në 31.12.2018 janë 39 praktika me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, në mos zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.01.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim nga Kryeregjistruesi, një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës, për periudhën e mëparshme dhe për periudhën 01.01.2017- deri 31.12.2018, të bazuar në organikat dhe organigramat e miratuara nga qeveria me urdhërat përkatës, pasi Rregullorja aktuale nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP-së, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat ligjore aktuale, për rrejdhojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësisë, të secilit specialist sipas sektorëve përkatës, Regjistruesit, lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimi, pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet 113-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e **39 praktikave** dhe kërkesave në proces të pa përfunduara, para dhe prej 3 vitesh, deri në 31.12.2018, për të bërë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

të mundur kryerjen e shërbimit të faturuar, rritjen e integritetit dhe transparencës së punës së Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh ndaj publikut, si dhe të administrohet në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave në proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

34.2- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të marrë masa për të hartuar e miratuar Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Administratës, e cila do të përcaktojë qartë funksionimin e hallkave e strukturave dhe detyrat e përgjegjësitë për çdo punonjës, duke ngritur e forcuar Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB).

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, **në vlerat 445,296 lekë** analizuar si me poshtë:

1- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast regjistrimi i AMTP nr. 12, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të D.K, me sipërfaqe 5200 m2 dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezulton se në total shtetasi D.Kl ka përfituar 5985 m2 tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 4900 m2 tokë arë, pra 1085 m2 tokë është e pajustifikuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 190,960 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të kërkojë në rrugë ligjore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

arkëtimin e vlerës 190,960 lekë përfituar padrejtësisht nga procesi i shpronësimit nga shtetasi D.K.

Brenda datës 31.10.2019

2- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast regjistrimi i AMTP nr. 80, datë 29.02.1992, Drizë Gramsh, në emër të F.C, me sipërfaqe 5400 m² dhe përfshirja në procesin e shpronësimit, sipas projektit për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës bazuar në VKM nr. 656, datë 26.09.2012 “Për shpronësimin, për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, në dosje nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjëndjen familjare në datën 01.08.1991, mungon dhe dokumentacioni tjetër konfirmues, gjithashtu nga verifikimi i regjistrimeve të kryera në kartelë rezulton se në total shtetasi F.Ca ka përfituar 5282 m² tokë arë, ndërkohë që sipas Aktit ka 5100 m² tokë arë, pra 182 m² tokë është e pajustifikuar me dokumentacion ligjor dhe titull pronësie, duke llogaritur një vlerë shpronësimi 32,032 lekë, përfituar në papajtueshmëri me përcaktimet e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, Ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 38-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa që në bashkëpunim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 32,032 lekë përfituar padrejtësisht nga procesi i shpronësimit nga shtetasi F. C.

Brenda datës 31.10.2019

3- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në zonën kadastrale zk. 1842-Gramsh, ka regjistruar pasuri të paluajtshme me leje legalizimi, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, në lidhje me mosllogaritjen dhe kryerjen e pagesës sipas vlerës së tregut për sipërfaqet e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes së ndërtuar, pra mbi normën ligjore, duke kaluar në pronësi të përfituesve të lejes së legalizimit, sipërfaqja prej 66.8 m² me pasoja dëmin ekonomik në vlerën 165,304 lekë, për pasurinë nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, në pronësi të shtetasit R.M. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 17, pika 1/c të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe pika 5 të Udhëzimit KM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

3.1- Rekomandim: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, në pronësi të shtetasit R.M deri në arkëtimin e vlerës 165,304 lekë.

Brenda datës 31.10.2019

4- Gjetje nga auditimi: Në 1 rast Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), në regjistrimin e lejes së legalizimit nr.2578818, datë 18.04.2018, në pronësi të R.M, zk. 1842-Gramsh, pasuria nr.9/278/3, vol.22, fq. 70, nuk ka verifikuar marrëdhëniet me truallin për pagimin e qirasë, për periudhën e auditimit nga data 30.06.2014 deri 30.06.2017 nuk ka të përcaktuar marrëdhëniet e pronësisë me qira apo shitje dhe nga llogaritja e qirasë së truallit në zbatim VKM 54, datë 05.02.2014 rezulton se për sipërfaqen 16 m² x 100 lekë/m² x 36 muaj, duhet të kishte paguar detyrimin 57,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje me marrëdhëniet me truallin dhe arkëtimin e detyrimit të qirasë së përcaktuar 57,000 lekë.

Brenda datës 31.10.2019

C- TË ARDHURA TË MUNGUARA

1- Gjetje nga auditimi: Në 8 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka arkëtuar **vlerën 412,733 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit**, që vijnë nga mosarkëtimi i të ardhurave nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të legalizimit, për pasuritë si vijon: nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit R.M, për vlerën **12,447 lekë**; nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H, përvlerën **35,176 lekë**; nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M, për vlerën **53,782 lekë**; nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.S, për vlerën **116,957 lekë**; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 6654236, datë 22.04.2016, në pronësi të V dhe M.D, me Ref. 8679, datë 10.03.2017, për vlerën 6094 lekë; - Pasuria regjistruar sipas Ref. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, vlerën 56,530 lekë; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, për vlerën 70,319 lekë; - Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 3040276, datë 29.08.2016, në pronësi të N.C, me Ref. 8871, pa datë, për vlerën 61,428lekë.Veprimenë kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 27, pika “ç” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar”, si dhe Kreu I, pikën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH

1, c dhe pika 2 të VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 62-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtori i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “PërKadastrën”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në arkëtimin e vlerës totale 412,733 lekë**, përkatësisht për pasuritë si vijon:

- Pasuria nr. 4/179, vol. 22, fq. 184, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të shtetasit R.M, për vlerën **12,447 lekë**;
- Pasuria nr. 9/188, vol. 16, fq. 33, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të L.H, përvlerën **35,176 lekë**;
- Pasuria nr. 9/278/3, vol. 22, fq. 70, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të R.M, për vlerën **53,782 lekë**;
- Pasuria nr. 7/331, vol. 22, fq. 46, zk. 1842-Gramsh, në pronësi të V.Sh, për vlerën **116,957 lekë**;
- Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 6654236, datë 22.04.2016, në pronësi të V dhe M. D, me Ref. 8679, datë 10.03.2017, për vlerën **6094 lekë**;
- Pasuria regjistruar sipasRef. 8646, datë 21.02.2017, leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të bashkëpronarëve T, zk. 1842, vlerën **56,530 lekë**;
- Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 102008, datë 09.01.2017, në pronësi të B.Z, me Ref. 8598, datë 21.02.2017, për vlerën **70,319 lekë**;
- Pasuria regjistruar me Leje legalizimi nr. 3040276, datë 29.08.2016, në pronësi të N.C, me Ref. 8871, për vlerën **61,428 lekë**.

Brenda datës 31.10.2019

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret).

- Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh) nuk është audituar më parë nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2017 deri me 31.12.2018 janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur nga veprimet e mosveprimet e specialistëve dhe nga një kuadër legjislativë me mangësi. Niveli i menaxhimit të veprimtarisë së subjektit nga strukturat drejtuese konstatohet në nivele jo të mjaftueshme. Auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të ish-ZVRPP Gramsh si një institucion që ka impakt të lartë social dhe ndikon direkt në vlerësimin dhe opinionin e qytetarëve për qeverisjen e vendit, paraqet rëndësi në lidhje me informimin dhe evidentimin e mangësive për vendosjen e rekomandimeve në lidhje me përmirësimin e punës në të ardhmen. Auditimet më të shpeshta dhe periodike do të ndikojnë në rritjen e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni.

Konkluzioni më sipër është arritur duke u bazuar në mangësitë dhe shkeljet si vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, bazuar vetëm në deklaratën noteriale, të poseduesit të ndërtimit, për prishjen e ndërtimit të vjetër, pa dokumentacionin përkatës ligjor nga institucionet vendore, si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit.
- Janë kryer regjistrime me shkelje të dispozitave ligjore, pasi mungon dokumentacioni tekniko ligjor, akti i fitimit të pronësisë mbi truallin, konfirmimi zyrtar nga institucionet përkatëse lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i truallit në pronësi "shtet", gjithashtu marrëdhëniet me truallin nuk janë sipas ligjit, etj.
- Janë kryer regjistrime të pasurive të përfituara me AMTP, me shkelje të dispozitave ligjore, pasi janë regjistruar pasuri që nuk janë të llojit tokë bujqësore, për të cilat AMTP-ja nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie.
- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetrit e objekteve informale, si dy nga dokumentet e detyrueshme për regjistrimin e lejes së legalizimit, nuk janë firmosur nga specialistët e Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, dhe specialistët e sektorëve të tjerë.
- Janë regjistruar leje legalizimi për objekte informale të ndërtuara mbi troje në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh pa marrë më parë miratimin nga Bashkia Gramsh për legalizimin e objektit informal.
- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe janë kryer transaksione, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi është shkelur kriteri i ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre kanë përfituar më tepër tokë se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare datë 01.08.1991.
- Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Elbasan, lidhur me konfirmimin zyrtar të statusit të parcelave ndërtimore të miratuara, ndërsa nga ish-ZVRPP Gramsh është proceduar duke regjistruar dhe certifikuar pronësinë për poseduesit e lejeve të legalizimit, të cilat janë ndërtuar mbi objekte që figurojnë në pronësi "shtet", të regjistruara në KPP.

Magësit dhe shkeljet e konstatuara më sipër nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, janë materiale për devijimet e konstatuara në disa raste, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar me rezervë dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar ish-Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, sot Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh, marrja e masave përkatëse.

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

Akt konstatimi nr. 1, datë 28.05.2019, Regjistrimi me vendim gjykate;

Akt konstatimi nr. 2, datë 28.05.2019, Regjistrimin e Vendimeve të KVVTP-ve dhe KKKP-ve;

Akt konstatimi nr. 3, datë 29.05.2019, Mbi buxhetin dhe prokurimet;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN NË ZYRËN VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS GRAMSH, ISH- ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GRAMSH"

Akt konstatimi nr. 4, datë 30.05.2019, Regjistrim sipas Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991;

Akt konstatimi nr. 5, datë 30.05.2019, Praktikat në proces;

Akt konstatimi nr. 6, datë 30.05.2019, Regjistrimi me leje legalizimi;

Akt konstatimi nr. 7, datë 30.05.2019, Regjistrimi i pasurive publike;

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport Përfundimtar Auditimi duhet t'u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Grupi i Auditimit

Besmir **PAJAJ (Përgjegjës Grupi)**

Xhovan **DOMI**

Julian **ADILI**

Keida **MUCA**